

Titulli: MORALI ISLAM

Nga: Komisioni i përgatitjes së librave mësimorë

E përktheu nga arabishtja: Vullnet Merja

Redaktoi: Hajri Shehu

Korrektore teknike: Vjollca Feza

Kopertina: T. Gorbani

Përkujdesja grafike:

Botoi: Shoqata "Flladi"

ISBN

Copyright: Shoqata "Flladi"

Tirazhi 1000 kopje

Formati:

Shtypur në Shtypshkronjën e Shtëpisë Botuese "LILO"

Shoqata

Flladi

PARATHËNIE

Në moralin islam, fjala *terbijeh*, "edukatë" është e bashkëshoqëruar me fjalën *ta'lim* "studim". Prandaj dijetarët e fesë dhe mësuesit e medreseve thonë se edukata është mesazh për udhëzimin e njerëzisë.

Në Kur'anin Famëlartë, në synnetin e Profetit Fisnik (s.a.s) dhe në thëniet e imamëve të Ehli Bejtit (a.s) dëshmohet fuqishëm rëndësia e edukimit dhe e pastërtisë së shpirtit. Ato nxjerrin në pah se studimi pa edukim nuk mund të jetë pishtar ndriçues; studimi mund të shndërrohet në një mbulesë, e cila e pengon njeriun që të ecë në rrugën e plotësisimit e të përsosurisë. Nga këtu kuptohet qartë se, morali që urdhëron feja për edukimin e vetes është prej shtyllave themelore të programeve mësimore- edukative. Shpërfillja e moralit ka rezultate dhe ndikime negative në jetën individuale dhe atë shoqërore.

Nganjëherë fjalët "etikë" dhe "moral" kanë kuptim të përbashkët; nganjëherë kanë kuptime të veçanta dhe të pavarura. Nëse i kuptojmë ashtu siç duhet etikën dhe moralet e mira, do të mësojmë se kanë përmbajtje më të gjerë, kjo përmbajtje e gjerë është kultura. Kultura përfshin zakonet e sjelljet të cilat i japin çdo shoqërie njëjtësinë (identitetin) dhe përcaktojnë pozitën e saj.

Islami, në mesazhin e tij për mbarë njerëzinë i fton shoqëritë që të përvetësojnë moralet, të cilat janë në përputhje me natyrën krijuese të njeriut. Islami nuk i mohon zakonet shoqërore që kanë bashkësitë; ai mohon zakonet që janë në kundërshtim me thelbin e fesë së All-llahut (xh.sh.). Profeti Muhammed (s.a.s.), pasi i erdhi kurora e profetësisë, nuk i mohoi zakonet dhe traditat e pëlqyeshme të asaj kohe. Ai thoshte se ato zakone janë plotësuese për moralet e mira.

Kultura luan rol të madh në shoqëri. Njësoj si gjaku, i cili qarkullon në çdo qelizë të trupit të njeriut, po ashtu edhe kultura depërton në çdo qelizë të shoqërisë, te mendimtarët, punonjësit dhe institucionet e mëdha a të vogla. Kësisoj, kultura ndryshon jetën shoqërore.

Kur erdhi Islami dhe u përhap drita dhe ngrohtësia e tij u formua një shoqëri e re, me shpirt të ri. Ky shpirt është solidarësia dhe dashuria mes anëtarëve të saj.

All-llahu (xh.sh.) thotë: ***“Muhammedi është i dërguari i All-llahut, e ata (sahabët), që janë me të janë të ashpër kundër jobesimtarëve, e të mëshirshëm ndërmjet njëritjetrit...”*** (Surja “Fet’h” 29)

Dhe: ***“Ai është që bashkoi zemrat e tyre. Edhe sikur të shpenzoje çfarë ka në Tokë, nuk do të arrije t'i bashkoje zemrat e tyre, por All-llahu bëri bashkimin e tyre, sepse Ai është i Plotfuqishëm dhe i Urtë.”*** (Surja “Enfal”: 63)

Kur njerëzit i besuan mesazhit të Profetit Muhammed (s.a.s) dhe përqaftuan fenë e All-llahut (xh.sh.) turma-turma, filloi të dukej një kulturë e re. Njëherazi, Profeti (s.a.s.) i shfarosi ato zakone dhe tradita që ishin në kundërshtim me natyrën krijuese të njeriut. Ai ftoi të falej namazi me xhemat, të falej namazi i xhumasë; ai urdhëronte në të mira dhe ndalonte nga të këqijat; ai nxiste për marrëdhënie të fuqishme vëllazërore, për respektimin e prindërve, për mbajtjen e lidhjeve farefisnore, për respektimin e fqinjit dhe të drejtat e fqinjit etj. Ai e ftonte besimtarin për ta zbukuruar veten me vetitë e pëlqyera morale, si; thjeshtësia, mbajtja e premtimeve,

zemërbutësia, vetëpërmbytja, falja, respektimi dhe nderimi i jetimëve, vizita tek i sëmuri, pjesëmarrja në gëzime e hidhërimi, mikpritja, çuarja e amanetit etj. Nga ana tjetër, ai luftonte sjelljet e këqija, si përgojimin, smirën, thashethemen, talljen dhe përqeshjen e të tjerëve, gënjeshtren etj.

Kur Islami parashtron etikën dhe kulturën e tij, nuk e parashtron thjesht bojë mbi letër, këto duhen zbatuar me qëllim që të forcohet personaliteti i individit dhe i shoqërisë. Në programin e Islamit gjendet shpërblimi dhe ndëshkimi në këtë jetë e në Jetën tjetër. Islami përqendrohet në vazhdimësinë e jetës së njeriut pas vdekjes. Në atë jetë njeriu do të korrë atë që ka mbjellë në këtë jetë.

Sipas kulturës dhe etikës islame, individi që punon për veten e tij, sjell edhe produkte shoqërore; p.sh, kur myslimani kujdeset për jetimin, ai ka si qëllim të fitojë kënaqësinë e All-llahut dhe Xhennetin; nga ana tjetër, ai i siguron jetimit një jetë të sigurt dhe e edukon me kulturë të dobishme për shoqërinë. Pra, kultura islame i vizaton individit dhe shoqërisë rrugën e vërtetë për të arritur lumturinë e vërtetë në këtë jetë dhe në Jetën tjetër.

I nderuar lexues! Shoqata "*Flladi*", sjell në duart tuaja këtë libër me titull "*Morali Islam*", i cili flet për etikën dhe moralin e myslimanit. Ky libër është përgatitur nga komisioni i përgatitjes së librave mësimorë që ndodhet pranë shoqatës së shkollave të fesë e Kur'anit në Republikën Islamike të Iranit. Njëkohësisht ky libër është përkthyer edhe në gjuhën arabe. Lusim All-llahun fuqiptotë që ky libër të jetë i dobishëm për lexuesit dhe kërkuesit e moraleve të pëlqyeshme, që të jemi shembull i përkryer në shoqëri. Shoqata "*Flladi*" falënderon të gjithë ata e të gjitha ato që morën pjesë në përgatitjen e këtij libri.

All-llahu u dhëntë suksese në jetën dhe veprimtarinë e tyre në këtë botë dhe na shpërbleftë me Xhennet në botën tjetër.

Mësimi 1

ISLAMI, FE SHOQËRORE

Një prej veçantive të Islamit, e cila e dallon atë nga fetë e tjera është se Islami është fe shoqërore. Ai nuk mjaftohet duke paraqitur detyrat vetëm për individin dhe për ngritjen e tij shpirtërore; ai i kalon këta kufij, ai është për tërë sistemin shoqëror dhe për ndërtimin e shoqërisë. Theksojmë një fakt të rëndësishëm në jetën e njerëzve: lumturinë. Lumturia numërohet prej qëllimeve më të larta.

Njerëzit, për nga natyra e tyre krijuese, e duan përsosurinë, lakmojnë për të ngjitur shkallët e përsosurisë dhe për të arritur në skajet më të larta të jetës pa u përballur me probleme e as me vështirësi. Kjo është një e vërtetë e qartë, apo jo. Në këtë jetë nuk mund të gjendet njeri të cilit nuk i pëlqen lluksi, pasuria, suksesi e qytetërimi në jetën e tij. Për nga natyra e tyre krijuese, njerëzit duan gjithnjë e më shumë të shkojnë lart e më lartë. Nëse një njeri do ta pengonin rrethanat ta vijonte rrugën drejt përsosurisë; do ta shohësh të hidhëruar, të mërzhitur, të stresuar. Këtë të vërtetë dijetarët e kanë quajtur “kërkimi i përsosurisë së natyrshme.” Është më se e sigurt se askush nuk dyshon në këtë të vërtetë. As në fetë e tjera qiellore, a sektet fetare nuk kanë asnjë dyshim rreth kësaj çështjeje, sepse të gjithë njerëzit duan që të arrijnë përsosurinë e kërkuar njerëzore.

Sipas studimeve tona rreth feve e besimeve, qofshin fetare a materiale, gjejmë kumtime ku thuhet se ajo vijë që ti e vizaton, ajo të çon në përsosuri dhe ajo ta plotëson lumturinë. Ndryshimi mes tyre qëndron në njohjen e përsosurisë e të lumturisë dhe të rrugës e cila ia siguron njeriut përsosurinë dhe lumturinë. Më lart u përmend se ky anim kah përsosuria, i cili ndodhet në brendinë e njerëzve, nuk ka mbarim, as ndalim e as ngurtësim. Në bazë të saj, njeriu në çdo lëvizje të tij i lutet të Plotit të pakufizuar (All-llahut). Sipas mendimit tonë, për këtë të vërtetë nuk ka dyshim se përsosuria të cilën e dëshiron njeriu është po ajo përsosuri që e përkufizon Islami dhe që udhëzon për atë. Ajo përsosuri është afrimi tek All-llahu (xh.sh.), sepse vetëm All-llahu është e Vërteta dhe vetëm All-llahu është i Plotfuqishmi i pakufizuar në këtë ekzistencë.

Sipas pikëpamjes islame, njeriu arrin në përsosurinë e tij të vërtetë kur është më afër me All-llahun dhe kjo nga ana e saj, arrihet kur u bindesh urdhrave të All-llahut, kur vepron dhe ndalon sipas asaj që ka urdhëruar All-llahu e kështu fitohet kënaqësia e All-llahut (xh.sh.).

Çdo gjë në këtë ekzistencë shkon drejt shkatërrimit e zhdukjes, përveç All-llahut. Askush tjetër përveç All-llahut (xh.sh.) nuk ua plotëson njerëzve dëshirat e tyre. Prandaj, ata të cilët e quajnë pasurinë shkak të lumturisë, janë të gabuar, sepse pasuria, sado e madhe që të jetë, është e kufizuar dhe e paqëndrueshme. Përveç kësaj, jeta e njeriut është e mbushur me probleme e pasuria është e paafte t'i zgjidhë ato. Ndërsa All-llahu (xh.sh.), Krijuesi i gjithçkaje, është burimi i përsosurisë, i mirësisë, i lartësisë dhe i Përhershmi pas zhdukjes së krijesave. Mbështetja tek All-

llahu (xh.sh.) ia mundëson njeriut sigurimin e pasurisë së vërtetë e të përhershme. Kur'ani Famëlartë thotë rreth kësaj çështjeje: **“O ju njerëz, ju jeni të varfër tek All-llahu, dhe All-llahu është Ai i Pasuri, Falënderuesi.”** ⁽¹⁾

⁽¹⁾ (Surja “Fatir”: 15.)

Pra, njeriu është i varfër e i kufizuar përballë All-llahut (xh.sh.), kurse All-llahu është i pasuri absolut e i pakufizuari. Imam Husejni (a.s.) në lutjen e ditës së Arafatit, duke folur për të vërtetat dhe njohjet madhështore, thotë: **“Çfarë gjen ai njeri, i cili të humbi Ty dhe çfarë humb ai njeri që të gjen Ty?”**

Me këto fjalë, Imam Husejni zbulon një të vërtetë mjaft të rëndësishme: All-llahu është qenia e përsosur; ai që nuk i drejtohet All-llahut, është drejtuar kah zhdukja; ai njeri që i drejtohet All-llahut, është drejtuar kah përsosuria e pasuria dhe gjatë jetës së tij nuk ndien asnjë mangësi a zbrazëti.

Përderisa Islami na ka vënë afrimin tek All-llahu si qëllimin më të lartë për të arritur përsosurinë dhe lumturinë, atëherë cila është rruga që ka caktuar Ai për t'i arritur ato?

Kësaj pyetjeje i përgjigjet ajeti⁽¹⁾

Cilido që shpreson ta takojë Zotin e tij dhe bën punë të mira dhe nuk adhuron askënd tjetër përveç Zotit të tij.”¹⁾

¹⁾“ (Surja “Kehf”:110)

Dëshira e njeriut për ta takuar Zotin e tij kushtëzohet nga dy kushte:

- 1- Të bësh vepra të mira
- 2- Ta adhurosh All-llahun me çiltërsi të mos i bësh shok Atij

Sipas Islamit, lumturia arrihet kur zbaton plotësisht urdhrat e All-llahut në veprime e në ndalime sepse, kur kryen detyrat dhe largohesh nga të ndaluarat arrihet kënaqësia e All-llahut (xh.sh.). Po ashtu, duhet theksuar se adhurimi i All-llahut i jep njeriut kuptimin e plotë e të vërtetë të lirisë.

Kur studiojmë rregullat e vendosura nga All-llahu, qofshin ato të adhurimit a të tjera, do të shohim se shumica e tyre kanë të bëjnë me marrëdhëniet e njeriut me shoqërinë. Të rralla janë ato rregulla të Sheriatit që flasin vetëm për individin.

Me fjalë të tjera, Islami thotë se adhurimi që njeriu i bën All-llahut është rruga e vetme për përhapjen e mëshirës së gjërë të All-llahut. Kjo nuk do të thotë që njeriu të ndërpresë marrëdhëniet e tij me shoqërinë në të cilën ai jeton, nuk do të thotë as mënjanim, nuk do të thotë të strehohet në shpellë a në pyll dhe të shkëputet nga të tjerët. Jo, përkundrazi. Kjo do të thotë t'i shërbesh shoqërisë dhe t'i zgjidhësh problemet e njerëzve nëpërmjet bashkëpunimit vëllazëror; kështu njeriu afrohet tek All-llahu (xh.sh.) dhe e mishëron kuptimin e adhurimit të Tij.

Sheriati Islam përmban mjaft adhurime që predikohen me tubim, me xhemat. Dhe, njëra prej tyre është edhe i'tikafi. I'tikafi është vepër (mustehabeh) e pëlqyer dhe ka si qëllim edukimin e individit dhe pastrimin e tij shpirtëror. I'tikafi nuk kryhet veçse në xhami dhe veçse me xhemat. Edhe pse largimi nga xhamia në kohën e kryerjes së i'tikafit e prish rregullin e tij, mirëpo ai person i cili kryen i'tikafin është i lejuar të dalë nga xhamia kur bëhet fjalë për të kryer një çështje të rëndësishme shoqërore, siç është p.sh., vizita e një të sëmuri. Forcimi i vlerave njerëzore mbi të cilat qëndron lumturia e vërtetë, nuk mund të realizohet vetëm e vetëm nën hijen e marrëdhënieve mes individit dhe shoqërisë. Po ashtu, duhet thënë se sistemi i vlerave njerëzore,

dashuria, respekti, sakrificat, bashkëpunimi, etj; nuk mund të shfaqen veçse kur njeriu është në mesin e shoqërisë.

Më poshtë po japim disa rregulla të cilat zbulojnë përmbajtjen shoqërore në Sheriatin islam:

Namazi me xhemat

Në pamje të parë, namazi – i cili është simboli i adhurimit dhe i nënshtrimit ndaj All-llahut (xh.sh.)- duket si veprim vetjak, ku çdo besimtarë e kryen në veçanti, për të fituar kënaqësinë e All-llahut dhe shpërblimin e Tij. Sheriati islam i jep aq shumë përparësi namazit me xhemat, sa që e quan (atë) burim të rëndësishëm.

Në Kur'an thuhet: ***“Falenë namazin, jepni zekatin dhe përkuluni me të përkulurit.”***⁽¹⁾

⁽¹⁾ (Surja “Bekare”: 43.)

Në çdo betejë, edhe pse situata ishte e ndërlikuar dhe kërkonte mbikëqyrje të lëvizjes së armikut, Profeti (s.a.s.), e falte namazin me xhemat. Në një hadith të Profetit (s.a.s.) thuhet: ***“Atij, që nuk falet në xhami me myslimanët, nuk i pranohet namazi përveçse kur ka një shkak që e pengon të shkojë në xhami.”***⁽²⁾

⁽²⁾ (El-Vesail: vëll.8, f. 293)

Nisur nga kjo, dijetarët e fesë në librat e tyre të jurisprudencës thonë se është faj i madh për atë mysliman që mungon në namazin me xhemat. Myslimani nuk duhet ta lërë namazin me xhemat pa asnjë arsye. Gjithashtu edhe kur për ndonjë arsye namazi falet pa xhemat, ka një dobi shoqërore, e cila është e mishëruar në këndimin e sures “Fatiha”, kur falësi thotë: “Ty të adhurojmë dhe tek Ti mbështetemi” dhe kur jep selamin në fund të namazit duke thënë: “Paqja qoftë mbi ne dhe mbi robtë e Tu të mirë!” Janë thënie të cilat e bëjnë individin të përjetojë ndjenjën e shoqërisë edhe në faljen e namazit pa xhemat.

Namazi i Xhumasë

Islami e ka bërë detyrim (farz) këtë namaz. Myslimani e fal atë në vend të namazit të drekës. Për namazin e xhumasë ka kumtime transmetime të rëndësishme. Ai është ibadet që kryhet vetëm e vetëm me xhemat. Përveç namazit, imami mban hytben. Nëpërmjet saj ai flet për çështjet e individit e të shoqërisë dhe i nxit myslimanët të kryejnë detyrat shoqërore

Urdhërimi në të mira dhe ndalimi nga të këqijat

Për arsye të këtyre dy veprave ymmeti (bashkësia) islam u bë prej ymmeteve më të mira. All-llahu (xh.sh.) thotë në Kur'an: ***“Ju jeni populli më i dobishëm, i ardhur për të mirën e njerëzve, të urdhëroni për mirë, të ndaloni nga veprat e këqija dhe të besoni All-llahun. E, sikur ithtarët e librit të besonin drejt, do të ishte shumë më mirë për ta. Disa prej tyre janë besimtarë, po shumica e tyre janë larg rrugës së Zotit.”***⁽¹⁾

⁽¹⁾ (Surja “Ali Imran”: 110).

Ka mjaft ajete dhe kumtime të përcjella nga Profeti Muhammed (s.a.s.), të cilat flasin për domosdoshmërinë e këtyre dy veprave dhe që nxisin për kryerjen e tyre. Baza e ligjshmërisë së tyre është mbrojtja e shoqërisë nga imoraliteti dhe shmangia nga rruga e drejtë.

Khumsi dhe Zekati

Këto janë dy detyra (farze) shoqërore të cilat Islami i ka caktuar për të pasurit. Për të dyja këto farze Islami ka vendosur një sistem të posaçëm dhe ato i ka bërë një të drejtë për shoqërinë dhe për të varfërit e saj.

Zekati gjithmonë në Kur’an përmendet i shoqëruar me namazin. Në shumë ajete që flasin për faljen e namazit shohim thirrjen për dhënien e zekatit. All-llahu (xh.sh) thotë në Kur’an: **“Faleni namazin dhe jepeni zekatin dhe përkuluni me të përkulurit.”**⁽¹⁾

⁽¹⁾(Surja “Haxh”: 41)

Ato që u përmenden më lart nuk janë veçse një prej mirësive të rregullave shoqërore në Sheriatin Islam. Xhihadi (sakrifica), uniteti shoqëror, bashkëpunimi me përkushtim, përkujdesja për jetimët, ndihma për të varfërit, janë të tjerë shembuj prej ligjeve e rregullave shoqërore në islam.

Nga këtu, themi se Islami vizaton për ithtarët e tij rrugën drejt lumturisë dhe përsosurisë nëpërmjet bashkëpunimit shoqëror, mbi bazën e dashurisë mes besimtarëve dhe marrëdhënieve të përgjithshme shoqërore. Nëse besojmë në të gjitha këto, atëherë duhet të pranojmë:

Së pari: Për anëtarët e shoqërisë ka të drejta dhe detyra kundrejt njëri-tjetrit.

Së dyti: Qenia e një sistemi të ngritur mbi bazat morale dhe rregullat shoqërore përcakton pozitën e shoqërisë dhe të drejtat e individit

Nëse individit nuk i plotëson detyrat e tij kundrejt shoqërisë, kjo do të çojë në humbjen e të drejtave shoqërore. Për këtë do të flasim në mësimet e ardhshme që kanë të bëjnë me ta dhe me detyrat që përcaktojnë marrëdhëniet mes individit dhe shoqërisë.

Përmbledhje

- Përsosuria e njeriut sipas Islamit arrihet me afrimin tek All-llahu.
- Nëse besojmë se çdo gjë do të zhduket, me përjashtim të All-llahut, atëherë mbështetja tek Ai është e vetmja siguri për të arritur përsosurinë. Vërtet, Kur’ani e përcakton këtë përsosuri në dy kushte:
 - a- Vepra e mirë
 - b- Njësisshmëria e Krijuesit dhe çiltërsia në adhurim.

Këto dy kushte mund të realizohen vetëm e vetëm me zbatimin e urdhrave të All-llahut e të këshillave të Sheriatit, me sistemimin e marrëdhënieve shoqërore islame dhe jo me mënjanim nga shoqëria

Pyetje

- 1- Çfarë do të thotë kërkim i përsosurisë së natyrshme?
- 2- Përmendni kushtet që ka vendosur Islami për të arritur lumturinë e vërtetë.
- 3- Përse përkufizohet arritja e lumturisë së vërtetë në marrëdhëniet shoqërore?
- 4- Përmendni një thënie të Profetit rreth namazit me xhemat.
- 5- Përmendni një ajet nga Kur'ani, i cili flet për domosdoshmërinë e urdhërimit në të mira dhe ndalimit nga të këqijat.
- 6- Përse Zekati dhe Khumsi kanë pozitë të lartë në Islam?

Mësimi 2

VËLLAZËRIA ISLAME

Hapi i parë që ndërmori Profeti ynë Muhammedi (s.a.s.) pasi mbërriti në Medine Munovereh (në Medinen e ndritur), qe futja e ndjenjës së dashurisë dhe të dhimbshurisë në mesin e myslimanëve ensarë (përkrahësve) dhe muhaxhirë (ardhësit). Këtë e bëri duke vëllazëruar një ensar me një muhaxhir. Vërtet, ky veprim i bekuar ndikoi shumë në forcimin e marrëdhënieve shoqërore, duke zhdukur zakonet e hakmarrjes e të fanatizmit injorant dhe duke i zëvendësuar ato me dashurinë, respektin dhe vëllazërinë islame, duke i bërë ata edhe një ymmet të përbashkët. Islami i zhdukuri të gjitha ngjyrat e epërsisë e të dallimit mbi bazë fise, race, pozite dhe pasurie.

Individët e shoqërisë islame janë të barabartë në detyra e në të drejta. Vlerësimi se kush është më i mirë u bë devotshmëria ndaj All-llahut (xh.sh.). Në ajetin 13 të sures "Huxhurat" thuhet: ***"O njerëz! Ne ju krijuam prej një mashkulli dhe prej një femre dhe ju bëmë në fise e në kombe, që të njiheni. Më i miri ndër ju tek All-llahu është ai që është më i devotshëm. Vërtet, All-llahu është i Ditur dhe i Mirinformuar."*** Kjo veti e re është mirësi nga All-llahu (xh.sh.) për të bërë që në gjithë njerëzinë të sundojë paqja dhe dashuria.

Në suren "Ali Imran", ajeti 103 All-llahu thotë: ***"Dhe kapuni që të gjithë ju me litarin (fenë dhe Kur'anin) e All-llahut, e mos u përçani! Kujtoni begatinë e All-llahut ndaj jush, kur ju (para se të pranoni fenë islame) ishit të armiqësuar, e Ai bashkoi zemrat tuaja dhe ashtu me dhuntinë e Tij aguat të jeni vëllezër. Madje, ishit në buzë të greminës së Xhehenemit, e Ai ju shpëtoi prej tij. Kështu All-llahu jua sqaron argumentet e veta, që ju të udhëzoheni."***

Ka shumë hadithe të Profetit (s.a.s.) dhe të familjes së tij, të cilat flasin rreth vëllazërisë mes myslimanëve duke e konsideruar atë një lidhje të fuqishme për unitetin e shoqërisë dhe për forcimin e marrëdhënieve mes individëve si edhe një mundësi për të marrë shpërblim në Ditën e Gjykimit.

Profeti Muhammed (s.a.s.) ka thënë: ***"All-llahu do ta lartësojë cilindo që vëllazëron një vëlla për hir të All-llahut, deri në ato shkallë, të cilat ai nuk mund t'i arrijë me punët që bën."***⁽¹⁾ ⁽¹⁾ ("El-Hakaik": 318)

Dhe: ***"Në Ditën e Gjykimit, për një grup njerëzish do të shtrohen karrige rreth Arshit dhe fytyrat e tyre do të jenë të ndritura si hëna e plotë. Atë ditë, kur njerëzit janë të frikësuar, ata nuk frikësohen. Ata janë eulijatë (njerëzit e mirë) e All-llahut"***

të cilët as nuk frikësohen e as nuk zemërohen.” E pyetën të Dërguarin (s.a.s.): *“Cilët janë ata, o i Dërguari i All-llahut?”* Ai tha: *“Do të jenë ata që e donin njëri-tjetrin për hir të All-llahut.”*⁽²⁾

⁽²⁾ (Ibjaul Ulum “Ringjallja e dijeve”: kreu “Rregullat e shoqërimit e të bashkëjetesës”)

Dhe: *“Vërtet, All-llahu ka thënë: Dashurinë Time e meritojnë ata që vizitojnë njëri-tjetrin për Mua, ata që ndihmojnë për Mua, për ata që duan njëri-tjetrin për Mua, për ata që u japin të tjerëve për Mua.”*⁽³⁾

⁽³⁾ (“Musned ibn Hanbel”: vëll. 4 f.386).

Përcillet nga imam Sadiku (a.s) se një ditë i Dërguari i All-llahut i pyeti sahabet, shokët e tij: *“Cila është vepra më e mirë?”* e ata thanë: *“All-llahu dhe i dërguari i Tij janë më të ditur.”* Disa të tjerë thanë: *“Namazi”*, disa thanë: *“Zekati”*, disa thanë: *“Agjërimi”*, disa thanë *“Haxhi”* dhe *“Umra”* disa thanë *“Xhihadi”*. I Dërguari i All-llahut tha: *“Në të gjitha ato që thatë ka mirësi por nuk është ajo për të cilën unë pyeta. Nyja më e fortë e besimit është dashuria për All-llahun dhe urrejtja për atë që urren All-llahu, dashuria e eulijave (njerëzit e mirë) të All-llahut dhe urrejtja për armiqtë e All-llahut.”*⁽⁴⁾

⁽⁴⁾ (“Biharul Anvar: vëll. 69, f. 242)

Përderisa të gjitha veprimet islame janë për All-llahun, atëherë edhe dashuria dhe urrejtja janë prej bazave të fesë. Në disa hadithe ato quhen prej bazave të fesë kur janë për All-llahun. Vëllazëria islame nuk është tjetër veçse dashuri mes myslimanëve për hir të All-llahut. Kur’ani Kerim thotë: *“Besimtarët janë vëllezër”*⁽¹⁾

⁽¹⁾ (Surja “Huxhuratë”: 1).

Kjo vëllazëri ngrihet mbi besimin e plotë në All-llahun (xh.sh.) dhe në përluljen (bindjen) ndaj Tij. Pa këtë besim, çështjet materiale janë të kota dhe të pavlerë. Vërtet, ka nga ata të cilët e duan një pasanik një njeri me pozitë, e i shfaqin atij dashurinë dhe respektin nga frika, nga lakmia, ose për postin që ai ka. Por kjo dashuri është e lëkundshme dhe jo e vazhdueshme sepse: kur ata arrijnë të marrin atë që duan prej pasurisë së tij, apo të përfitojnë nga pozita e tij, apo..., ato marrëdhënie do të shpëputen e do të mbarojnë, pra, i dashuri i djeshëm sot bëhet i urryer. Nuk është e tillë dashuria vëllazërore islame; ajo është e vazhdueshme dhe e palëkundshme; ajo nuk njih mbarim sepse themeli i saj është i fortë, ajo është e mbështetur mbi vlerat hyjnore e të përhershme.

Për këtë arsye, besëlidhja e vëllazërisë islame i tejkalon të gjithë kufijtë materialë, ajo nuk njih pozitë, prejardhje, ngjyrë e të tjera si këto. Kjo lidhje vëllazërore u duk edhe në fillim të Islamit, kur Profeti ynë, Muhammedi (s.a.s.) ulej në një sofër me të vegjëlit dhe shërbëtorët.

Para Islamit, fiset e Gjirit Arab krenoheshin me numrin e deveve, të fëmijëve, të pasurisë por edhe në numurin e të vdekurve. Ata i jepnin përparësi arabit ndaj joarabit, të bardhit ndaj të ziut. Mirëpo me ardhjen e Profetit tonë, këto dukuri e veprime fanatike të pavlera u zhdukën.

Kur Islami nxit për dashurinë ndaj All-llahut (xh.sh.), këtë e bën për arsye se kjo dashuri ka lidhje edhe me të dashurit dhe eulijatë e Tij, sepse dashuria për eulijatë e All-llahut çon në njohjen e All-llahut.

Këto që u thanë i gjejmë të mishëruara, në suren “Fet’h”, në ajetin 29, i cili thotë: *“Muhammedi është i dërguari i All-llahut dhe ata që e pasojnë atë janë të ashpër ndaj mohuesve (jobesimtarëve) dhe të dashur mes tyre.”*

Marrëdhëniet mes besimtarëve janë të ngrohta e vëllazërore. Këto marrëdhënie i njëson dashuria ndaj All-llahut (xh.sh.), i bën ata të fuqishëm e të ashpër ndaj armiqve të All-llahut. Dashuria ndaj All-llahut përmbushet nëpërmjet dy kushtesh.

E para: Bindja ndaj All-llahut në urdhëresa dhe ndalesa.

Ne i bindemi Atij dhe e falënderojmë Atë, me qëllim që të shprehim dashurinë tonë ndaj Tij. Po ashtu falënderimi shton mirësitë siç thotë All-llahu në Kur'an, ***“Nëse falënderoni, Unë do t’jua shtoj mirësitë.”***⁽¹⁾

⁽¹⁾ (Surja “Ibrahim”: ajeti7).

Mirësitë shtohen deri në atë masë sa që e çojnë njeriun në shkallët më të larta.

E dyta: Nuk ka dyshim se dashuria ndaj All-llahut kërkon të kryhen detyrat shoqërore, të tilla si: respekti për prindërit dhe fitimi i kënaqësisë së tyre, sjellja e mirë me të afërmit, sjellja e mirë me fqinjët, zemërbutësia për të varfërit e të mjerët, urrejta e armiqve të All-llahut etj. Kur’ani Fisnik e ka përcaktuar rregullën e marrëdhënieve, të dashurisë dhe të urrejtjes kur thotë: ***“O ju që besuat, mos i zini miq jobesimtarët e t’i lini anash besimtarët. A doni t’i sillni All-llahut argument të qartë kundër vetës?!”***⁽²⁾ ⁽²⁾ (Surja “Nisa”: 144) dhe:

“O ju që besuat, nëse keni dalë prej vendlindjes për hir të luftës për rrugën Time, duke kërkuar kënaqësinë Time ndaj jush, mos e zini mik armikun Tim dhe armikun tuaj, duke shprehur ndaj tyre dashuri, kur dihet se ata mohuan të Vërtetën që ju erdhi juve ...”⁽³⁾

⁽³⁾ (Surja “Mumtebine”:1).

Mbi këtë themel u përhap besëlidhja e vëllazërisë islame. Ajo është e palëkundur sepse e ka burimin te thelbi i besimit. Kjo besëlidhje është xhevahiri i këtij besimi dhe normë e tij.

Përmbledhje

Hapi i parë që ndërmoi Profeti kur arriti në Medinën Munoverë (Medinën e ndritshme) ishte krijimi i vëllazërisë mes muhaxhirëve (emigrantëve) dhe ensarëve (përkrahësve). Si pasojë u krijuan marrëdhënie dashurie dhe respekti mes myslimanëve.

All-llahu (xh.sh.) e ka bërë devotshmërinë faktorin bazë për përsosurinë dhe lartësimin e njeriut dhe ka përcaktuar bazat e marrëdhënieve shoqërore në përshtatje me dashurinë dhe urrejtjen për hir të All-llahut dhe kjo me qëllim që të realizohen detyrat shoqërore ku ndër to është dashuria për eulijatë e Tij dhe ndërprerja e çdo lloj marrëdhënie me armiqtë e Tij.

Pyetje

- 1- Tregoni rolin e devotshmërisë në Islam duke e argumentuar me ajetin në suren “Huxhuratë.”
- 2- Përmendni një hadith nga Profeti Muhammed (s.a.s.), ku duket rëndësia e vëllazërisë dhe e zemërbutësisë mes myslimanëve.
- 3- Çfarë ka thënë Profeti (s.a.s.) për lidhjen e besimit?
- 4- Cili është qëllimi i Islamit kur na fton që të duam besimtarët dhe eulijatë e All-llahut?
- 5- Çfarë thotë Kur’ani Fisnik për Profetin tonë dhe për përkrahësit e tij?

6-Në ç'themel e ka pikënisjen dashuria dhe urrejtja e besimtarit për hir të All-llahut?

Mësimi 3

TË DREJTAT E PRINDËRVE

Më lart mësuam se Islami është fe shoqërore, e myslimanët i ndërtojnë marrëdhëniet e tyre shoqërore për hir të Zotit dhe për të fituar kënaqësinë e Tij. Dashuria dhe respekti mes tyre ka qëllim të shenjtë dhe lumturia arrihet duke pasuar Islamin, fenë e All-llahut. Vërtet, Islami i ka sqaruar detyrimet, detyrat fetare dhe marrëdhëniet tona shoqërore. Njohja e atyre detyrimeve dhe detyrave dhe obligimeve si dhe vënia e tyre në jetë janë shkak për fitimin e kënaqësisë së All-llahut, e më tej arritja e lumturisë në këtë jetë dhe në jetën e përherëshme (Ahireti). Nëse duam të dimë detyrat tona ndaj të tjerëve, duhet të njohim të drejtat e tyre kundrejt nesh. Në këtë mësim dhe në mësimet e ardhshme do të flasim për të drejtat dhe detyrat më themelore, të cilat duhet t'i di e t'i zbatojë çdo besimtarë. Ky mësim flet për njohjen e të drejtave ndaj prindërve.

1- Respektimi i prindërve

Prej detyrimeve të mëdha në Islam janë detyrat e fëmijëve ndaj prindërve. All-llahu na tregon se respektimi i prindërve vjen fill pas adhurimit të Tij (xh.sh.). Në Kur'an thuhet: *“Zoti yt ka dhënë urdhër të prerë që të mos adhuroni askënd tjetër e asgjë tjetër përveç Tij, që të silleni mirë me prindërit. Nëse njërin prej tyre, ose të dy, i ka kapur pleqëria pranë kujdesit tënd, mos thuaj as “of-oh!”, as mos u bëj i vrazhdë ndaj tyre, po atyre thuaju fjalë të mira (të buta, respektuese). Dhe në shenjë mëshire shtrihe pranë tyre krahun përulës e respektues dhe thuaj: “Zoti im! Mëshiroji ata të dy, siç më rritën mua kur isha i vogël. Zoti juaj e di më së miri atë që keni në shpirtin tuaj. Nëse keni qëllime të mira, vërtet Ai i fal ata që pendohen.”⁽¹⁾ (Surja “Isra”: 23-25).*

Në këto ajete gjejmë teuhidin, për të besuar se All-llahu është Një dhe vetëm Një. E fill pas këtij urdhëri është urdhëri tjetër: Adhuroni Zotin e doni prindërit.

Imam Sadiku (a.s.) sqaron fjalën Ihsan (respekt, mirësi) që përmendet në këtë ajet: *“Ihsan do të thotë të bashkëjetosh me prindërit me mirësi dhe të mos presësh që ata të të thonë për ndonjë nevojë, edhe nëse janë të mjaftueshëm nga ana materiale.”*

Pra, besimtari duhet të respektojë prindërit e tij dhe t'i pyesë ata për nevojat që kanë para se ata t'i thonë atij.

Një njeri e pyeti Profetin Muhammed (s.a.s.): ***“Cila është e drejta e fëmijës ndaj prindërve të tij? Profeti (s.a.s.) tha: “Ata janë Xhenneti dhe Xhehenemi yt.”***⁽¹⁾

⁽¹⁾ (“Targhib dhe Tebdhib”, vëll.3, f.316).

Pra, përfundimi i njeriut në Ahiret varet nga marrëdhëniet e tij me prindërit. Po me të njëjtin kuptim në një hadith tjetër thuhet: ***“Xhenneti është nën këmbët e nënave.”***⁽²⁾

⁽²⁾ (“Kenzul Ummal”, hadithi /45439). Pra është fare e qartë: nëse qëllimi ynë është që të hyjmë në Xhennet, duhet të respektojmë prindërit. Xhenneti ndodhet nën këmbët e tyre dhe respekti për ata është rruga që na çon në Xhennet.

Ka shumë hadithe që flasin për të drejtat e prindërve ndaj fëmijëve; mirëpo, në ato hadithe u jepet më tepër përparësi të drejtave të nënës.

Imam Ali ibn Husejn, në fjalën e tij të njohur, me titullin *“Mesazhi i të drejtave”* thotë: ***“All-llahu e ka bërë detyrë për ty të drejtën për nënën tënde, pastaj të drejtën për babanë tënd e pastaj të drejtat për fëmijët.” “E drejta e nënës kundrejt teje, se ajo të ka mbajtur në barkun e saj, ku askush tjetër nuk mund të mbajë. Ajo të ka ushqyer, të ka mbrojtur me veshin e vet, me sytë e vet, me duart e veta, me këmbët e veta, me lëkurën e vet, me flokët e vet me të gjitha pjesët e trupit të vet. Këtë ajo e ka bërë me gëzim... derisa ajo dorë e fuqishme të nxorri në tokë (të solli në jetë). Ajo e pranoi që ti të ushqeheshe e ajo të rrinte e uritur, ti të visheshe e ajo të rrinte e zhveshur, ti të pije e ajo të rrinte e etur, ...Barku i saj ka qenë për ty shtrati, prehëri i saj ka qenë për ty jeta, gjoksi i saj të shuante ty etjen dhe vetja e saj ka qenë mbrojtësja jote. Ajo duronte të nxehtët dhe të ftohtët për ty...”***⁽¹⁾

⁽¹⁾ (“Mesazhi i të drejtave”)

Kjo paraqitje e mrekullueshme e imam Ali ibn Hysejn, tregon dhembshurinë e nënës. Dhembshuria e nënës është dritë prej mëshirës së All-llahut, prehri i nënës është djep i mbushur me ngrohtësi dhe dashuri, sa që nuk mund të përfytyrohet.

Imam Sexhadi përmend të drejtat e babait: ***“Ndërsa të drejtat e babait tënd kundrejt teje është se duhet të dish se origjina jote është prej tij dhe ti je pjesë e tij...”***⁽²⁾

⁽²⁾ (Risaletul bukuk)

2-Kujdesi për të mos u bërë keq atyre

Më i pakti veprim me anë të të cilit njeriu mund të shprehë “mosrespektin” ndaj prindërve të tij është që të thotë “uf.” Ky veprim, i cili mund të konsiderohet i vogël te njerëzit, tek All-llahu konsiderohet fyerje për prindërit. Në Kur’an thuhet: ***“Zoti yt ka dhënë urdhër të prerë që të mos adhuronit askënd tjetër tjetër e asgjë përveç Tij, që të silleni mirë me prindërit. Nëse njërin prej tyre, ose të dy i ka kapur pleqëria pranë kujdesit tënd, mos u thuaj atyre "of-oh", as mos u bëj i vrazhdë ndaj tyre, por thuaju fjalë të mira (të buta, respektuese).”***⁽³⁾

⁽³⁾ (Surja “Isra”, 23).

Imam Sadiku (a.s.) ka thënë: ***“Mosrespektimi më i pakët është që të bësh “uf!”***⁽⁴⁾

⁽⁴⁾ (“Biharul Anvar”; vëll.74 f, 6)

Nëse “uf!” është prej të ndaluarve (haram), si do të konsideroheshin vallë fjalët ofenduese dhe ngritja e zërit para tyre?!

Nuk duhet të habitemi kur mësojmë se mosrespektimi i prindërve numurohet prej mëkateve më të mëdha, për të cilat njerëzit marrin ndëshkimin e All-llahut (xh.sh.). Profeti Muhammed (s.a.s.) ka thënë: **“S’ka dyshim se prej mëkateve të mëdha (të pafalshme tek All-llahu në Ditën e Gjykimit) janë shirku (t’i bësh shok All-llahut), vrasja e besimtarit pa të drejtë, largimi nga fusha e betejës dhe mosrespektimi i prindërve.”**⁽¹⁾

⁽¹⁾ (“Tergib dhe Terhib”; vëll. 3 f. 327)

Në një hadith tjetër thuhet: **“Mosmirënjohësit ndaj prindërve i thuhet: Bëj çfarë të duash, Unë nuk do të të fal ty.”**⁽²⁾

⁽²⁾ (“Kenzul Ummal”, hadithi/ 25527).

Kuptimi i hadithit është: mosmirënjohja ndaj prindërve dhe mosrespektimi i tyre janë shkak që të mos hysh në Xhennet dhe të mos falesh në Ditën e Gjykimit. Sigurisht, mosrespektimi i prindërve është mëkat si të gjitha mëkatet, por All-llahu (xh.sh.) ka hapur për robtë e Tij portën e pendimit: njeriu të kuptojë se çfarë ka vepruar ndaj prindërve dhe të ndreqë veprat e shkuara.

Dy gjëra duhen pasur parasysh:

1-Rastet e keqtrajtimit dhe mosrespektimit të prindërit.

Profeti Muhammed (s.a.s.) ka thënë: **“Ai që i zemëron prindërit e tij, vërtet është mosrespektues.”**⁽³⁾

⁽³⁾ (Kenzul Ummal; hadithi, 45537).

Imam Sadiku (a.s.) ka thënë: **“Mosrespektim i prindërve është t’i shohësh ata me shikim të vrenjtur.”** (Biharul Anvar, vëll. 73, f. 61).

Ka raste që mosrespektimi arrin deri në gradën delikate kur prindërit i bëjnë ndonjë padrejtësi fëmijës së tyre. Por edhe në këtë rast, fëmija nuk duhet t’i shohë prindërit me vrazhdësi a me përbuzje.

Imam Sadiku (a.s.) ka thënë: **“All-llahu nuk ia pranon namazin cilitdo që i sheh prindërit me shikim përbuzës kur ata i bëjnë padrejtësi.”**⁽⁴⁾

⁽⁴⁾ (Biharul Anvar, vëll.73, f.61).

2- Mosrespektimi i prindërve nuk përkufizohet vetëm me të qenurit e prindërve mysliman, por edhe kur janë jomyslimanë. Ndalimi i mosrespektimit dhe kryerja e detyrave të cilat mishërojnë kuptimin e mirësisë për prindërit, janë të vazhdueshme e të palëkundura. Fëmija mysliman duhet t’i respektojë prindërit e tij në çdo gjë, me përjashtim nëse e udhëzojnë t’i bëjë shirk All-llahut (xh.sh.).

All-llahu (xh.sh) thotë në Kur’an: **“Ne e kemi urdhëruar njeriun për (sjellje të mira ndaj) prindrit të vet, sepse nëna e vet e barti me mundim pas mundimi dhe pas dy vjetësh ia ndau gjirin. (E porositëm) Të jetë mirënjohës ndaj Meje dhe ndaj dy prindërve të tu, sepse vetem tek Unë është kthimi juaj”.**

Dhe, nëse ata të dy përpiqen që ti të më përshkruash Mua shok, për çka ti nuk ke kurrfarë fakti, atëherë mos i respekto ata; por në çështjet e jetës së kësaj bote të kesh mirëkuptim ndaj tyre.”⁽¹⁾

⁽¹⁾ (Surja “Lukman”, 14-15).

Zekeria ibn Ibrahim ka qenë i krishterë pastaj ka përqafuar Islamin në duart e imam Sadikut (a.s.). Një ditë Zekeria e pyeti imamin për një fetva: **“Unë e kam nënën të verbër dhe jetoj me familjen time. Ha e pi prej ushqimit të tyre dhe me enët e tyre. Çfarë rregulle ka për këtë veprim?”** Imami e ka pyetur: **“A e hanë mishin e**

derrit?” Zekerija i ka thënë: “Jo, o zotëria im”. Imami i ka thënë: “Ha me ata dhe mirësoje nënën tënde me sa të mundesh.”

Zekeria u kthye në Kufe, duke e mirësuar të ëmën e i shërbyer shumë asaj. E ushqente me dorën e tij, i lante rrobat, e pastronte etj. Nëna e tij është habitur nga ky veprim i tij. Dhe një ditë e pyeti: *“O biri im, kur ishe në fenë tonë nuk m’i bëje këto që po më bën këto ditë. Vërtet, ti më mirëson, më shërben, më respekton.”* Zekeria iu përgjigj me sjellje e kulturë islame: *“Një njeri prej rrënjës së Profetit më këshilloi për këto veprime.”* Ajo i tha: *“A Profet është ai?”*: *“Jo, o nëna ime, iu përgjigj Zekeria, ai është prej bijve të Profetit dhe është imam.”* Nëna me dashuri i tha: *“O biri im, o Zekerija, mbaje fenë tënde sepse ajo është feja më e përsosur ndër fetë. Më njih me atë fe o biri im.”* Zekeria filloi t’i shpjegojë asaj besimin islam dhe këshillat e All-llahut për pasuesit e kësaj feje të drejtë e të vërtetë. Zemra e nënës u emocionua prej fjalëve të Zekerias dhe përqafoi Islamin. Ajo mësoi të falte namazin. Sa herë që vinin kohët e namazeve, ajo çohet dhe i falte ato. Më vonë u sëmur e ndenji në shtrat. Ajo ndërroi jetë myslimane besimtare dhe xhenazën e saj e përcollën myslimanët dhe u varros në varetat e myslimanëve.

Dhembshuria dhe Mëshira

Në fillim të këtij mësimi lexuam ajetet e sures “Isra”, në të cilat thuhet: *“Dhe, në shenjë mëshire shtrije pranë tyre krahun përulës e respektues dhe thuaj: “Zoti im! Mëshiroji ata të dy, siç më rritën mua kur isha i vogël.”*⁽¹⁾

⁽¹⁾ (Surja “Isra”: 24).

Një thënie kaq e madhe, kaq e hollë e kaq modeste e fëmijëve kundrejt prindërve të tyre.

Imam Sadiku (a.s.) ka thënë: *“Shikoji ata me sy të mbushur me mëshire, mos e ngri zërin tënd mbi zërin e tyre, as dorën tënde mbi duart e tyre e as këmbët tuaja mbi këmbët e tyre.”*⁽²⁾

⁽²⁾ (Biharul Anvar, vëll. 74, f. 39-40). Pastaj, imami sqaron kuptimin e ajetit *“dhe thuaju atyre fjalë të mira”* duke thënë: *“Nëse të rrahin, t’u thuash atyre: “All-llahu ju faltë!”*⁽³⁾

⁽³⁾ (“Usulul Kafj”, vëll. 2, f.158).

Përmbledhje

- Islami është fe shoqërore dhe pasuesit e tij i ndërtojnë marrëdhëniet e tyre shoqërore për hir të All-llahut dhe për të fituar kënaqësinë e Tij. Prandaj, prej detyrave tona të përditshme është që të njohim të drejtat e të tjerëve kundrejt nesh, që të zbatojmë detyrimet tona kundrejt tyre.

- Prej të drejtave në Islam janë edhe të drejtat e prindërve ndaj fëmijëve. Mirësjelljen ndaj tyre All-llahu e ka shoqëruar me adhurimin e Tij (xh.sh.). Profeti ynë Muhammedi (s.a.s.), e ka cilësuar mirësinë për prindërit, si detyrën më të lartë *“Ata janë Xhenneti ynë dhe Xhehenemi ynë”*, thotë Profeti (s.a.s.)

Pra, ne jemi të urdhëruar për mirësi ndaj prindërve, qofshin ata mysliman ose jomysliman.

Pyetje

- 1 - Çfarë thotë Kur'ani Fisnik për mirësinë ndaj prindërve?
- 2- Përmendni hadithin e imam Sexhadit (a.s.) në *"Mesazhin e të drejtave"* për të drejtat e nënës.
- 3- Përmendni një hadith të profetit tonë Muhammedit (s.a.s.) rreth mosrespektimit të prindërve.
- 4- Përmendni rastet e mosrespektimit të prindërve siç thonë hadithet.
- 5- Si e ka sqaruar imam Sadiku (a.s.) kuptimin e ajetit 24 të sures "Isra"?

Mësimi 4

LIDHJET FAREFISNORE

Ndër të drejtat shoqërore, të cilën e dëshmon Islami dhe për të cilin i fton myslimanët është kujdesi për farefisin, për të afërmit lidhjet farefisnore. Kjo do të thotë që çdo myslimani besimtar i kërkohet që të vizitojë të afërmit e tij, të interesohet për ata, t'i respektojë ata, t'i ndihmojë ata që janë nevojtarë, të bashkëpunojë me mirësi e devotshmëri me ta etj.

Nëse ndonjërit i ndodh ndonjë fatkeqësi, të jetë pranë tij. Nëse ndonjëri prej të afërmeve të tij përballet me një problem, të bashkëpunojë për zgjidhjen e atij problemi. Nëse një prej të afërmeve të tij mbart a bën diçka ndonjë gjë të papëlqyeshme ta këshillojë me mënyrat më të përsosura për t'u larguar nga ajo. Fisi, të afërmit, kushërinjtë janë mbështetës për njeriun, sepse, nëse atij i ndodh ndonjë e keqe, ai do t'u drejtohet atyre dhe do të kërkojë përkrahjen e tyre.

Imam Aliu (a.s.) thotë: ***"O njerëz, asnjë njeri nuk mund të jetë i panevojshëm për fisin e tij, - edhe nëse ai është i pasur -, prej mbrotjes së tyre, qoftë me duar apo me gjuhë. Ata janë njerëzit më të fortë për atë. Nëse ndonjë prej jush i gjen të afërmit e vet në skamje dhe të uritur, nuk duhet të jetë dorështërguar në ndihmën e tyre. Kushdo që tregohet dorështërguar për të afërmit e vet, pakëson vetëm një dorë; mirëpo, në kohën kur ai të ketë nevojë për ndihmë, shumë duar do të mbesin të shtërnguara për ta ndihmuar atë. Ai i cili është zemërmirë do të mbesë gjithmonë i dashur në mesin e kombit të tij."*** ⁽¹⁾

⁽¹⁾ ("Nabxhul Belaga"; fjalimi 23).

Në këtë fjalim, imam Aliu paraqet humbjet që vijnë kur një njeri i shkëput marrëdhëniet me fisin dhe me të afërmit e tij. S'ka dyshim se të afërmit humbasin një njeri të vetëm, ndërsa, ndërprerja e lidhjeve me fisin humbet mjaft njerëz. Imami tregon se bashkëjetesa e mirë e njeriut sjell dashurinë e të afërmeve të tij për të dhe se në këtë veprim ka mirësi të shumta. Çdo fis a familje e madhe përbëhet prej disa

anëtarëve. Ata dallojnë në aftësi, në fuqi: ka të fortë nga ana trupore të thjeshtë e të dobët, të ditur e të paditur, me pozitë pa pozitë, mendjemëdhën timer. Vallë, çfarë e ekuilibron dhe e përsos këtë shoqëri?

S'ka dyshim, marrëdhëniet e forta midis të afërmeve të cilat kristalizohen në unitet, ndihmë e bashkëpunim, kur i pasuri vë dorën mbi dorën e të varfërit, kur i forti mbështet të dobët dhe qëndron në krah të tij në rast fatkeqësie. Vërtet, lidhjet farefisnore me të afërmit krijojnë shoqëri të fortë e të palëkundshme. Në moralin Islam ka një detyrë për myslimanët: Ajo është forcimi i marrëdhënieve vëllazërore në mes tyre dhe qortim për shkëputjen e këtyre marrëdhënieve në çdo situatë. Hadithet e përcjella i konsiderojnë prej besimit marrëdhëniet me të afërmit.

Në një hadith të transmetuar nga imam Bakiri, prej baballarëve të tij (a.s.) kumtohet se Profeti Muhammed (s.a.s.) ka thënë: **“Këshilloj ymmetin tim, ata që gjallërojnë dhe ata që kur janë prezent dhe ata që ndodhen në palcat e meshkujve dhe në mitrat e femrave, që do të vijnë deri në Ditën e Gjykimit, që të mos i shkëpusin marrëdhëniet farefisnore.”**⁽¹⁾

⁽¹⁾ (“Biharul Anvar”; vëll. 74, kreu i marrëdhënieve farefisnore)

Kurse imam Zejnul Abedin (a.s.) ka përcjellë një thënie tjetër nga Profeti (s.a.s.): **“Ai që dëshiron që All-llahu t'i dhurojë jetëgjatësi e mirësi në jetën e tij, të mbajë marrëdhëniet e mira me të afërmit e tij, sepse ato (marrëdhëniet) do të dëshmojnë në Ditën e Gjykimit.”**⁽²⁾

⁽²⁾ (“Biharul Anvar”; vëll. 74, kreu i marrëdhënieve farefisnore)

Në një kumtim tjetër thuhet se Profeti Muhammed (s.a.s.), ka thënë: **“Ai që më garanton një (mbajtjen e lidhjeve farefisnore), unë i garantoj atij katër: All-llahu do ta dojë atë, do t'ia zgjerojë mirësitë, do t'ia shtojë jetëgjatësinë dhe do ta fusë në Xhennetin e premtuar.”**⁽³⁾

⁽³⁾ (“Biharul Anvar”; vëll. 74, kreu i marrëdhënieve farefisnore)

Në një transmetim tjetër thuhet: **“Marrëdhëniet farefisnore pastrojnë veprat, shtojnë pasurinë, largojnë të këqijat ...”**⁽⁴⁾ (“Biharul Anvar”; vëll. 74, kreu i marrëdhënieve farefisnore)

Në këto marrëdhënie gjenden feja, besimi, jetëgjatësia, mirësi të shumta, dashuria e All-llahut, kënaqësia e Tij dhe Xhenneti. Mbajtja e lidhjeve farefisnore i garanton njeriut jetë të lumtur në këtë botë, kënaqësinë e All-llahut (xh.sh.), ndriçim në Ahiret dhe shpërblimin me Xhennet.

Nëse e njohim rëndësinë e lidhjes farefisnore, a është e drejtë të thuhet se largësia dhe punët e shumta qenkan shkak i shkëputjes së marrëdhënieve me të afërmit? Sigurisht që jo. Profeti ynë dhe anëtarët e familjes së tij të nderuar u tregojnë besimtarëve myslimanë rrugën e ndritur të cilën e pëlqen All-llahu (xh.sh.).

Në një hadith thuhet se dikush u ankua tek Profeti (s.a.s.) për dëmet e fisit të vet ndaj tij. Për këtë ai e kishte pa të arsyeshme që të mënjanohej prej tyre dhe t'i ndërpresë marrëdhëniet me ta. Profeti (s.a.s.) i tha: **“All-llahu qoftë i zemëruar me ty”. Ankimtari e pyeti: “Çfarë të bëj, o i Dërguar i All-llahut?” Profeti i tha: “T'i japësh atij që nuk të jep dhe të mbash lidhje me atë që t'i ndërpret e të bën padrejtësi. Nëse vepron kështu, All-llahu do të të përkrahë ty ndaj atyre.”**⁽¹⁾

⁽¹⁾ (“Thjaul Ulum”; kitabul muasheretu dhe subbetu)

Imam Aliu (a.s.) ka thënë: **“Mbani lidhje me të afërmit tuaj edhe nëse ata i ndërpresin marrëdhëniet me ju.”**⁽²⁾

⁽²⁾ (“Biharul Anvar”; vëll. 74, kreu i marrëdhënieve farefisnore, f. 404)

Imam Sadiku (a.s.) ka thënë: **“Vërtet, lidhja farefisnore dhe mirësjellja (me të afërmit), lehtësojnë llogarinë dhe janë mbrojtëse prej gjynaheve. Prandaj, mbajini lidhjet me fiset tuaja dhe silluni mirë me vëllezërit tuaj, qoftë edhe me përshëndetje të çiltërt dhe kthimin e saj (përshëndetjes).”**⁽³⁾

⁽³⁾ (“Biharul Anvar”; vëll. 74, kreu i marrëdhënieve farefisnore, f. 404)

Profeti Muhammed (s.a.s.) ka thënë: **“Mbajini lidhjet farefisnore qoftë edhe me Selam.”**⁽⁴⁾

⁽⁴⁾ (“Biharul Anvar”; vëll. 74, kreu i marrëdhënieve farefisnore, f. 404)

Dhe: **“Mbajeni lidhjet farefisnore qoftë edhe me një gllënkë uji. Mënyra më e mirë për mbajtjen e lidhjeve farefisnore është të mos iu bëhet keq atyre (të afërmve).”**⁽⁵⁾

⁽⁵⁾ (“Biharul Anvar”; vëll. 71, f.88, 103,117)

Nëpërmjet këtyre haditheve del në pah domosdoshmëria e lidhjes farefisnore. Nëse nuk mund ta vizitosh të afërmin tënd për shkak të largësisë, ndoshta dërgimi i një letre dhe telegrafi do t’i mbajë të forta marrëdhëniet mes jush. Një përshëndetje e çiltërt për të afërmit ose për fisin tënd, gjithashtu është prej mbajtjes së lidhjeve farefisnore. Edhe një gotë ujë është një ngjyrë prej ngjyrave të mbajtjes së lidhjeve farefisnore. Të mos u bësh keq të afërmve të tu është një mënyrë për të mbajtur lidhjet farefisnore dhe këtë Profeti e ka quajtur si gjënë më të përsosur.

Ndërprerja e lidhjes farefisnore

Deri tani u njohëm me mbajtjen e lidhjeve farefisnore dhe marrëdhëniet e mira me të afërmit dhe përmendëm se kjo është prej domosdoshmërive të fesë. Tani le të njohim se çfarë ndikimesh ka në jetën e myslimanit nëse ai këput marrëdhëniet farefisnore.

All-llahu (xh.sh.) thotë në Kur’an: **“A pritet prej jush (dyfytyrakëve) që nëse merrni sundimin (ose zëmbrapseni prej fesë islame) të bëni trazira në tokë dhe të ndërprisni lidhjet farefisnore?”**⁽¹⁾

⁽¹⁾ (Surja “Muhammed”, 22).

Dhe: **“Ata që e thyejnë besën e dhënë All-llahut pasi është lidhur ajo dhe e këpusin atë që All-llahu ka urdhëruar të jetë e kapur, e bëjnë edhe shkatërrime në tokë, janë të dështuarit.”**⁽²⁾

⁽²⁾ (Surja “Bekare”, 27).

All-llahu (xh.sh.), ka bashkëshoqëruar ndërprerjen e lidhjeve farefisnore me shkatërrimin në këtë tokë kur thotë: **“Ju shpresoni për shpëtim dhe në të njëjtën kohë ju jeni shkatërrues, ndërprisni marrëdhëniet me njëri-tjetrin dhe me të afërmit tuaj, për të cilat All-llahu ju ka urdhëruar që t’i mbani e t’i forconi ato.”** Hadithet e përcjella për këtë çështje sqarojnë disa pasoja të rënda që vijnë kur shkëputen lidhjet farefisnore.

Profeti Muhammedi (s.a.s.) ka thënë: **“Vërtet, mëshira nuk zëbret në atë komb në të cilin ndërpriten lidhjet farefisnore.”**⁽¹⁾

⁽¹⁾ (“Kenzul Ummal; hadithi/6978)

Imam Bakiri (a.s.) ka thënë: “Në një prej haditheve të Profetit (s.a.s.) kemi gjetur thënien: **“Nëse ndërpriten marrëdhëniet farefisnore, pasuritë kalojnë në duart e të këqijëve.”**⁽²⁾ ⁽²⁾ (“Biharul Anvar”; vëll.70, f.369)

Imam Aliu (a.s.) ka thënë: *“Njeriu që mbart tri veti, ai nuk vdes derisa të shohë vuajtjet e tyre. Ato veti janë: imoraliteti, ndërprerja e marrëdhënieve farefisnore dhe betimi i rremë (betimi në Allahun)”*⁽³⁾

⁽³⁾ (“Biharul Anvar”; vëll.71, f.134 dhe vëll. 72, f. 274)

Sipas këtyre haditheve mëshira e All-llahut nuk i përfshin ata që shkëpusin lidhjet farefisnore. Po u përhap në një popull ky veprim kaq negativ, pasuritë e tij kalojnë në duart e të këqijve. Lidhjet farefisnore, sigurojnë bashkëpunimin vëllazëror. Nëse shkatërrohen këto lidhje vjen shkatërrimi, humbet ndjenja e përgjegjësisë dhe ua lehtëson të këqijve sundimin mbi shoqërinë dhe mbi pasuritë e saj. Mbajtja e lidhjeve farefisnore është prej veprave të mira, rezultatit e të cilës njeriu e sheh në këtë jetë. Sepse ai që ndërpret marrëdhëniet me të afërmit dhe me fisin e tij, është njësoj sikur ka mbjellë gjemba, produkt i të cilëve janë po gjembat. Vërtet, ai që mbjell të keqen do të korrë të keqen dhe humbjen.

Përmbledhje

Prej detyrave dhe të drejtave të domosdoshme islame është mbajtja e lidhjeve farefisnore dhe marrëdhëniet e mira me të afërmit. Lidhje farefisnore do të thotë bashkëpunim, garanci dhe përkujdesje mes njerëzve të afërm jo vetëm me fisin, pjesëmarrje në gëzime e në hidhërimet etj. Ndërprerja e lidhjeve farefisnore sjell humbje në këtë jetë dhe pendim në jetën tjetër.

Pyetje

- 1- Çfarë do të thotë “lidhje farefisnore?”
- 2- Sqaroni mënyrat e lidhjes farefisnore sipas haditheve.
- 3- Përmendni një hadith të Profetit (s.a.s.) rreth lidhjes farefisnore
- 4- Përmendni një hadith të imam Rizait (a.s.) rreth lidhjes farefisnore.
- 5- Përmendni një ajet i cili flet për ndërprerjen e lidhjeve farefisnore.
- 6- Përmendni një hadith të transmetuar nga imam Bakiri dhe nga imam Aliu rreth disa cilësive të këqija.

Mësimi 5

TË DREJTAT E FQINJIT

Sheriati islam kërkon marrëdhënie të mira me fqinjët dhe e ka bërë këtë pjesë të pandarë të fesë e të besimit.

Këtë urdhër të All-llahut e gjejmë në ajetin 36 të sures "Nisa": ***“Adhurojeni All-llahun e mos i bëni Atij asnjë ortak, silluni mirë me prindërit, me të afërmit, me jetimët, me të varfërit, me fqinjën e afërt me fqinjën të largët, me shokun pranë vetes, me udhëtarin e largët dhe me robërit. All-llahu nuk e do atë që është kryelartë dhe atë që lavdërohet.”*** Profeti Muhammed (s.a.s.) ka thënë: ***“Xhebraili më porosiste shpesh për fqinjët derisa arrita të mendoj se ai (fqinji) do të ishte trashëgimtari im.”*** ⁽¹⁾

⁽¹⁾ (“Kenzul Ummal”; hadithi/ 24913)

Imam Sadiku (a.s.) ka thënë: ***“Silluni mirë me fqinjët tuaj sepse All-llahu (xh.sh) ka urdhëruar për këtë.”*** ⁽²⁾

⁽²⁾ (“Biharul Anvar”; vëll. 69, kreu 38 f. 11)

Imam Aliu (a.s.) në testamentin e tij ka thënë: ***“Ju betohem në All-llahun për fqinjin tuaj, sepse ai (fqinji) është porosi e Profetit tuaj i cili gjithmonë na porosiste për atë derisa mendonim se (fqinji) do të ishte trashëgimtari ynë.”*** ⁽³⁾

⁽³⁾ (“Biharul Anvar”; vëll. 71 f. 153).

Këto dy hadithe e ngrejne respektin për fqinjin në një pozitë të lartë.

Më poshtë po japim disa hadithe, të cilat njëkohësisht janë edhe këshilla të të Dërguarit Islam.

Profeti Muhammed (s.a.s) ka thënë: ***“Fqinjësia më e mirë është ajo besimtare.”*** ⁽⁴⁾

⁽⁴⁾ (“Biharul Anvar”; vëll. 71 f. 116).

Dhe: ***“Shenjtëria e fqinjit ndaj njeriut është njësoj si shenjtëria e nënës së tij.”*** ⁽⁵⁾

⁽⁵⁾ (“Biharul Anvar”; vëll. 71 f. 153).

Dhe: ***“I bekuar është ai që sillet mirë me të afërmit dhe me fqinjin mysliman. Nuk më ka besuar mua ai njeri i cili flen i ngopur, kur fqinji i tij mysliman është i uritur.”***⁽¹⁾

⁽¹⁾ (“Biharul Anvar”; vëll. 71 f. 151).

Një burrë shkoi te Profeti (s.a.s.) për t’i dhënë sihariqin për blerjen e shtëpisë.

Profeti i tha: ***“Fqinji pastaj shtëpia, shoku para udhëtimit.”***⁽²⁾

⁽²⁾ (“Mizān ul Hikmetu”; kreu 64)

Në librin “El-Ether” thuhet: I Dërguari i All-llahut u tha shokëve të tij: ***“A i dini të drejtat e fqinjit?”*** Ata thanë: “Jo.” Ai u tha: ***“Kur të të kërkojë ndihmë, ndihmoje; po të të kërkojë borxh, jepi; po t’i vijë atij të mira ta urosh; po u sëmur, ta vizitosh; po t’i bjerë ndonjë fatkeqësi, ta ngushëllosh; kur të vdesë, ta shoqërosh xhenazën e tij; mos e ndërto murin të lartë, që t’ia pengosh atij ajrin pa lejen e tij; nëse blen fruta dhuroji atij prej tyre; nëse nuk i jep haptasi, dërgoja fshehurazi; mos i nxirr fëmijët e tu me fruta në dorë, sepse u thyhet zemra fëmijëve të tij dhe jepi prej mirësive që të të është dhënë ty.”***⁽³⁾

⁽³⁾ (“Biharul Anvar”; vëll. 79 kreu i ngushëllimeve)

Në librin “Risālet ul Hukuk” të imam Zejn ul Abidinit (a.s.) thuhet: ***“E drejta jote për fqinjin tënd është ta mbrosh atë kur nuk është i pranishëm; dhe nderimi kur është i pranishëm; ta përkrash nëse i bëhet padrejtësi; mos ia zbulojë të keqijat kur i di ato, por mbuloja; nëse e pranon këshillën tënde, këshilloje veças të tjerëve; mos e lër atë në vështirësi; falja gabimet dhe fajet; të silleni mirë me të.”***⁽⁴⁾ ⁽⁴⁾ (“Biharul Anvar”; vëll. 71 kreu i të drejtave, f. 7)

Imam Hasani (a.s.) kur ishte i vogël, e shihte nënën e tij, zonjën Fatime Zahra (a.s.), të ngrinte duart dhe të lutej për fqinjët e saj duke i përmendur një nga një, kur falej natën. (këtë e bënte natën e xhuma). Një ditë ai e pyeti atë: ***“O nënë, përse nuk lutesh për veten tënde?”*** Zonja e grave të botëve i tha: ***“O biri im, në fillim fqinji pastaj shtëpia.”***⁽⁵⁾

⁽⁵⁾ (“Biharul Anvar”; vëll. 43, f. 81, 86, 313.)

Pa dyshim, nëse njeriu do ta përsosë jetesën me fqinjët e tij, atij do t’i shtrojnë urën e dashurisë e të respektit dhe do të garojnë për t’i shërbyer atij. Fqinjësia e përsosur bën që njerëzit të flasin mirë për atë njeri dhe kështu rrethi i marrëdhënieve të mira mes njerëzve do të zgjerohet edhe më shumë. Respektimi i fqinjëve ka ndikime të bekuara në jetën e njerëzve. Ai shton mirësitë dhe jetëgjatësinë, siç thuhet në një hadith: ***“Fqinjësia e mirë ndërton familje dhe zgjat jetën.”***⁽¹⁾

⁽¹⁾ (“Usul ul Kafi”; vëll. 2 f. 667, kreu, të drejtat e fqinjit)

Keqtrajtimi i fqinjit

Islami i kundërshton të gjitha veprimet dhe sjelljet që çojnë në keqtrajtimin e komshijve. Respektin për fqinjët Islami e ka bërë prej besimit në All-llahun (xh.sh.) e në Ditën e Gjykimit.

Profeti ynë Muhammedi (s.a.s.) ka thënë: ***“Cilido që beson në All-llahun e në Ditën e Gjykimit, të mos e keqtrajtojë fqinjin e tij.”***⁽²⁾

⁽²⁾ (“Biharul Anvar”; vëll. 43, kreu 3 f. 61)

Një burrë prej Ensarëve (përkrashës) shkoi te Profeti (s.a.s.) e i tha: “O i Dërguari i All-llahut! Unë kam blerë një shtëpi dhe kam një fqinj, nga i cili nuk shpresoj të mira dhe nuk jam i sigurt prej sherrit të tij”. I Dërguari i All-llahut ftoi katër veta: Aliun,

Selmanin, Ebu Dherin dhe Mikdadin. I urdhëroi ata që të thoshin me zë të lartë në xhami: **“Nuk është besimtar ai, i cili i bën keq fqinjët të tij.”** ⁽³⁾ ⁽³⁾ (“*El-Vesail*”; vëll. 12, f. 125 *kreu: Mënjanimi i të bërit keq fqinjët*)

Një njeri shkoi te Profeti Muhammed (s.a.s.) dhe iu ankua atij për fqinjin e vet. Profeti (s.a.s.) i tha: **“Duro!”** Për të dytën herë Profeti i tha **“Duro!”** Njeriu erdhi për të tretën herë te Profeti (s.a.s.). ***Këtë herë Profeti e urdhëroi që t'i nxjirrte pajisjet prej shtëpisë e të ulej në anë të rrugës. Po ta pyesnin njerëzit se çfarë i kishte ndodhur, ai t'ua tregonte atyre si e keqtrajtonte fqinji i vet. Kur fqinji keqbërës e pa këtë veprim të tij i hyri frika se do të poshtërohej. Ai i'u afrua fqinjët i kërkoi falje dhe iu lut që të kthehej në shtëpinë e tij, duke i premtuar se do të sillej mirë me të gjithnjë.”***

Mes respektit dhe keqtrajtimit gjendet një tjetër pikë e kjo është mosinteresimi për fqinjin. P.sh, një person nuk interesohet për fqinjin e tij ka të hajë apo jo, a është i gëzuar apo i hidhëruar etj.

Profeti Muhammed (s.a.s.) ka thënë: **“Nuk është besimtar ai njeri që fle i ngopur kur fqinji i tij është i uritur.”** ⁽¹⁾

⁽¹⁾ (“*Kenzul Ummal*”; *hadithi 24929*)

Në këtë hadith duket qartë thirrja për tu kujdesur për fqinjët e varfër.

Cili është kufiri i largësisë që përcakton se dikush është fqinji yt? Këtë e gjejmë në hadithin e imam Aliut (a.s.): **“Kufiri i xhamisë 40 dhira (afërsisht 20-28 metra) dhe i fqinjësisë 40 shtëpi nga katër anët.”** ⁽²⁾

⁽²⁾ (“*Bibarul Anvar*”; vëll. 77, *kreu 7*)

Dijetarët e Islamit, duke ndjekur jetën e Profetit dhe të Imamëve prej familjes së tij, kanë qenë dhe janë shembulli më i lartë i mirësjelljes me fqinjët.

Teologu i madh, Sejid Xhevad El-Amilij përcjell një ngjarje që i ka ndodhur atij:

Një natë po haja darkë. Në atë çast trokiti dera. Kur e hapa derën pashë shërbyesin e profesorit tim, Alametun Bahrul Ulum. Ai më tha; Profesori të fton që të hani darkë së bashku. Me shpejtësi veshja rrobat për të shkuar tek ai. Kur hyra në dhomën e tij, vura re në fytyrën e tij zemërim të madh. Ai më tha: A nuk i frikësohesh All-llahut? A nuk ke turp nga All-llahu? I habitur, thashë: A kam bërë ndonjë gjë? Ai tha: “Fqinji yt, filani dhe familja e tij po vdesin urie që prej shtatë netësh. Ata nuk kanë ushqim tjetër përveç hurmave që i blejnë me çmim të lirë e me borxh te shitësi i frutave. Sot shitësi nuk u dha atyre hurma se shumica e borxhit është shtuar dhe ata sonte janë pa ushqim. Unë i thashë: O profesori im, betohem në All-llah se unë nuk e kam ditur këtë gjë. Sikur ta dija gjendjen e tyre, unë do t'i ndihmoja. Profesori i tha: Unë jam i hidhëruar se si ti nuk e di gjendjen e fqinjët tënd? Si ka mundësi që ata të kalojnë shtatë net të uritur e ti të mos e dish? Sikur ti ta kishe ditur gjendjen e tyre e nuk ke bërë asgjë për ta, ti nuk do të ishe mysliman por do të ishe jahudi. Pastaj profesori urdhëroi shërbëtorin e tij që të merrte ushqimin; më urdhëroi edhe mua që ta shoqëroja për tek shtëpia e atij fqinjët. Profesori më tha: “Merr këtë ushqim e shko tek ai dhe i thuaj: Kam ardhur që të ha darkë sonte në shtëpinë tënde.” Merre edhe këtë shumë parash dhe lëri nën qilim.”

Kjo ngjarje tregon se Al-lame Bahrul Ulum interesohet jo vetëm për gjendjen e fqinjëve të tij, por pyeste edhe për fqinjët e nxënësve të tij.

Përmbledhje

Mirësjellja me fqinjët është prej atyre vlerave, të cilën feja islame e nxit dhe e ka bërë prej moraleve të larta. Profeti ynë dhe familja e tij e pastër e dëshmojnë dhe e vërtetojnë këtë. Ndikimet e mira që sjell mirësjellja me fqinjin, janë shtimi i mirësive, jetëgjatësia, mbarësia, etj.

Hadithet tregojnë se keqtrajtimi i fqinjit dhe mosinteresimi për gjendjen e tij, janë shkak i zemërimit të All-llahut. Ai njeri që sillet keq me fqinjin e vet, nuk është besimtar.

Pyetje

- 1- Thoni një hadith të Profetit (s.a.s.) për mirësjelljen ndaj fqinjit.
- 2- Cilat janë dobitë e mirësjelljes së fqinjit sipas imam Aliut (a.s.)?
- 3- Thoni një hadith që e dënon sjelljen e keqe ndaj fqinjit.
- 4- Çfarë i tha Al-lame Bahrul Ulum nxënësit të tij, i cili nuk e njihnte gjendjen e fqinjit të vet?

Shoqata

Mësimi 6

Fladi

MORALI I BASHKËJETESËS

Marrëdhëniet dhe lidhjet e barabarta mes individëve të shoqërisë kanë nevojë për parime të cilat duhen zbatuar. Zbatimi i këtyre parimeve sjell:

Së pari: zhvillimin e personalitetit të individit, nëpërmjet suksesit të marrëdhënieve të tij me të tjerët, e më pas përsosja e atyre marrëdhënieve.

Së dyti: nëpërmjet marrëdhënieve të tij me të tjerët, individi zbulon të drejtat shoqërore dhe nuk tregohet mënjanësë (neglizhencë) për këto të drejta e as nuk i shkel të drejtat e të tjerëve.

Buqeta e bazave dhe e rregullave ndahet në dy grupe:

Grupi i parë: Përfshin cilësitë pozitive me të cilat duhet të zbukurohet individi para të tjerëve.

Grupi i dytë: Përfshin cilësitë negative, prej të cilave njeriu duhet të largohet.

Pra, me fjalë të tjera: ka urdhra dhe ndalime në morale të cilat individi dhe shoqëria duhet t'i zbatojnë. Zbatimi i tyre i përcakton njeriut dhe shoqërisë identitetin e tyre.

Moralet e Mira

Nëpërmjet marrëdhënieve të tij shoqërore, njeriu lakmon që të jetë i respektuar dhe i dashur në mes njerëzve. Ky anim njerëzor (që rrjedh nga vetë natyra e njeriut) për të kërkuar pozitën shoqërore, buron nga ndjenja e frikës së vetmisë.

Në mësimet e kaluara u tha se shumica e nevojave shpirtërore dhe materiale të njeriut plotësohen vetëm me anë të marrëdhënieve dhe lidhjeve me të tjerët. Njeriu nuk mund ta përmbushë qëllimin e tij kur është i vetëm. Ndjenja e vetmisë godasin shpirtin e njeriut e si pasojë vjen zemërimi, hidhërimi, ndjenja për mangësi.

Këto probleme me të cilat përballet njeriu i vetmuar e shtyjnë atë të kërkojë marrëdhënie me shoqërinë. Në këtë mënyrë ai njihet me shumë cilësi njerëzore të pëlqyera dhe personaliteti i tij rritet, e përsoset. Moralet e mira luajnë rolin më të madh në tërheqjen e zemrave të njerëzve. Jo vetëm kaq, ai është baza e mirësive të tjera. Moralet e pëlqyera e humbasin vlerën e tyre nëse nuk trupëzohen me anë të moraleve të mira. Çfarë vlere mund të paraqitë një njeri me fytyrë të vrenjtur që nuk ndien çlodhje për shkak të mënyrës së tij të bashkëpunimit me të tjerët?! Dijetarët e moralit i njohin moralet e mira. Ata thonë se ato janë gjendja shpirtërore e cila e bën njeriun të mirë, bashkëpunues me njerëzit, të butë e fytyrëqeshur në punë a në marrëdhënie të tjera me njerëzit.

E kanë pyetur imam Sadikun (a.s.) për moralet e mira dhe ka thënë: **“Të jesh i thjeshtë, fjalëmirë dhe ta takosh vëllanë tënd me fytyrë të qeshur.”** ⁽¹⁾

⁽¹⁾ (“Biharul Anvar”; vëll. 71, f. 171)

Për mirësinë e moraleve të mira ka mjaft hadithe. Ato cilësojnë vlerat dhe ndikimet e tyre në këtë jetë dhe në jetën tjetër (Ahiretin).

Profeti ynë, Muhammedi (s.a.s.) ka thënë: **“Më të mirët ndër ju janë ata që kanë moral të mirë...”** ⁽²⁾

⁽²⁾ (“Usulul Kafi”; vëll. 2, f. 102, kreu, moralet e mira)

Dhe: **“Ai që ka morale të mira ka të njëjtin shpërblim si ai që agjëron e fal namazin.”** ⁽³⁾

⁽³⁾ (“Usulul Kafi”; f. 102)

Dhe: **“E para që i vendoset njeriut në peshë Ditën e Gjykimit janë moralet e tij të mira.”** ⁽⁴⁾

⁽⁴⁾ (“Biharul Anvar”; vëll. 68, f. 385, kreu, Moralet e mira)

Dhe: **“Nuk ka gjë më të përsosur në peshore se sa morali i mirë.”** ⁽⁵⁾

⁽⁵⁾ (“Biharul Anvar”; vëll. 68, f. 385)

Dhe: **“Më i dashur dhe më i afërm tek unë në Ditën e Gjykimit është ai që ka moralin më të mirë.”** ⁽⁶⁾

⁽⁶⁾ (“Biharul Anvar”; vëll. 66, f. 409)

Imam Aliu (a.s.) ka thënë: **“Nuk ka shok si morali i mirë.”** ⁽⁷⁾ ⁽⁷⁾ (“Biharul Anvar”; vëll. 68, f. 392)

Dhe: **“Titulli i librit të besimtarit është morali i mirë.”** ⁽⁸⁾ ⁽⁸⁾ (“Biharul Anvar”; f. 386)

Imam Hasani (a.s.) ka thënë: **“Më e mira e të mirave është morali i mirë.”** ⁽¹⁾

⁽¹⁾ (“Biharul Anvar”; f. 372)

Imam Bakiri (a.s.) ka thënë: **“Besimtari më i plotë në besim është ai me morale të mira.”** ⁽²⁾

⁽²⁾ (“Biharul Anvar”; f. 372)

Në këto hadithe të Profetit (s.a.s.) e të imamëve të Ehli Bejtit (a.s.) jepet rëndësia e moraleve të mira dhe roli i tyre në jetën e njerëzve.

Vërtet, Profeti (s.a.s.) e ka vendosur themelin e përsosurisë të moraleve të mira. Ata që i takojnë njerëzit me fjalë të mira e me fytyrë të qeshur, janë më të mirët e njerëzve.

Me këtë veprim të pëlqyer ata arrijnë shpërblim, sepse kjo mënyrë është adhurim, është njësoj si e atij që e kalon jetën duke agjëruar e duke falur namaz.

Në Ahiret njeriu do të japë llogari për mënyrën e jetesës në këtë botë. Atë Ditë, nuk gjendet gjë më e rëndë në peshore sesa moralet e mira. Sa më shumë të ngrihet myslimani në morale të mira, aq më i dashur është te Profeti ynë Muhammedi (s.a.s.)

në Ditën e Gjykimit. Vërtet, All-llahu në Kur'an e lavdëron Profetin e Tij, Muhammedin (s.a.s.) duke thënë: **“Vërtet, ti je në majat më të larta të moralit.”**⁽³⁾
⁽³⁾(Surja “Kalem”: 4)

Dhe: **“Ti ishe i butë ndaj tyre, ngase All-llahu të dhuroi mëshirë. E sikur të ishe i vrazhdë e zemërfortë, ata do të largoheshin prej teje, prandaj ti falju atyre dhe kërko ndjesë për ta e konsultohu me ta në të gjitha çështjet, e kur të vendosësh, atëherë mbështetu në All-llahun, se All-llahu i do ata që i mbështeten Atij.”**⁽⁴⁾
⁽⁴⁾ (Sure “Ali Imran”: 159).

Imam Aliu e cilëson profetin Muhammed kështu: **“Ka qenë më bujari, më guximtari, më i vërteti në thënie, më premtuesi, më zemërbuti, më fisniku. Cilido që e shikonte, menjëherë zemra iu mbushte me dashuri për atë, ai që ulej më atë dhe e njohu, e donte. Unë nuk kam parë asnjë njeri tjetër si ai, as para tij apo pas tij.”**⁽⁵⁾

⁽⁵⁾ (“Biharul Anvar”; vëll. 16 f. 231)

Pra, Profeti Muhammed (s.a.s.) ishte në majat më të larta të moraleve të mira, më bujari në dhënie, shembull në durim, në vërtetësi, në premtim. Çdo njeri që bashkohej me të e donte. Këtë cilësim të imam Aliut (a.s.) për Profetin e përforcojmë me një ndodhi historike:

Profeti Muhammed (s.a.s.) i kishte borxh një Jahudiu. Një ditë, Jahudiu shkoi te Profeti dhe i kërkoi borxhin. Profeti (s.a.s.) i tha:

“Tani nuk kam para.” Jahudiu ia ktheu: **“Unë nuk largohem derisa të më japësh paratë.”** Profeti (s.a.s.) i tha: **“Qëndro!”** Jahudiu nuk u largua nga Profeti. Shokët e Profetit shkuan te Jahudiu dhe e kërcënuan. **“Çfarë bëni?”**- u tha Profeti. Ky Jahudi të ka mbyllur,- folën ata. Profeti u tha: **“All-llahu nuk më ka dërguar t'u bëj padrejtësi njerëzve.”**

Në kohën e namazit të ditës tjetër, njerëzit e panë Jahudiu duke hyrë në xhami. Jahudiu shkoi te Profeti (s.a.s.) dhe i tha: **“Unë dëshmoj se nuk ka Zot tjetër përveç All-llahut dhe Muhammedi është i dërguari i All-llahut.”** Pastaj tha: **“Beto hem në All-llah, unë veprova kështu që të njoh cilësitë e tua, sepse në Teurat thuhet: “Lajmëtari i All-llahut, Muhammedi, i biri i Allahit, i lindur në Mekë, i emigruar në Tijbetu (Medine), ka morale të mira, nuk mallkon e nuk është i ashpër.” “O i Dërguari i All-llahut! Pasuria ime është jotja, shpenzoje aty ku dëshiron.”** Jahudiu ishte i pasur dhe të gjithë pasurinë e tij ia dhuroi Profetit (s.a.s.). Prandaj, është detyra jonë që të pasojmë Profetin tonë Muhammedin (s.a.s.). All-llahu (xh.sh.) thotë në Kur'an: **“Vërtet, tek i Dërguari i All-llahut keni shembullin më të lartë.”**⁽¹⁾⁽¹⁾(Surja “Abzab”:21)

Morali i lartë i Profetit, luajti dhe luan rol të madh në përhapjen e Islamit, sepse në çdo kohë njerëzit e shikojnë Profetin simbol e shembull i njerëzimit, fisnik, zemërdhimbshëm e shpirtlartë.

Ndikimet e moralit të mirë

Moralet e larta kanë fryte, të cilat njeriu i vjel në këtë jetë para se të kalojë në jetën tjetër. Prej ndikimeve të tyre është se shtohet mirësia.

Imam Sadiku (a.s.) ka thënë: **“Moralet e mira shtojnë mirësitë.”**⁽¹⁾ ⁽¹⁾ (“El- Bihar”; vëll. 68 f. 396)

Dhe: **“Mirësjellja dhe moralet e mira ndërtojnë shtëpi (sjellin lumturi) dhe shtojnë jetëgjatësinë.”**⁽²⁾

⁽²⁾ (“Gurerul Hikem”; f. 255)

Dhe: **“Moralet e mira i prishin të këqijat njësoj siç e prish uthulla mjaltin.”**⁽³⁾

⁽³⁾ (“Biharul Anvar”; vëll. 68 f. 395)

Imam Aliu (a.s.) ka thënë: **“Moralet e larta shtojnë mirësitë dhe afrojnë shoqët.”**⁽⁴⁾

⁽⁴⁾ (“Gurerul Hikem”; f. 255)

Dhe: **“Cilido që mbart morale të mira i shtohen të dashurit dhe me të kënaqen njerëzit.”**⁽⁵⁾

⁽⁵⁾ (“Gurerul Hikem”; f. 255)

Vërtet, moralet e mira janë fuqi njerëzore që të rrezatojnë ngrohtësi dhe kanë aftësi të shkrijnë gjynahet.

E kundërta ndodh me moralet e këqija. Ato ndikojnë keq: prishin dobite e punëve të mira. Profeti ynë (s.a.s.) dhe imamët prej familjes së tij na paralajmërojnë për moralet e këqija duke na treguar ndikimet e tyre negative.

Profeti Muhammed (s.a.s.) ka thënë: **“Moralet e këqija janë gjynahe që nuk falen.”**⁽⁶⁾

⁽⁶⁾ (“Miżanul Hikmetu”; kreu 1115)

Dhe: **“Moralet e këqija e bëjnë jetën të vështirë dhe mendojnë shpirtrat.”**⁽⁷⁾

⁽⁷⁾ (“Gurerul Hikem”; f. 264 kreu 5, f. 131)

Dhe: **“Moralet e këqija i vetmojnë njerëzit dhe largojnë shoqërinë.”**⁽⁸⁾

⁽⁸⁾ (“Gurerul Hikem”; f. 264 kreu 5, f. 131)

Dhe: **“Moralet e këqija vetmojnë të afërmin dhe largojnë të largët.”**⁽⁹⁾

⁽⁹⁾ (“Gurerul Hikem”; f. 264 kreu 5, f. 131)

Këtë mësim po e mbyllim me një hadith të profetit Muhammed (s.a.s.): **“Dy cilësi nuk bashkohen te besimtari- koprracia dhe moralet e këqija.”**⁽¹⁰⁾

⁽¹⁰⁾ (“Miżanul Hikmetu”; kreu 1115)

Sipas këtyre haditheve moralet e mira ndikojnë për mirë te njeriu dhe shoqëria. Ato i sjellin njeriut shumë mirësi si: ndjenjën e lumturisë, të bindjes të paqes. E kundërta ndodh me moralet e këqija. Ato i bëjnë shpirtërat të jetojnë në stërmundim të përhershëm.

Përmbledhje

Ngritja e marrëdhënieve shoqërore ka nevojë për themele. Këto themele ndahen në dy grupe:

- a) Zbatimi i urdhrave të All-llahut.
- b) Ndalimet e caktuara nga All-llahu.

Moralet e mira janë xhevahiri themelor i bashkëjetesës mes individëve dhe shoqërive.

Pyetje

- 1- Si i njohin dijetarët moralet e mira?

- 2- Përmendni një ajet Kur'anë nëpërmjet të cilit All-llahu na flet për moralin e Profetit Muhammed (s.a.s.).
- 3- Përmendni një ndodhi historike për moralin e Profetit dhe bashkëpunimin e tij me të tjerët.
- 4- Përmendni disa dobi të moraleve të mira.
- 5- Çfarë ka thënë Profeti (s.a.s.) për moralet e këqija?



Shoqata

Mësimi 7

Flladi

THJESHTËSIA

Në Kur'an thuhet: ***“E rob të Zotit janë ata që ecin nëpër tokë të qetë, e, kur të paditur u drejtohen atyre me fjalë, ata thonë: “Paqe!”*** ⁽¹⁾

⁽¹⁾(Surja “Furkan”: 63).

Thjeshtësia është në krye të bazave morale kur bashkëpunon me njerëzit. Vërtet, All-llahu (xh.sh.) e ka bërë atë prej shenjave të adhurimit të Tij të çiltërt për Të.

Kjo pamje të cilën na paraqet ky ajet i bekuar, pasqyron një gjendje sigurie, respekti e thjeshtësie: mënyra se si ec njeriu tregon se çfarë valëzon në veten e tij. Mendjemadhi njihet kur ecën, ai ecën në atë mënyrë e cila shfaq mendjemadhësinë, vetëpëlqimin dhe kryeneçësinë e tij. Ai nuk i sheh njerëzit e tjerë, sepse mendon se ka arritur majat, ose mendon se do të hapë tokën me këmbët e tij!!

Imam Aliu (a.s.) thotë për të devotshmit: ***“Në ecjen e tyre shihet thjeshtësia.”*** ⁽²⁾

⁽²⁾(“Biharul Anvar”; vëll. 67, kreu 14, hadithi 50)

Thjeshtësia është prej shenjave më kryesore të besimtarëve, të cilët e duan All-llahun (xh.sh.) dhe Ai i do ata. All-llahu (xh.sh) thotë në Kur'an: ***“O ju që besuat! Kush prej jush largohet nga feja e vet (i bën dëm vetes), s'ka dyshim se All-llahu do ta çojë një popull që Ai e do atë popull dhe ata e duan Atë (Zotin), (një popull) që është i thjeshtë e i butë ndaj besimtarëve, por i ashpër dhe i fortë ndaj mohuesve...”*** ⁽³⁾

⁽³⁾(Surja “Maide”: 54).

Thjeshtësia është prej cilësive, që e bën njeriun ta vlerësojnë të tjerët. Sa më shumë të shtohet thjeshtësia, aq më shumë vlerësohet njeriu në sytë e të tjerëve.

Profeti Muhammed (s.a.s) ka thënë: ***“Vërtet, thjeshtësia e ngre mbartësin e saj; prandaj përpiquuni të jeni të thjeshtë që All-llahu t'ju lartësojë.”*** ⁽⁴⁾

⁽⁴⁾(“Biharul Anvar”; vëll, 18, kreu 4, hadithi 2)

Dhe: **“Ai njeri që është i thjeshtë për hir të All-llahut, All-llahu do ta lartësojë atë. Ky njeri e sheh veten e tij të ulët, por të tjerët e shohin atë të lartë.”** (“Kenzul Ummal”; vëll. 3, f. 113, hadithi 5737)

Imam Sadiku (a.s.) na kumton se Llukmani i ka thënë djalit të tij: **“Krenaria është vetëm për atë që bindet për hir të All-llahut dhe lartësimi është vetëm për atë që është i thjeshtë për hir të All-llahut.”** (“Mishkatul Anvar”; f. 227)

Dhe: **“Në qiell janë dy melekë që shikojnë robtë. Ai njeri që është i thjeshtë për hir të All-llahut, All-llahu do ta lartësojë. Ai njeri që është mendjemadh, All-llahu do ta ulë (poshtërojë).”** (“Biharul Anvar”; vëll. 59, kreu 23, hadithi 50)

Familja e Profetit i nxit besimtarët që të vishen me rrobën e thjeshtësisë, sepse ajo është bukuria e të ndershmëve dhe zekati i nderit.

Imam Aliu (a.s.) ka thënë: **“Bukuria e të ndershmit është thjeshtësia.”** (“Biharul Anvar”; vëll. 75, kreu 51, hadithi 11)

Dhe: **“Thjeshtësia është zekati i nderit.”** (“Biharul Anvar”; vëll. 75, kreu 51, hadithi 11)

Duke porositur djalin e tij imam Hasanin (a.s.) Imam Aliu (a.s.) ka thënë: **“Ji i thjeshtë (për hir të All-llahut), sepse thjeshtësia është prej adhurimeve më të larta.”** (“Biharul Anvar”; vëll. 75, kreu 51, hadithi 11)

Imam Hasan Askeriu (a.s.) ka thënë: **“Thjeshtësia është mirësi e cila duhet pasur çili.”** (“Biharul Anvar”; vëll. 78, kreu 29, hadithi 1)

Thjeshtësi do të thotë: **“Të mos e quash veten tënde më të mirë se sa të tjerët.”**

Thjeshtësia duhet që:

1- Të jetë për hir të All-llahut. Prandaj, besimtari duhet ta zbatojë thjeshtëstinë vetëm me besimtarët, nuk lejohet zbatimi i thjeshtësisë në bashkëpunime me jobesimtarët dhe me mohuesit e All-llahut, sepse këtu ai quhet poshtërim.

2- Të lidhet me besimin dhe me devotshmërinë. T'i shfaqësh thjeshtësi një të pasuri për hir të pasurisë së tij, kjo është një gjë e përbuzur.

Imam Sadiku (a.s.) ka përcjellë një hadith të Profetit Muhammed (s.a.s.): **“Cilido që shkon tek i pasuri e i përulet atij për ato që ka në duart e tij (i pasuri), i ka ikur 2/3 e fesë.”** (“Biharul Anvar”; vëll. 73, kreu 122, hadithi 58)

Imam Aliu (a.s.) ka thënë: **“Sa e përsosur është thjeshtësia e të pasurve për të varfërit për hir të All-llahu. Thjeshtësia më e përsosur se ai i të pasurve është largimi i të varfërve prej të pasurit duke iu mbështetur All-llahut.”** (“Biharul Anvar”; vëll. 72, kreu 94, hadithi 57)

Pra, thjeshtësia është sjellje që mbështetet te besimi, dhe te devotshmëria për All-llahun dhe tek adhurimi i All-llahut (xh.sh.). Nuk ka thjeshtësi tek pasuria, posti a vendi në shoqëri, sepse Islami nuk njih tjetër përveç devotshmërisë si etalon për përparësi.

3. Thjeshtësia është jetesë e ekuilibruar, dhe cilësohet si ballancë. Ajo mënjanon teprinë dhe neglizhencën. Ekzagjerimi në thjeshtësi, çon në një gjendje dobësie dhe të afron tek kufijtë e nënvleftësimit, ndërsa tepria dhe neglizhenca e çojnë njeriun tej kufijve të mëndjemadhësisë e vetëpëlqimit.

Shenjat thjeshtësisë

Hadithet e përcjella nga familja e Profetit (s.a.s.) na i përshkruajnë qartë shenjat e thjeshtësisë.

Imam Rizain (a.s.) e kanë pyetur për kufirin e thjeshtësisë. Ai ka thënë: **“Tu japësh njerëzve prej vetës sate, atë që dëshiron të të japin ata ty.”** (“Biharul Anvar”; vëll. 71, kreu 63, hadithi 11)

Imam Sadiku (a.s.) ka thënë: **“Thjeshtësia është që të kënaqesh, të përshëndesësh atë që të takon, të lësh të drejtën edhe nëse e meriton. Kreu i mirësisë është thjeshtësia.”** (“Biharul Anvar”; vëll. 2, kreu 17, hadithi 20)

Ndikimet e Thjeshtësisë

Imam Musa Kadhim (a.s.) ka thënë: ***“Urtësia është në zemrën e atij që është i thjeshtë dhe nuk është në zemrën e mendjemadhrit kryeneç, sepse All-llahu e ka bërë thjeshtësinë mjet të intelektit, mendjes dhe e ka bërë mendjemadhësinë mjet të padijes.”*** (“*Biharul Anvar*”; vëll, 14, kreu 21, hadithi 17)

Transmetohet se Profeti Isa (a.s.) i biri i Merjemes u ka thënë apostujve: “Nëse më bindeni mua, do t’ju them diçka. Ata thanë: “Të bindemi, o i dërguari i All-llahut. Atëherë, Hazreti Isai u çua dhe u lau këmbët atyre njëri pas tjetrit. Apostujt i mbuloi ndienja e turpfit, por ata i dhanë besën se do t’i bindeshin dhe e lejuan t’ju lante këmbët. Kur Isai ua lau këmbët të gjithëve ata i thanë: “Ti je mësuesi ynë dhe ka qenë më mirë që ne të t’i lanim ty këmbët jo ti të na i laje ne? Hazreti Isai (a.s.) u tha atyre: “E bëra këtë që t’ju them se ju jeni njerëzit që do t’u shërbeni të tjerëve duke i mësuar ata pas meje.” Pra, le të jetë mënyra e të jetuarit tuaj thjeshtësia. Dijeni mirë se urtësia rritet në tokën e thjeshtësisë, njësoj si bima që zhvillohet në tokën e butë dhe jo në shkëmbij e në male.

Imam Aliu (a.s.) ka thënë: ***“Fryti i thjeshtësisë është dashuria kurse fryti i mendjemadhësisë është fyerja.”*** (“*Gurerul Hikem*”; vëll.3, f. 327)

Thjeshtësia i jep njeriut shëndet dhe e vesh me bukurinë e respektit e të hejbetit, siç ka thënë Imam Aliu (a.s.): ***“Thjeshtësia të jep ty shëndet (mbarëvajtje).”*** (“*Biharul Anvar*”; vëll, 75, kreu 51, hadithi 11)

Dhe: ***“Thjeshtësia të vesh ty (mehabbete) dashurinë.”*** (“*Biharul Anvar*”; vëll, 77, kreu 14, hadithi 1)

Kur thjeshtësia përhapet në mesin e njerëzve, atëherë nuk mbetet vend për mendjemadhësinë, por as për urrejtjen e armiqësinë.

Profeti Muhammed (s.a.s.) ka thënë: ***“All-llahu (xh.sh.) më ka frymëzuar që të jeni të thjeshtë, me qëllim që askush të mos i krenohet tjetrit e as mos ta urrejë tjetrin.”*** (“*Kenzul Ummal*”; vëll. 3, f. 110, hadithi 5722)

Këtë mësim po e mbyllim duke përmendur një ndodhi historike nga jetëshkrimi i Profeti Muhammed (s.a.s.) dhe e imam Aliut (a.s.).

Transmetohet se një ditë, i Dërguari i All-llahut (s.a.s.) së bashku me një grup shokësh të tij po udhëtonin. Kur erdhi koha e drekës, ata qëndruan për t’u çlodhur dhe për të ngrënë. Njëri prej tyre tha: “Unë do të ther dashin.” Tjetri tha: “Unë do ta rrjep.” Një tjetër foli: “Unë do ta pjek.” Në ato çaste i Dërguari i All-llahut tha: “Unë do të mbledh drutë.” Shokët i thanë: “O i Dërguari i All-llahut, ne i bëjmë të gjitha.” Profeti u tha: “Unë e di, por All-llahu (xh.sh.) nuk e pëlqen robin që të dallohet nga vëllezërit e tij.” Dhe u çua për të mbledhur drutë.

Te prijësi i besimtarëve, Ali ibn ebu-Talib (a.s.) shkuan dy besimtarë, babë e birë. Imami u çua, i respektoi dhe i uli në krye të dhomës. Më pas, urdhëroi që t’ju sillej ushqim dhe ushqimi erdhi. Kur miqtë mbaruan së ngrëni, Kamberi (shërbyesi i imamit) solli ibrikun me ujë dhe një enë. Imami mori ibrikun për t’u hedhur ujë, që miqtë të lajnë duart. Burrit i erdhi rëndë dhe i tha imam Aliut: “O prinjës i besimtarëve! All-llahu më shikon e ti më hedh ujë që të laj duart?! Imami iu përgjigj: “Ulu e laj duart, sepse vërtet All-llahu (xh.sh.) të sheh. Vëllai yt, i cili nuk ka dallim nga ti, prej shërbimit të tij kërkon shpërblim në Xhennet me dhjetëfish sa është numuri i banorëve të kësaj jete. Burri u ul. Imami foli përsëri: “Unë betohem për të drejtën time që ti e di dhe për thjeshtësinë tënde për hir të All-llahut, që t’i lashë duart njësoj sikur hedhësi i ujit të ishte Kamberi.” Burri ashtu bëri. Kur burri i lau duart, imami ia dha ibrikun Muhemmed ibn Hanefije dhe tha: “Sikur djali të kishte ardhur i vetëm, do t’i hidhja ujë për të larë duart, por All-llahu (xh.sh.) nuk e pëlqen që babai dhe i biri të barazohen në një vend të përbashkët: përderisa babai i hodhi ujë babait për të larë


duart, atëherë i biri t'i hedhë ujë të birit për të larë duart. Muhammed ibn Hanefije i hodhi ujë birit të atij burrit.

Përmbledhje

Prej cilësive më të domosdoshme e të lavdërueshme të besimtarit është thjeshtësia. Vërtet All-llahu (xh.sh.) e ka bërë atë prej cilësive të adhurimit. Thjeshtësia është shkak i zhvillimit të urtësisë, dashurisë, krenarisë, pozitës së lartë etj.

Pyetje

- 1- Ç'është thjeshtësia?
- 2- Thoni cilësinë e parë të robve të çiltërt të All-llahut, që përmendet në Kur'an në suren "Furkanë", ajeti 63.
- 3- Çfarë thotë imam Rizai (a.s.) për thjeshtësinë?
- 4- Cilat janë frytet e thjeshtësisë?



Mësimi 8

MBAJTJA E PREMTIMIT

Premtimi është prej bazave të moralit dhe duhet që myslimanët ta zbatojnë në marrëdhëniet e tyre shoqërore. Vërtet, ajetet e Kur'anit dhe hadithet e përcjella nga Ehli Bejti (a.s) dëshmojnë për këtë cilësi të lavdërueshme në jetën e njerëzve. All-llahu (xh.sh.) ka thënë: **"...Zbatojeni premtimin, pse për premtimin ka përgjegjësi."** (Surja "Isra": 34).

Dhe: **"O ju që besuat! Zbatojeni premtimet! ..."** (Surja "Maide": 1)

Pra, besimtar është ai që thotë e bën, sepse All-llahu (xh.sh.) zemërohet me atë që thënia e tij nuk është njësoj si vepra e tij. All-llahu (xh.sh.) thotë: **"O ju që besuat, pse po e thoni atë që nuk e bëni? Tek All-llahu është shumë e urrejtur ta thoni atë që nuk e bëni!"** (Surja "Saff": 2-3)

Në fillim të Islamit kishte premtime mes myslimanëve dhe mushrikëve. Profeti (s.a.s.) i zbatonte premtimet, ndërsa mushrikët jahudinj i thyenin premtimet. Kur'ani Famëllartë thotë: **"... edhe ju përmbushni marrëveshjen e tyre deri në afatin e caktuar..."** (Surja "Teube": 4).

Në një hadith të përcjellë nga imam Sadiku (a.s.) thuhet: **"Tri gjëra, të cilat asnjë njeri nuk mund të shfajësohet (ose t'i bëjë ose t'i lërë): Çuarja e amanetit, tek i miri apo i keqi, zbatimi i premtimit, qoftë për të mirët apo të këqijtë (të shtbururit), dhe mirësjellja me prindërit, qofshin të mirë apo të këqij."** ("Biharul Anvar"; vëll, 74, kreu 2, hadithi 46)

S'ka dyshim se zbatimi i premtimeve, respektimi i kontratave dhe marrëveshjet, janë kusht themelor për stabilizimin e shoqërisë dhe qëndrueshmërinë e saj. Nëse në mesin e shoqërisë do të përhapet pabesia dhe tradhëtia e amanetit, ajo do të shpërbëhet dhe do të jetë e pasigurt, sepse mungon bashkëpunimi, i cili është baza e kryerjes së nevojave të individëve dhe të shoqërisë. Një tjetër dukuri që do të duket është se i forti do të bëjë padrejtësi mbi të dobëtin. Shih për këtë, në hadithin e lartpërmendur të imam Sadiku (a.s.) që dëshmon për besnikërinë, amanetin dhe askush nuk mund të shfajësohet nëse nuk i zbaton ato.

Në letrën drejtuar Maliku Eshterit kur e emëroi mëkëmbës në Egjipt imam Aliu thotë: ***“Nëse lidh marrëveshje mes teje dhe armikut, apo i jep fjalën, atëherë zbatoje marrëveshjen dhe mbaje me çitërsi fjalën tënde. Bëhu si mburojë ndaj atyre që u ke dhënë fjalën, sepse respektimi i përmbushjes së premtimit është ndër detyrat e caktuara nga All-llahu... Jo vetëm myslimanët, por edhe adhuruesit e idhujve i mbajnë marrëveshjet reciproke, sepse i kuptojnë pasojat e prishjes së saj. Prandaj, kurrë mos e tradhto atë që i ke premtuar, mos e prish marrëveshjen dhe mos e mashtro armikun tënd, sepse askush nuk e kundërshton All-llahun përveç të paditurëve fatkeqë. All-llahu e ka bërë premtimin amanet dhe simbol të sigurisë, të cilën e ka përhapur te robtë e Tij që kërkojnë shpërblim nga afrimi te Ai (xh.sh.). Prandaj, në këtë gjë nuk duhet të ketë mashtrim, dinakëri e as dyfytirësi...”***
(“Nebxhul Belaga”; fjalimi 286)

Rëndësia e zbatimit të premtimeve

Nëpërmjet ajeteve të Kur'anit të Shenjtë dhe haditheve të Profetit (s.a.s.) e të Ehli-Bejtit (a.s.) mësuam se zbatimi i premtimeve është i domosdoshëm për myslimanët dhe për jo myslimanët. Tani le të njihemi me rëndësinë e zbatimit të premtimeve dhe pozitën e tij në moralin islam.

1-Kur'ani Famëlartë e quan zbatimin e premtimeve prej cilësive të besimtarëve.

All-llahu (xh.sh.) thotë: ***“Dhe ata të cilët me kujdes i ruajnë ato që u janë besuar (sende a fjalë), e ruajnë edhe premtimin e dhënë.”*** (Surja “Mu'minun”: 8)

Profeti Muhammed (s.a.s.) ka thënë: ***“Ai që beson në All-llah dhe në Ditën e Gjykimit, nëse premtion ta zbatojë premtimin.”*** (“Biharul Anvar”; vëll, 77, kreu 7, hadithi 1)

Imam Aliu (a.s.) ka thënë: ***“Vërtet, zbatimi i premtimeve është prej shenjave të besimtarëve.”*** (“Biharul Anvar”; vëll, 17, kreu 14 hadithi 11)

Dhe: ***“Themeli i fesë është çuarja e amanetit dhe zbatimi i premtimit.”*** (“Biharul Anvar”; vëll, 17, kreu 14 hadithi 11)

2 –All-llahu i lavdëron të dërguarit sepse ata i zbatonin premtimet. Për Ismailin (a.s.) All-llahu ka thënë: ***“Përkujtoja në këtë libër Ismailin! Ai ka qenë shumë besnik në premtim dhe i dërguar e pejgamber.”*** (Surja “Merjem”: 54)

Pra, ai ka qenë i vërtetë në premtime. Kjo cilësi përmendet para përmendjes së profetësisë dhe mesazhit.

Imam Rizai (a.s.) përcjell nga i ati i tij një ngjarje të Profetit tonë Muhammedit (s.a.s.): Një njeri i premtoi Profetit Muhammed (s.a.s.) se do të takoheshin te një

shkëmb. Profeti shkoi atje në kohën e caktuar, mirëpo ai nuk erdhi. Dielli ishte shumë i nxehtë. Disa shokë të Profetit i thanë: **“O i Dërguari i All-llahut, ulu në hije.”** Ai u tha: **“Takimi ynë është këtu dhe nuk do të luaj nga vendi derisa të vijë.”**

3- Nga hadithet e transmetuara nga familja e Profetit (s.a.s.) thuhet se zbatimi i petimeve është prej të drejtave të besimtarëve.

Imam Sadiku (a.s.) ka thënë: **“Besimtari është vëlla i besimtarit, vetja e tij dhe delili (treguesi) i tij. Ai nuk e tradhton, nuk i bën padrejtësi, nuk e mashtron dhe nuk i thyen premtimet.”** (“Biharul Anvar”; vëll, 74, kreu 16, hadithi 7)

4- Cilësia e zbatimit të petimeve është binjake e vërtetësisë dhe ajo bie ndesh me trillimet, kurthet dhe tradhtinë.

Imam Aliu (a.s.) ka thënë: **“O njerëz! Zbatimi i petimeve është binjake me sinqeritetin. Nuk njoh mburojë më të mirë se sa ai. Ai njeri që e kupton të vërtetën e ringjalljes, ai kurrë nuk tradhton. Jetojmë në kohën kur shumica e njerëzve tradhtinë e kanë si mençuri. Në këtë kohë të paditurit e quajnë tradhtinë dinakëri fisnike. Ç’ka ndodhur me ta? All-llahu i vraftë!...”** (“Biharul Anvar”; vëll, 75, kreu 96, hadithi / 21)

Nëpërmjet këtij hadithi shohim se pabesia përhapet në shoqëritë e paditura (xhahile), sepse njeriu i paditur e sheh një tjetër që është i pabesë por e konsideron njeri! Por, zotëria ynë, Aliu e konsideron këtë njeri të çmendur, sepse pabesia është cilësi e ulët me të cilën cilësohet njeriu që nuk beson në All-llah e as në Ditën e Gjykimit. Ndërsa besimtari nuk mund të bëjë pabesi, sepse pabesia nuk është në përputhje me besimin. Profeti ynë, Muhammedi (s.a.s.) i zbatonte premtimet me mushrikët dhe jobesimtarët edhe pse e dinte se çfarë poshtërimesh e të këqijash do të vinin prej tyre. Po ashtu, ai e dinte se ato do t’i thyenin premtimet derisa erdhi mesazhi nga All-llahu (xh.sh.), i cili i bëri të pavlera premtimet mes Profetit dhe jobesimtarëve, siç thotë All-llahu (xh.sh) në Kur'an: **“Denoncim nga All-llahu dhe i dërguari i Tij ndaj idhujtarëve, me të cilët ju patët lidhur kontratë** (kumtesë për shkëputjen e marrëveshjes).” (Surja “Teube”:1).

Pas zbritjes së këtij ajeti dhe të ajeteve pas tij, prej sures “Teube”, u prish marrëveshja mes myslimanëve dhe mushrikëve, përveç me mushrikët të cilët nuk i thyen premtimet e tyre me myslimanët.

Vërtet, Profeti Muhammed (s.a.s.) dhe Ehli Bejt (a.s.) e dëshmojnë cilësinë e zbatimit të petimeve dhe i inkurajojnë myslimanët dhe besimtarët që të zbukurohen me këtë cilësi. Mirëpo, në të njëjtën kohë ata kanë thënë që t’i ruhen pabesisë, sepse i pabesi është dyfytyrak, dhe All-llahu e urren.

Profeti Muhammed (s.a.s.) ka thënë: Shenjat e dyfytyrakut janë tri: **“Kur flet, gënjen; kur premtion nuk e mban fjalën dhe kur i beson diçka, të tradhton.”** (“Biharul Anvar”; vëll, 72, kreu 106, hadithi 6)

Imam Aliu (a.s.) kur e caktoi Maliku El-Eshteri mëkëmbës në Egjipt, i tha: **“Mjerë ti, nëse u premtion atyre dhe nuk e zbaton atë..! Moszbatimi i premtimit sjell zemërimin e All-llahut dhe të njerëzve.** All-llahu (xh.sh.) ka thënë: **Tek All-llahu është shumë e urrejtur ta thoni atë që nuk e bëni!”** (“Nehxhul Belaga”; porosia 53)

Përmbledhje

Zbatimi i premtimeve është prej bazave të moraleve. All-llahu e ka cilësuar besimtarin me cilësinë e zbatimit të premtimeve. Prandaj, myslimani duhet që të zbatojë premtimet e tij, qoftë me myslimanët qoftë me jomyslimanët.

Pyetje

- 1- Çfarë thotë Kur'ani Famëlartë për ata që nuk i zbatojnë premtimet e tyre?
- 2- Përmendni thëniet që i tha imam Aliu (a.s.) Maliku El-Eshterit rreth çështjes së zbatimit të premtimeve.
- 3- Cila është pozita e zbatimit të premtimeve në Islam?
- 4- Cili është kushti për zbatimin e premtimit me palën tjetër?



Mësimi 9

ZEMËRBUTËSIA DHE VETËPËRMBAJTJA

Në jetën e tij shoqërore individi përballlet me shumë njerëz. Ka njerëz pozitive, dhe ka disa të tjerë që janë negativë në veprime. Duke bashkëjetuar me ta, ai krijon marrëdhënie. Atëherë, si duhet të jenë marrëdhëniet tona me individët negativë? Ndoshta, disa mendojnë se mënyra më e mirë është t'i ndërpresim marrëdhëniet me ata të cilët nuk sillen mirë dhe t'i kufizojmë marrëdhëniet shoqërore me njerëzit e mirë, sepse në këtë mënyrë do të jetojmë të qetë e pa probleme. Mirëpo, kjo mënyrë nuk është praktike, sepse është e pamundur që të gjejmë një shoqëri, individët e së cilës të kenë parapëlqime të përbashkëta, moral të përbashkët, etj. Rrallëherë mund të shihen dy njerëz të përbashkët në mënyrën e të menduarit të tyre, në idetë e tyre dhe moralet e tyre. Pastaj, nevojat tona shoqërore nuk mund të sigurohen duke pasur marrëdhënie të kufizuara me disa njerëz. Ndoshta, dikush propozon rrugëzgjdhje tjetër e kjo është hyrja në konflikt me ata të pasjellshmit dhe t'i shkëpusim marrëdhëniet me çdo person që del nga rruga e drejtë e si përfundim jetesa e individëve të shoqërisë do të jetë e tensionuar dhe do të arrijë në përfundimin e papëlqyer. Sa të shumta janë gjakderdhjet për shkak të konflikteve! Ndoshta një grup

e mbyll konfliktin për interes të tij. Por, a ka mbaruar çdo gjë? Jo, sepse, siç thuhet prushi i ndezur qëndron poshtë hirit, sepse konflikti shoqëror prodhon urrejtje e smirë në zemrën e të mundurit dhe ajo urrejtje do të shfaqet sa të vijë koha e përshtatshme për hakmarrje. Dhe dihet se hakmarrja e egër dhe e verbër nuk njihet rrugëzgjdhje tjetër. Është më se e sigurt se jeta do të jetë e vështirë në atë shoqëri, të cilën e udhëheq konflikti, urrejtja, smira etj.

- Atëherë, cila është rrugëzgjdhja?

Në këto situata, Islami propozon rrugëzgjdhjen e përshtatshme e cila është: “zemërbutësia dhe vetëpërmbajtja.”

Këtu përmendim tri pika:

- 1- Zemërimi në pikpamjen e Islamit.
- 2- Vlera e zemërbutësisë dhe e vetëpërmbajtjes në besimin Islam.
- 3- Disa shembuj rreth zemërbutësisë dhe vetëpërmbajtjes.

Zemërimi

Transmetimet Islame e quajnë “zemërimin” cilësi negative dhe të papëlqyer. Më poshtë po përmendim një pjesë të atyre haditheve: Profeti Muhammed (s.a.s.) ka thënë: **“Zemërimi është prush prej shejtanit.”** (“Biharul Anvar”; vëll, 73, kreu 132, hadithi/15)

Imam Sadiku (a.s.) ka thënë: **“Zemërimi është çelësi i të këqijave.”** (“Biharul Anvar”; vëll, 73, kreu 132, hadithi/4)

Imam Aliu (a.s.) ka thënë: **“Zemërimi është sherr; nëse e lëshon, të shkatërron.”** (“El-Mustedrek”; vëll. 12, kreu 53, hadithi/13376)

Dhe: **“Zemërimi e poshtëron mbartësin e tij dhe i shfaq atij të këqijat.”** (“Gurerul hikem”; vëll. 2, f. 31)

Dhe: **“Zemërimi ndikon në përhapjen e smirës.”** (“Gurerul hikem”; vëll. 2, f. 255)

Dhe: **“Zemërimi është zjarr i ndezur; ai që e bllokton atë, e ka fikur, kush e lëshon, është i pari që do të digjet dhe do të jetë vetë ai personi.”** (“El-Mustedrek”; vëll. 12, kreu 53, hadithi/13376)

Dhe: **“Ruhuni prej zemërimit, sepse ai është prej ushtarëve (përkrabësve) të djallit.”** (“Biharul Anvar”; vëll, 33, kreu 29, hadithi/20)

Dhe: **“Zemërimi shkatërron mendjet dhe të largon nga shpërblimet.”** (“El-Mustedrek”; vëll. 12, kreu 53, hadithi/13376)

Imam Sadiku (a.s.) ka thënë: **“Ai që nuk e përmban zemërimin e tij, nuk sundon mendjen e tij.”** (“Biharul Anvar”; vëll, 73, kreu 132, hadithi/33)

Këto ishin disa transmetime të cilat flasin për dëmet e mëdha që sjell zemërimi nëse njeriu është i papërmbajtur.

Tani po përmendim disa hadithe të cilat e lavdërojnë atë njeri i cili është i përmbajtur kur zemërohet dhe arrin ta mposhtë atë.

Profeti Muhammed (s.a.s.) ka thënë: **“Fuqia nuk njihet në konflikt, por kur përmban zemërimin.”** (“Biharul Anvar”; vëll, 77, kreu 7, hadithi/1)

Imam Aliu (a.s.) ka thënë: **“Më i miri sundim është sundimi i zemërimit.”** (“Gurerul hikem”; vëll. 4, f. 302)

Dhe: **“Njeriu që përfiton shpërblim është ai që nuk zemërohet.”** (“Gurerul hikem”; vëll. 4, f. 246)

Dhe: ***“Fiton mbi djallin ai që përmbahet në zemërim.”*** (“Gurerul hikem”; vëll. 4, f. 301)

Dhe: ***“Zemërimi është armik, prandaj mos e lër të të sundojë!”*** (“El- Mustedrek”; vëll. 12, f. 11)

Dhe: ***“Ai njeri që bie pre e zemërimit dhe e unit të tij, ai është në gradën e kafshëve.”*** (“Gurerul hikem”; vëll. 5, f. 362)

Dhe: ***“Njeriu më i fortë është ai që përmbahet në zemërim.”***

Imam Bakiri (a.s.) ka thënë: ***“Nuk ka fuqi më të madhe se sa të mposhtësh zemërimin.”*** (“Biharul Anvar”; vëll. 78, kreu 22, hadithi/1)

Nga jeta e Profetit transmetohet se një burrë shkoi tek ai dhe i tha: ***“Më këshillo o i Dërguari i All-llahut.”*** Profeti i tha: ***“Mos u zemëro!”***. Ai e përsëriti tri herë atë dhe Profeti (s.a.s.) tha: ***“Mos u zemëro!”*** Burri u kthye te fisi i tij dhe pa se atje ishte ndezur lufta. Kur pyeti, atij i thanë se disa njerëz nga fisi i tij kishin sulmuar një fis tjetër dhe kishin plaçkitur pasuritë e tyre, e kështu kishte filluar konflikti mes dy fiseve. Kur pa të plagosurit e fisit të tij u zemërua e hyri në çadrën e tij për të veshur pajimet e luftës. Në ato çaste ai kujtoi këshillën e Profetit Muhammed (s.a.s.) i cili i kishte thënë: ***“Mos u zemëro!”*** Menjëherë, ai filloi të mendonte për fundin e këtij veprimi që po përgatitej. Ai e hodhi shpatën dhe iu drejtua fisit tjetër duke i propozuar të parit të tyre kompesimin për të gjitha ato humbje që pësoi fisi i tyre. Ai u tha atyre: ***“Merrni prej pasurive çfarë të doni e çfarë t’ju pëlqejë e mos bëni gjakderdhje të tjera.”*** Të parët e atij fisi u ndikuan nga ky qëndrim i zgjuar dhe i thanë: ***“Ne na pëlqyen fjalët e tua, prandaj shko i sigurtë”*** Kështu, thënia e Profetit (s.a.s.) ***“mos u zemëro!”*** e fiku zjarrin e luftës e të urrejtjes. Në këtë ngjarje që lexuam shohim dy anë: e para mospëlqimi i zemërimit, e dyta, lavdërimi i të përmbajturit në zemërim. Mirëpo, përveç këtyre dy anëve përmendet edhe një anë e tretë që është, zemërimi për hir të All-llahut dhe në rrugën e Tij (xh.sh).

Kur e përcolli imam Aliu shokun e njohur të Profetit, Ebu Dherrin, të cilin e përzunë, i tha: ***“O Ebu Dherr, vërtet, ti u zemërove për hir të All-llahut, prandaj shpresoj në atë për të cilin ti u zemërove. Populli u frikësua nga ti prej dynjasë së tyre dhe ti iu frikësove atyre për fenë tënde. Prandaj, lëri në duart e tyre ato që ata u frikësuan nga ti dhe largohu prej tyre që ti u frikësohesh. Sa nevojë kanë ata për ato që ti i ndalove ato, e sa i mjaftueshëm je ti për ato që ata të ndaluan. Nesër do të mësosh se kush është fituesi. Nuk të kënaq veçse e drejta dhe nuk të hidhëron veçse padrejtësia. Nëse do ta pranoje dynjanë e tyre, ata do të donin ty dhe sikur ta pranoje këtë jetë dhe do të të jepnin siguri.”*** (“Biharul Anvar”; vëll. 71, kreu 22, hadithi/30)

Nga ato që përmendëm më lart mësuam se zemërimi është fuqi të cilën All-llahu e ka vendosur te njerëzit dhe duhet përfituar prej saj në rrugën e All-llahut (xh.sh.). Kur ndodh agresion mbi fenë dhe shkelen kufijtë e All-llahut, zemërimi bëhet i ligjshëm dhe i kërkueshëm. Prandaj, duhet që myslimani të jetë mbrojtës dhe ta ndiejë zemërimin për hir të All-llahut dhe në rrugën e Tij. Për këtë Kur’ani Fisnik i cilëson besimtarët të mëshirshëm mes tyre dhe të ashpër me mohuesit, me jobesimtarët. All-llahu (xh.sh) thotë: ***“Muhammedi është i Dërguari i All-llahut, e ata që janë me të (sahabët), janë të ashpër kundër jobesimtarëve, janë të mëshirshëm ndërmjet tyre ...”*** (Surja ‘Fet’h’: 29).

Përmbledhje

Vërtet, krijimi i marrëdhënieve me të tjerët është prej të domosdoshmëve të jetës shoqërore. Shkaku i llojshmërisë dhe ndryshueshmërisë në preferenca dhe jetën e njerëzve është pasojë e konflikteve që lindin prej urrejtjeve. Disa mendojnë se rrugëzgjdhja është përdorimi i forcës. Disa të tjerë thonë se rrugëzgjdhja është ndërprerja e marrëdhënieve. Por, Islami fton në zemërbutësi dhe vetëpërmbytje dhe i konsideron këto si rruga më e suksesshme në rregullimin e marrëdhënieve shoqërore.

Pyetje

- 1- Ç'është vetëpërmbytja?
- 2- Përse hadithet e konsiderojnë zemërimin si cilësi të keqe?
- 3- Përmendni një hadith të Profetit Muhammed (s.a.s.) rreth vetëpërmbytjes në zemërim.
- 4- Çfarë tha imam Aliu për zemërimin kur po ndahej me shokun e tij të famshëm, Ebu Dherrin?

Mësimi 10

ZEMËRBUTËSIA DHE VETËPËRMBAJTJA (2)

Deri tani mësuam se zemërimi lejohet vetëm përballë armiqve të All-llahut. Përballë besimtarëve ai është haram (i ndaluar). Atëherë, si të veprojmë me gabimet dhe me shkeljet (kalimin e kufijve) e shokëve dhe vëllezërve tanë?! Siç u përmend edhe në mësimin e kaluar, Islami propozon zemërbutësinë dhe vetëpërmbytjen në zemërim si mënyrë, për ekzistencën dhe vazhdueshmërinë e marrëdhënieve shoqërore. S'ka dyshim se konfliktet mes njerëzve mund të zgjidhen me zemërbutësi duke përmbytur veten. Për këtë arsye sheriatu islam e konsideron vetëpërmbytjen prej cilësive të lavdërueshme, me të cilën besimtarët duhet të zbukurohen. Kur'ani Famëlartë na nxit që të jemi gjakftohtë dhe ta përmbytjmë veten në situata zemërimi. All-llahu (xh.sh) thotë: ***“Të cilët japin kur janë çlirë edhe kur janë në vështirësi dhe që e frenojnë mllëfjin, që ua falin (të keqen) njerëzve. All-llahu i do bamirësit.”*** (Surja “Ali Imran”, 134).

Dhe: ***“Nuk është e barabartë e mira me të keqen. Prandaj, (të keqen) ktheje në mënyrë të mirë, se atëherë ai, me të cilin kishit njëfarë armiqësie, do të bëhet mik i afërt. Mirëpo,***

këtë nuk mund ta arrijë kush, përveç atyre që janë të durueshëm, dhe nuk mund ta arrijë kush, përveç atyre që kanë virtyt të lartë. (Surja "Fussilet", 34-35).

Vërtet, kultura e vetëpërbajtjes është në kundërshtim me kulturën negative të hakmarrjes. Hakmarrja shton armiqësinë dhe ndez urrejtjen, kurse vetpërbajtja na bën që të bashkëpunojmë me kundërshtarët njësoj sikur të jenë miq të dashur. Pra, vetëpërbajtja është dritë e cila ndriçon shpirtat, ndërsa hakmarrja është zjarr që djeg shoqërinë njerëzore. Ehli Bejti e lavdëron vetëpërbajtjen dhe i ftojnë besimtarët që të zbukurohen me këtë cilësi. Po përmendim disa hadithe:

Profeti Muhammed (s.a.s.) ka thënë: ***"All-llahu do t'ia mbushë zemrën me iman (besim) atij që është i përbajtur."*** ("Biharul Anvar"; vëll, 69, kreu 38, hadithi/44)

Dhe: ***"Njeriu më i prerë (i palëkundur në mendime e në veprime) është më i përbajtur."*** ("Biharul Anvar"; vëll, 71, kreu 93, hadithi/55)

Imam Aliu (a.s.) ka thënë: ***"Zemërbutësia është mburojë prej të këqijave."*** ("Nurul Hakikatu"; f. 213)

Dhe: ***"Zemërbutësia është dritë dhe xhevahiri i tij është mendja, (intelekti)."*** ("Gurerul Hikem"; vëll. 5 f. 286)

Dhe: ***"Nuk ka krenari më të lartë sesa vetëpërbajtja."*** ("Biharul Anvar"; vëll, 71, kreu 93, hadithi/32)

Dhe: ***"Njiheni zemërbutësinë sepse ajo është miku i besimtarit dhe veziri i tij."*** ("Biharul Anvar"; vëll, 78, kreu 16, hadithi/140)

Dhe: ***"Zbatoje zemërbutësinë sepse ajo është fryti i diturisë."*** ("Biharul Anvar"; vëll, 71, kreu 93, hadithi/35)

Dhe: ***"Ai që zbaton zemërbutësinë, udhëheq."*** ("Biharul Anvar"; vëll, 77, kreu 93, hadithi/1)

Dhe: ***"Paqja është fryti i vetëpërbajtjes."*** ("Gurerul Hikem"; vëll. 1 f. 227)

Imam Xhevadi (a.s.) ka thënë: ***"Zemërbutësia është veshja e dijetarit, prandaj mos e hiqni atë."*** ("Biharul Anvar"; vëll, 78, kreu 3, hadithi/2)

Imam Bakiri (a.s.) ka thënë: ***"Kush është i përbajtur dhe i aftë në vazhdimësinë e tij, Ditën e Gjykimit All-llahu do t'ia mbushë zemrën me siguri dhe besim."*** ("Biharul Anvar"; vëll, 7, kreu 15, hadithi/62)

Imam Sadiku (a.s.) ka thënë: ***"Kush e përmban zemërimin dhe është në gjëndje të shpëtojë prej tij dhe është vetëpërbajtur, All-llahu do t'ia japë shpërblimin e dëshmorit (shëbidit)."*** ("Biharul Anvar"; vëll, 71, kreu 66, hadithi/10)

Në këto hadithe shohim se përbajtja e vetes dhe mposhtja e saj e ka pikënisjen tek drita e besimit, e cila i ndriçon njeriut rrugën e tij duke njohur edhe pozitën e tij. Vetëpërbajtja mbulon të këqijat e njeriut, kurse zemërimi i zbulon njeriut shumë prej të këqijave të tij.

Vetëpërbajtja e ngre njeriun në shkallën e dëshmorit, sepse kur njeriu e mposht veten e tij dhe fiton mbi të, ai ka bërë një prej dy të mirave triumfin ose shehadetin (martirizimin).

Njeriu halim, cilësohet edhe me cilësinë e të palëkundurit, sepse të palëkundurit është prej cilësive dhe udhëheqësve e personaliteteve të forta. Prandaj edhe profeti Muhammed (s.a.s.) ka thënë: ***"Njeriu më i prerë (i palëkundur në mendime e veprime) është më i përbajturi."*** ("Biharul Anvar"; vëll, 71, kreu 93, hadithi/55)

E kanë pyetur imam Hasanin (a.s.) për "hilmin" e ka thënë: ***"Të përbajturit dhe të sunduarit e vetit."*** ("Biharul Anvar"; vëll, 78, kreu 19, hadithi/2)

Imam Sexhad, Ali ibn Husejn (a.s.) ka thënë: ***"Vërtet, më pëlqen ai njeri i cilin e përdor zemërbutësinë kur është i zemëruar."*** ("Biharul Anvar"; vëll, 71, kreu 93, hadithi/13)

Një njeri e pyeti imam Sadikun (a.s.): ***"A nuk është poshtërim kur i largohesh konfliktit?"*** Ai (a.s.) i tha: ***"I poshtëruar është keqbërësi."*** ("El-Mebexhetul Bejda"; vëll. 5 f. 313)

Mundohet një person që bën debat me ty për një çështje. Ti ke mendim më të drejtë rreth saj, mirëpo, njeriu me të cilin ti debaton është fanatik në mendimin e tij e mbron me

ngulm. Vërtet, etika islame të nxit që ti ta lësh debatin, sepse nuk ka rrugëdalje në të. Ndoshta ky lloj debati çon në mëri. Ky qëndrim yti (pra, ndërprerja e debatit) nuk është poshtërim, sepse e vërteta dhe e drejta janë si dielli, i cili nuk qëndron gjithmonë pas reve. Për këtë edhe shoku yt do të zgjohet dhe do të vijë një ditë e ai do ta kuptojë gabimin e tij. Hilmi ruan marrëdhëniet e njeriut me individët e tjerë të shoqërisë.

Disa shembuj rreth zemërbutësisë dhe vetëpërbajtjes

Po përmendim disa shembuj rreth zemërbutësisë dhe vetëpërbajtja, që të nxjerrim mësimë prej tyre.

Para Islamit, mes dy fiseve - Aus dhe Hazreth- kishte luftë të vazhdueshme. All-llahu (xh.sh.) i udhëzoi këto dy fise në dritën e Islamit dhe u shua ai zjarr i çmendur i urrejtjes dhe ata u bënë vëllezër. Ata uleshin së bashku dhe bisedonin me dashuri, respekt e vëllazëri me njëri-tjetrin. Pra, vëllazëria islame zuri vendin e armiqësisë së padijes (xhahilijetit).

Një ditë, një Jahudi, i quajtur "Shas ibn Kajs" kaloi pranë tyre dhe i pa tek bisedonin. Atë e mbuloi hija e smirës dhe sytë iu ndezën nga inati. Ai mendoi që të ndizte mes tyre luftën dhe të përhapte zjarrin e smirës. Për këtë, ai dërgoi tek ata një njeri të keq dhe i tha që të recitonte tek ata një poezi të vjetër (të kohës së xhahilijetit). Ai njeriu jahudi shkoi tek ata dhe u ul mes tyre. Pastaj filloi të recitonte një poezi prej Ausit dhe një prej Hazrethit.

Poezitë flisnin për luftërat në kohën e xhahilijetit. Kur dëgjuan poezitë, të pranishmit kërkuan që të silleshin armët dhe filloi lufta mes dy fiseve si zjarri në barishtet e thata. Kur Profeti (s.a.s.) dëgjoi për këtë ndodhi, menjëherë u nis dhe shkoi në vendin e përçarjes dhe thërriti më zë të lartë: ***"O myslimanë!" All-llah, All-llah, a iu kthyet xhahilijetit dhe unë jam mes jush e ju doni të ktheheni mohues ashtu siç ishit?!"***

Kur dëgjuan fjalët e Profetit (s.a.s.), myslimanët u kthyen në udhëzimin e tyre dhe e kuptuan që kishin bërë një gabim të turpshëm. Ata u penduan dhe e ripërtëritën besën e vëllazërisë islame. Drita e Islamit e fiku zjarrin e xhahilijetit, e fiku zjarrin e luftës që ndezi Jahudiu.

Në jetëshkrimin e Profetit (s.a.s.) thuhet: "Një ditë një A'rabij (banor i shkretëtirës) hyri në xhaminë e Profetit (s.a.s.) dhe tha se kishte nevojë për para. Profeti (s.a.s.) i dha atij aq sa kishte. A'rabiju i mori paratë dhe i foli ashpër Profetit (s.a.s.). Shokët e Profetit (s.a.s.) deshën ta rrihin A'rabijun, por Profeti i ndaloi. Pas namazit, Profeti (s.a.s.) e pa A'rabijun jashtë xhamisë. E ftoi atë në shtëpinë e tij dhe i dha një shumë tjetër parash. Kur A'rabiju pa shtëpinë e Profetit (s.a.s.) e kuptoi se shtëpia e tij nuk ndryshonte nga shtëpitë e të varfërve. I erdhi keq për ato që pa dhe u pendua dhe e falënderoi Profetin (s.a.s.) për paratë që i dha. Profeti (s.a.s.) i tha: "Unë të frikësohem ty prej të keqes së shokëve të mi që dëgjuan ato fjalë që më the në xhami. Do kishte qenë më mirë sikur të shfaqje kënaqësinë tënde atje." A'rabiju tundi kokën në shenjë pranimi. Ditën e dytë A'rabiju shkoi përsëri në xhami. Kur e pa Profeti (s.a.s.), tha: "Ky njeri është i kënaqur nga unë." A'rabiju e dëshmoi thënien e Profetit: "Po." Pastaj u largua nga xhamia. Profeti, për t'u dhënë mësim shokëve të tij, tha: "Unë me këtë njeri jam njësoj me atë person, të cilit i ikën deveja dhe njerëzit vrapojnë për ta kapur atë. Sa herë që deveja dëgjon zërat e njerëzve, ikën edhe më shumë. Ai personi u tha njerëzve, ndaloni që të them mendimin tim. Ai mori ushqim, ia hodhi devesë dhe deveja u kthye që të hante. Në ato çaste, i zoti i saj e kapi atë. "E pra, sikur dje t'ju kisha lënë, ndoshta do ta kishit vlarë atë. E shikoni se çfarë bëri zemërbutësia."

Një njeri nga Shami shkoi në Medine Munovereh. Kur e pa imam Hasanin (a.s.), e njohu dhe filloi ta fyente e ta shante. Imam Hasani vetëm e dëgjonte dhe nuk e ndërpriste. Kur ai mbaroi të sharët e të fyerit, imam Hasani me dashuri e me buzqeshje tha: ***"O xhaxha, më dukesh i huaj në këtë vend. Nëse na kërkon, ne të japim; nëse na kërkon udhëzjim, ne të udhëzojmë; nëse je i uritur ne të japim të hashë; nëse je nevojtar, të të pasurojmë; nëse***

kërkon strehim, ne të strehojmë...” Imami vazhdoi t’i fliste me fjalë të buta derisa ia shkuli nga zemra rrënjët e sherrit e të smirës dhe në fytyrën e tij u dukën shenjat e pendimit. Ai i kërkoi falje imamit dhe i tha: *“All-llahu e di se ku e vendos mesazhin e Tij.”* Imam Hasani jo vetëm u tregua zemërbutë, por iu përgjigj së keqes me të mirë duke i treguar njeriut nga Shami shpirtin njerëzor. Me këtë mënyrë të lartë morale fitoi e mira mbi të keqen, moralet e pëlqyera mbi moralet e papëlqyera, dituria mbi padijen dhe Islami mbi xhahilijetin.

Përmbledhje

Vërtet, eulijatë e All-llahut janë shembulli më i lartë për forcimin e marrëdhënieve shoqërore. Zemërbutësia dhe vetëpërmbytja, të përgjigjurit e të keqes me të mirë janë shembujt më të lartë në morale. S’ka dyshim se zemërbutësia është mesazh i madh njerëzor e shoqëror në jetën e përditshme.

Pyetje

- 1-Sqaro ndikimet e zemërbutësisë në marrëdhëniet shoqërore
- 2- Përse imam Aliu fton në njohjen e zemërbutësisë?
- 3-Sqaro marrëdhëniet mes zemërbutësisë dhe vetëpërmbytjes
- 4-Përmendni një shembull nga jeta e Profetit (s.a.s.) dhe nga historia islame rreth vetëpërmbytjes.

Mësimi 11

FALJA

Në dy mësimet e kaluara mësuam se Islami propozon zemërbutësinë përballë të këqijave që mund të vijnë nga njerëzit, që marrëdhëniet shoqërore të jenë sa më të forta. Kur folëm për zemërbutësinë, folëm edhe për vetëpërmbytjen. Në këtë mësim do të shohim se zemërbutësia bashkëshoqërohet me faljen, tesamuhin dhe Safhin. Të falurit e tjetrit konsiderohet prej cilësive dhe bazave morale. Është prej etikës islame të cilën, e përforcon sheriati në marrëdhëniet shoqërore. Siç u përmend edhe në mësimin e kaluar, armiqësia dhe shkelja e të drejtave janë faktorë me anë të të cilave mund të humbasin disa të drejta të veçanta gjatë jetës së përditshme. Britmat, këmbëngulja dhe kokëfortësia do të jenë parrulla e të gjithëve për të rikthyer të drejtat e tyre, atëherë ne do të shohim një varg të gjatë konfliktesh e armiqësish që do ta bënin jetën të hidhur dhe të padurueshme. Prandaj, erdhi Sheriati me

rrugëzgjdhjen morale të lavdërueshme dhe i nxiti besimtarët për zemërbutësi dhe për të falur.

Kur'ani Famëlartë na frymëzon për këtë duke thënë: **“Ti (Muhammed) merre të lehtë, urdhëro për mirë dhe largohu prej të paditurve.”** (Surja ‘El A'raf’: 199).

S'ka dyshim se falja duhet të jetë zakon në personalitetin tonë, e përhershme dhe jo e përkohshme e kalimtare. Për këtë në komentimin e ajetit të mësipërm thuhet: “I Dërguari i All-llahut e pyeti Xhebrailin për thënien dhe ai (Xhebraili) iu përgjigj: “Nuk e di derisa të pyes të Gjithëditurin. Më pas Xhebraili erdhi te Profeti dhe i tha: **“O Muhammed, All-llahu të urdhëron ty që ta falësh atë që të bën padrejtësi, ti japësh atij që nuk të jep dhe të vizitosh atë që nuk të viziton.”** (“Biharul Anvar”; vëll, 75, kreu 66, hadithi/4)

All-llahu (xh.sh.) i ka cilësuar besimtarët me këtë veti duke thënë: **“Të cilët japin kur janë çlirë edhe kur janë në vështirësi dhe që e frenojnë mllëfin, që u falin (të keqen) njerëzve ...”** (Sureja “Ali Imranë”: 134).

Po ashtu, Kur'ani Famëlartë nxit për faljen, ku thotë: **“Të ndershmit dhe të pasurit nga ju të mos betohen se nuk do t'u, japin të afërmve, të varfërve dhe atyre që për hir të All-llahut lanë vendlindjen e tyre, po le t'ua falin (gabimin) dhe mos t'ua zënë për të madhe. A nuk dëshironi që All-llahu t'ju falë ju? All-llahu fal dhe mëshiron shumë.”** (Surja “Nur”: 22). Dhe: **“... E nëse nuk merrni masa, nuk ua vini veshin dhe i falni, ta dini se All-llahu është mëkatfalës, mëshirues.”** (Surja “Tegabun”: 14).

Edhe Profeti Muhammed (s.a.s.) dhe imamët prej familjes së tij nëpërmjet thënieve të tyre i nxisin besimtarët që të zbukurohen me këtë cilësi lavdëruese.

Profeti Muhammed (s.a.s) ka thënë: **“All-llahu (xh.sh.) është Falës dhe e do atë që fal.”** (“Kenzul Ummal”; vëll. 3, f. 373, hadithi/7005)

Dhe: **“Kush ia fal myslimanit gabimet, All-llahu do t'ia falë atij gabimet Ditën e Gjykimit.”** (“Kenzul Ummal”; vëll. 3, f. 376, hadithi/7019)

Dhe: **“Zbatojeni faljen, sepse falja i shton robit krenarinë; prandaj falini të tjerët që All-llahu t'ju dojë.”** (“Biharul Anvar”; vëll, 71, kreu 93, hadithi/5)

Dhe: **“Atij që e shton faljen (për të tjerët), atij do t'i shtohet jeta.”** (“Biharul Anvar”; vëll, 75, kreu 81, hadithi/74)

Imam Aliu (a.s.) ka thënë: **“Të falurit është kurora e moraleve të mira.”** (“Gurerul Hikem”; f. 245)

Dhe: **“Dy gjërave nuk mund t'u peshohet shpërblimi i tyre: falja dhe drejtësia.”** (“Gurerul Hikem”; f. 446)

Dhe: **“Njeriu më i keq është ai që nuk fal gabimet dhe nuk mbulon të këqiat e tjetrit.”** (“Biharul Anvar”; vëll, 71, kreu 93, hadithi/6)

Dhe: **“Falja e paktë është e meta më e keqe dhe nxitimi në hakmarrje është mëkati më i madh.”** (“Gurerul Hikem”; f. 465)

Imam Bakiri (a.s.) ka thënë: **“Pendimi për të falurin është më i mirë dhe më i lehtë se sa pendimi për dënimin.”**

Imam Sadiku (a.s.) ka thënë: **“Ne, Ehli Bejti, personaliteti ynë është të falurit për atë që na bën keq e padrejtësi.”**

Dhe: **“Tri janë moralet e kësaj jete dhe të Ahiretit: Të falësh atë që të bën keq dhe padrejtësi, të mbash lidhjet farefisnore me atë që i ndërpret ato dhe të jesh i përmbajtur kur flitet keq për ty.”** (“Biharul Anvar”; vëll, 71, kreu 93, hadithi/3)

Dallimi me uf'uit (faljes) dhe Safhit

Në pamje të jashtme duket se fjala Safh është sinonimi i fjalës af'u (falje)_dhe të dyja fjalët flasin për një qëndrim të përbashkët i cili është; përgjigja e të keqes me të mirë, të mos e dënosh tjetrin për gabimet dhe të mos hakmerresh. Mirëpo, safhi ka kuptim më të gjërë sesa af'ui. Nëse af'ui është (falja), *safhi ka kuptimin të konsiderohen gjynahet apo gabimet sikur mos të kishin ndodhur, dhe, e kundërta ndodh me afu.*

All-llahu (xh.sh.) thotë në Kur'an: **“Ndëshkimi i së keqes bëhet me një të keqe në të njëjtën masë. Por kush fal e bën pajtim, shpërblimi i tij është tek All-llahu. Vërtet, Ai nuk i do keqbërësit,”** (Surja “Shura”: 40).

Për safhin All-llahu thotë: **“(E Zoti iu përgjigj): Hiq atyre pra, dhe thuaj: “Qofshi braktisur, e më vonë do ta kuptojnë!”** (Surja “Zubruf: 89).

“..e ti (Muhammed) sillu me njerëzishmëri.” (Surja “Hixhr”: 85).

Ajeti i parë në fillim vë re gabimin dhe përcakton dënimin; pastaj urdhëron për falje përballë shpërblimit të All-llahut (xh.sh.). Dy ajetet e tjera e ftojnë Profetin Muhammed (s.a.s.) që të mos e shohë gabimin. Nga Imam Rizai (a.s.) kumtohet se ajeti ka kuptimin: *“falje pa qortim.”*

Falja në mundësi

Vërtet, kuptimi i të falurit nuk realizohet vetëm e vetëm me makdaretu (brenda mundësive). Për këtë, nuk ka kuptim për të falurit në situata të pamundura dhe për t'ju përgjigjur të keqes me të mirë. Pamundësia, nganjëherë çon në ndjenjat e smirës, përbuzjes, lëshimin e akuzave, urrejtjes, gënjeshtërisë, etj.

Islami urdhëron për faljen e të tjerëve, sepse shoqëria dhe shteti Islam kanë marrë përsipër zbatimin e drejtësisë dhe heqjen e dënimit ndaj palës keqbërëse.

Në hadithet islame lexojmë se të falurit është i shoqëruar me mundësinë.

Profeti Muhammed (s.a.s) ka thënë: **“Ai që ka mundësi për falje, All-llahu do ta falë në Ditën e Gjykimit.”** (“Kenzul Ummal”; vëll. 3, f. 377)

Dhe: **“Njerëzit më të meritueshëm për falje, ato janë më të mundëshmit (ekderubum) për dënimin.”** (“Biharul Anvar”; vëll, 68, f. 420)

Imam Aliu (a.s.) ka thënë: **“Falja është zeqati i mundësisë.”** (“Gurerul Hikem”; f. 342)

Imam Hasani (a.s.) ka thënë: **“Njeriu më falës është ai që fal në kudretin e tij.”** (“Biharul Anvar”; vëll, 74, kreu 93, hadithi/76)

Imam Sadiku (a.s.) ka thënë: **“Falja në mundësi është synnet i të dërguarve dhe i të devotshmëve.”** (“Biharul Anvar”; vëll, 71, kreu 93, hadithi/62)

Në kohën e çlirimit të Mekkës kur ushtria myslimane hyri në të, flamurin e mbante shoku i Profetit, Sa'ad ibn i cili me zë të lartë tha: **“Sot është dita e masakrës. Sot do të bëhen të lejuara të ndaluarat (fjala është për të gjitha ato që ia morën myslimanëve Kurejshitët e Mekkës).”** (“Sherh Nebxhul Belaga”; vëll. 17, f. 272). Kur Profeti (s.a.s.) dëgjoji për këtë e urdhëroi Aliun që të shkonte te Sa'adi t'ia merrte flamurin dhe ta zgjidhte çështjen. Imam Aliu shkoi menjëherë, e mori flamurin prej Sa'adit dhe filloi të thoshte me zë të lartë: **“Sot është dita e faljes dhe e mëshirës.”** Edhe pse ushtria islame i kishte të gjitha mundësitë që të hakmerrej, të shkatërronte shtëpitë e Mekkës,

Profeti (s.a.s.) i fali të gjithë armiqtë e tij me gjithë ato veprime të shumtuara që pati

provuar prej Mekkasve. Dita e çlirimit të Mekkës është më e famshmia në historinë njerëzore. Në këtë histori duket qartë falja në Islam.

Vendet e të falurit

Ku mishërohet kuptimi i të falurit? Kur lejohet ai?

Në përgjigje të pyetjeve të lartpërmendura mund të thuhet se falja (af'ui) është e pëlqyeshme në të gjitha ato raste që kanë lidhje me çështjet personale, ndërsa në ato raste që kanë lidhje me të drejtat e përgjithshme, (me të drejtat ndaj All-llahut dhe ato shoqërore), falja nuk është e pëlqyeshme.

Në historinë islame thuhet se në kohën kur imam Aliu ishte udhëheqës i myslimanëve, njëri prej mëkëmbësve të tij shpërdoroi pasuritë e thesarmbajtëses. Imami i dërgoi atij një letër në të cilën thuhej: ***“Frikësohu All-llahut dhe ktheja atij populli pasuritë e tyre. Nëse nuk vepron e më pas All-llahu më mundëson që të të takoj, do t'i kërkoj falje All-llahut dhe do të godas me shpatën time. Çdo njeri që kam goditur me këtë shpatë ka hyrë në zjarr. Betohem në All-llah, sikur Hasani dhe Hyzejni do të vepronin siç veprova ti, ata nuk do të shpëtonin prej meje derisa t'ja ktheja të drejtën atij që ata i bënë padrejtësi.”***

Ai që shkel të drejtat e shoqërisë ai nuk mund të jetë meritues për falje. Po ashtu edhe ai që shpërdoron të drejtat e All-llahut dhe i shkel kufijtë e Tij.

Nëse i hedhim një vështrim jetëshkrimit të eulijave, do të shohim se ato kanë qenë në majat e af'uit, Safhit dhe tolerancës në ato çështje që kanë lidhje me të drejtat personale. Ndërsa, në të drejtat ndaj All-llahut dhe shoqërisë ata kanë qenë të ashpër e të prerë. Vërtet, falja është metodë morale me anë të së cilës pala tjetër e ndjen gabimin e tij dhe e shtyn atë që të mos e përsërisë më atë. Falja është e përshtatshme për njeriun e mirë e jo për të keqin, sepse falja nuk gjen dobi te ky njeri i keq. Jo vetëm kjo, por ai përfiton prej saj në shtimin e paturpësisë.

Imam Aliu (a.s.) ka thënë: ***“Falja për të keqin dëmton aq sa reformimi që bën i miri.”*** (“Biharul Anvar”; vëll, 77, kreu 15, hadithi/4)

Imam Zejnul Abedin (a.s.) ka thënë: ***“E drejta e atij që të bën keq është që ti ta falësh. Nëse e di se falja të dëmton ty ke fituar, sepse All-llahu (xh.sh) ka thënë: “E kush hakmerret për padrejtësitë që i janë bërë ndaj të tillëve nuk ka ndonjë përgjegjësi”*** (“Biharul Anvar”; vëll, 74, kreu 1, hadithi/1)

Përmbledhje

Falja dhe safhi janë prej bazave të moraleve në Islam dhe në jetën shoqërore.

Kuptimi i vërtetë af'uit (i faljes) arrihet vetëm në gjendjen e mundësisë (kudretit).

Vërtet, sheriati e pëlqen faljen (af'uin) në çështjet individuale, ndërsa në shkeljen e të drejtave të All-llahut dhe të drejtave shoqërore, af'ui (falja) nuk lejohet.

Pyetje

- 1- Cili është dallimin mes af'uit dhe safhit.
- 2- Përse af'ui (falja) sjell dobi me njeriun e mirë por jo me të keqin?
- 3- Përmendni hadithin e imam Sadikut rreth moraleve të kësaj bote dhe të Ahiretit.



Mësimi 12

DREJTËSIA

Drejtësia është prej bazave morale në Islam. Drejtësia në marrëdhëniet shoqërore do të thotë: e vërteta dhe drejtësia të jenë prezente gjithmonë tek ne; pra të themi të vërtetën dhe ta zbatojmë atë edhe nëse është kundra nesh, të duam për të tjerët atë që duam për vetën tonë. Drejtësia është shkak i ekzistencës së bazave konstante (të palëkundshme) në jetën shoqërore që ligjet e saj të zënë vend tek të gjithë. Pra, drejtësi do të thotë: zbatimi i ligjit. Vërtet, të drejtat e individëve dhe detyrat e tyre janë të përcaktuara në atë mënyrë që të vërtetohet drejtësia. Gabimi në këtë shpërndarje do të thotë padrejtësi. Puna është se njerëzit flasin shumë për drejtësinë. Por kur kjo drejtësi është në dobi të tyre individuale, ata zgjedhin interesin e tyre. Ndoshta dikush e ndërron një ligj që të përfitojë për vete.

Imam Aliu (a.s.) ka thënë: **“Drejtësia është gjëja më e gjërë në njohje dhe më e ngushta në veprim.”** (“Nehxhul Belaga”; f. 332, fjalimi 216)

Kur flasim për drejtësinë, fluturojmë në qiellin e të menduarit. Por, kur e drejta na bëhet detyrë për t’u zbatuar tek të tjerët, ne biem në hall të madh! Drejtësia është me fjalë dhe me vepër.

All-llahu (xh.sh.) thotë: **“...Kur të flisni (të dëshmoni), duhet të jeni të drejtë edhe nëse çështja është për (kundër) të afërmit. Dhe zotimin e dhënë All-llahut plotësojeni. Këto janë ato që Ai ju porosit kështu që të kujtoni.”** (Surja “El-En’am”:152).

Dhe: **“O ju që besuat, të jeni gjithnjë dëshmuar të drejtë për hir të All-llahut edhe nëse është kundër (interesit) vetvetes tuaj, kundër prindërve, ose kundër të afërmeve, le të jetë ai (për të cilin dëshmohet) pasanik ose i varfër, sepse All-llahu di më mirë për ta. Mos ndiqni pra emocionin e t’i shmangeni drejtësisë. Nëse shtrembëroni ose tërhiqeni, All-llahu e di hollësisht çfarë bëni.”** (Surja “Nisa”: 135).

Sipas këtij ajeti duket qëndrimi i njeriut besimtar i cili ka si bazë drejtësinë, dhe të vërtetën.

Pra, ka një peshore të përhershme dhe kjo peshore është drejtësia. Kjo peshore nuk u nënshtrohet ndikimeve të jashtme, p.sh, nuk ndikohet prej marrëdhënieve, emocioneve e lakmisë. Kjo do të thotë se njeriu duhet të gjykojë me drejtësi në çdo vend e në çdo kohë, qoftë ky gjykim kundër vëllait të vet, nënës së vet, babait të vet. Njeriu duhet të gjykojë me drejtësi edhe nëse i akuzuari është i varfër dhe mos i japë të drejtë të pasurit për pasurinë që ka.

All-llahu (xh.sh.) thotë: **“O ju që besuat! Bëhuni plotësisht të vendosur për hir të All-llahut, duke dëshmuar të drejtën, dhe të mos ju shtyjë urrejtja ndaj një populli e t’i shmangeni drejtësisë! Bëhuni të dretë, sepse ajo është më afër devotshmërisë. Kijeni frikë All-llahun, se All-llahu e di hollësisht se çfarë bëni.”** (Surja “Maide”: 8).

Peshorja e drejtësisë nuk ndikohet prej marrëdhënieve tona me të tjerët. Mundet që dikush të bëjë ndonjë vepër të keqe; por ne duhet të jemi të drejtë me të duke zbatuar drejtësinë.

Hadithet e përcjella nga Profeti dhe imamët e pastër e lavdërojnë shumë vlerën e drejtësisë.

Profeti Muhmmmed (s.a.s.) ka thënë: **“Njeriu më i drejtë është ai që do për njerëzit atë që don për veten e tij, dhe urren për ata, atë që urren për veten e tij.”** (“Biharul Anvar”; vëll, 75, kreu 35, hadithi/ 1)

Imam Aliu (a.s.) ka thënë: **“All-llahu do ta bëjë krenar atë që bën drejtësi me njerëzit.”** (“Biharul Anvar”; vëll, 75, kreu 35, hadithi/ 25)

Në testamentit e tij për imam Hasanin (a.s) imam Aliu thotë: **“O biri im, barazoje veten tënde me të tjerët. Dëshiro për të tjerët atë që dëshiron për veten tënde dhe urrej për të, atë që urren për veten tënde! Mos bëj padrejtësi, sillu mirë si don që të sillen mire me ty. Përbuz për veten tënde atë që e përbuz për të tjerët, duaj për njerëzit atë që do për veten tënde dhe mos thuaj për ta atë që nuk të pëlqen të ta thonë ty.”** (“Biharul Anvar”; vëll, 75, kreu 35, hadithi/ 21)

Në këtë tekst testamenti shohim një program të hollësishëm për drejtësinë. Ky program është që vetë njeriu të jetë peshore. T’i duam tjetrit atë që e duam për veten tonë dhe të urrejmë për të atë që e urrejmë për veten tonë, të mos i bëjmë padrejtësi askujt, siç nuk duam që të na bëjnë padrejtësi.

Imam Aliu (a.s.) i ka thënë Maliku Eshterit: ***“Bëhu i drejtë ndaj All-llahut dhe ndaj njerëzve, ndaj vetes tënde, veçanërisht me familjen tënde dhe me ata që janë nën përgjegjësinë tënde. Nëse nuk vepron kështu, do të jesh i padrejtë. Ai që është i padrejtë, All-llahu do të jetë kundërshtari. Për atë që All-llahu është kundërshtari i tij, do t’i dobësohen faktet dhe do të jetë në luftë me Zotin derisa të bindet e të pendohet*** (për padrejtësitë e bëra).” (*“Biharul Anvar”*; vëll. 33, kreu 3, hadithi/744)

Këtu po përmendim disa fjalë përmbledhëse të imam Aliut (a.s.) rreth drejtësisë:

- 1- ***“Drejtësia është shkak i vazhdimësisë së dashurisë.”*** (*“Gurerul Hikem”*; f. 393)
- 2- ***“Drejtësia bashkon zemrat.”*** (*“Gurerul Hikem”*; f. 393)
- 3- ***“Drejtësia largon kundërshtimet dhe sjell dashuri.”*** (*“Gurerul Hikem”*; f. 393)

Kujtesë morale

Prej haditheve të mësipërme nxjerrin si përfundim se drejtësia dhe barazia në marrëdhëniet shoqërore do të thotë barazi e vetes me të tjerët në të gjitha të drejtat shoqërore. Shoqëria islame është e ndërtuar mbi barazinë në të drejta dhe detyrime. Ajo është shoqëri e pavarur, e solidarizuar dhe sipërmarrëse për përhapjen e dashurisë, të respektit dhe të miqësisë.

Por, duhet të kuptojmë se barazia e njerëzve me vetveten është çështje e vështirë, sepse njeriu bie në kundërshtim me “dashurinë e vetvetes”, e cila i ka rrënjët në brendinë e njeriut. Për këtë imam Sadiku (a.s.) ka thënë: ***“A t’ju them gjënë më të lartë, të cilën All-llahu ua ka bërë detyrë (farz) krijesave të Tij? Barazia e njerëzve me vetat e tyre.”*** (*“Biharul Anvar”*; vëll. 72, f. 27)

Në jetëshkrimin e imam Sadikut (a.s.) transmetohet se një prej shokëve të tij i ka dërguar një letër dhe e ka pyetur për disa çështje. Imami u është përgjigjur çështjeve përvç njëjës, e cila kishte të bënte me të drejtat e besimtarëve. Kur erdhi koha të udhëtonte nga Medina shkoi të takonte imamin dhe i tha: ***“O zotëria im, përse nuk iu përgjigje pyetjes sime?”*** Imam Sadiku i tha: ***“Kisha frikë se po të përgjigjesha nuk do ta zbatoje dhe do të dilje nga feja.”*** Më pas i tha: ***“All-llahu u ka bërë detyrim robve të Tij tri gjëra më të mëdha: Barazia e tjetrit me vetën tënde, të veprosh me vëllanë tënd mysliman ashtu siç do të veprohet me ty, të këshillosh vëllezërit e tu, ta përmendësh All-llahun në çdo kohë jo vetëm duke thënë “Subhanall-llahi, uel hamdulil-lahi, por nëse të propozohet diçka e ndaluar (haram) ta kujtosh All-llahun.”***

Pra, barazia me të tjerët është prej detyrave të rrepta, të cilën All-llahu e ka caktuar për robtë e Tij. Për këtë, duhet që çdo mysliman të bëjë xhihad me veten e tij dhe ta qetësojë veten, që ta shohë drejtësinë në sytë e tij përherë. Ai duhet të thotë vetëm të vërtetën, të zbatojë të drejtën duke dashur për njerëzit e tjerë atë që do për veten e tij dhe t’u urojë atyre gjithmonë të mirën, ashtu siç e uron për veten e tij.

Përmbledhje

Drejtësi do të thotë barazia e tjetrit me veten në çdo të drejtë shoqërore dhe zbatimi i drejtësisë. Në këtë veprim gjindet krenari, pavarësi dhe siguri në shoqëri; rritet solidariteti mes njerëzve dhe përhapet dashuria e miqësia.

Barazia, siç u pa në hadithe është prej detyrave të vështira të caktuara nga All-llahu (xh.sh.).

Pyetje

1-Cili është etaloni që e cakton imam Aliu për barazinë në testametin e tij për imam Hasanin (a.s.)?

2-Sqaroni disa ndikime dhe fryte të barazisë.

4-Përse konsiderohet vepër e vështirë morale barazia e vetes me tjetrin?



Mësimi 13

FYTYRA E QESHUR DHE SHAKAJA

Edhe këto janë prej etikës islame në marrëdhëniet shoqërore dhe prej dukurive të sjelljes së njeriut në jetën e tij. Fytyra e qeshur është prej moralit të të dërguarve dhe eulijave. Për këtë na vjen hadithi i profetit Muhammed (s.a.s.): ***“Ju nuk do t’i bëni të lumtur njerëzit me pasurit tuaja, prandaj takojini ata me fytyrë të qeshur dhe me fjalë të mira.”*** (“Bibarul Anvar”; vëll, 74, kreu 38, hadithi/36)

Këto fjalë të ndritshme na sqarojnë një të vërtetë të rëndësishme që është qëllimi ynë: që të fitojmë dashurinë e njerëzve, të mos kemi mjet tjetër përveç moralit të mirë, ku gjëja më e paktë që mund të bëjmë është takimi i njerëzve me fytyrë të qeshur e me buzëqeshje. E kjo do të thotë që edhe sikur të ketë një shqetësim

besimtari duhet ta fshehë hidhërimin e tij në zemër dhe t'i takojë të tjerët me fytyrë të qeshur.

Imam Aliu (a.s.) ka thënë: **“Buzëqeshja e besimtarit është në fytyrën e tij, ndërsa zemërimi në zemrën e tij.”** (“Biharul Anvar”; vëll, 67, kreu 14, hadithi/37)

Këtu na bëhet e qartë se besimtari duhet t'i takojë shokët, miqtë, vëllezërit, fqinjët e tij me fytyrë të qeshur. Nëse ka ndonjë problem, a është i hidhëruar për shkak të ndonjë problemi, duhet që hidhërimin ta mbajë në zemrën e tij, sepse hidhërimi në fytyrë do të ketë ndikime negative për të tjerët. Në qoftë se do ta lejojmë hidhërimin që të përhapë hijen e tij të zezë në fytyrë, atëherë dalëngadalë shoqëria do të goditet me fatkeqësi. Mirëpo, shoqëria islame duhet të jetë shoqëri e lumtur, e gjallë e plot energji.

Ndikimet dhe frytet e fytyrës së qeshur

Fytyra e qeshur ka ndikime pozitive në jetën vetjake e shoqërore. Në hadithet e Profetit (s.a.s.) dhe të Ehli Bejtit përmenden mjaft dobi kur zbatohet fytyra e qeshur. Profeti Muhammed (s.a.s.) ka thënë: **“Fytyra e qeshur largon skëtërrat.”** (pra, fytyra e qeshur shkatërron urrejtjet dhe pastron zemrat.) (“Biharul Anvar”; vëll, 74, kreu 10, hadithi/41)

Imam Aliu (a.s.) ka thënë: **“Fytyra e qeshur është litari i dashurisë në marrëdhënie.”** (“Biharul Anvar”; vëll, 75, kreu 59, hadithi/12)

Dhe: **“Fytyra e qeshur është njëra prej dy afrimeve (afrimi të All-llahu dhe afrimi të njerëzimit).”** (“Biharul Anvar”; vëll, 75, kreu 59, hadithi/9)

Dhe: **“Nëse takoni vëllezërit tuaj, jepuani dorën dhe u shfaqni atyre buzëqeshjen dhe çiltërsinë. (nëse veproni kështu), Kur të ndaheni, çdo gjynah do t'u hiqet.”** (“Biharul Anvar”; vëll, 75, kreu 59, hadithi/19)

Dhe: **“Gjëja më e mirë me të cilën zbuten zemrat e njerëzve sëmundjet e tyre dhe zhduket smira që gjendet në zemrat e armiqve të tyre është; fytyra e qeshur, kur i takon njerëzimit, interesimi për ta kur nuk janë të pranishëm dhe buzëqeshja kur janë të pranishëm.”** (“Biharul Anvar”; vëll, 7, kreu 8, hadithi/83)

Dhe: **“Buzëqeshja tregon fismikërinë tënde.”** (“Gurerul Hikem”; f. 434)

Imam Bakiri (a.s.) ka thënë: **“Përhapja e gëzimit dhe fytyra e qeshur sjellin dashurinë dhe afrimin tek All-llahu (xh.sh.). Ndërsa fytyra e vrenjtur sjell zemërim dhe largim nga All-llahu (xh.sh.).”** (“Biharul Anvar”; vëll, 75, kreu 8, hadithi/83)

Këto hadithe dëshmojnë për rolin e sjelljes buzagaz në forcimin e marrëdhënieve shoqërore mes individëve të saj. Meqenëse myslimani nuk e kufizon interesimin e tij vetëm në këtë jetë, ka hadithe të tjera, të cilat tregojnë për ndikimet e fytyrës së qeshur në ahiret.

Imam Sadiku (a.s.) ka thënë: **“Nëse një njeri zbaton një prej këtyre tri gjërave; dhënia në situata të vështira, buzëqeshja për njerëzimit dhe barazia e njerëzve me veten e vet All-llahu do ta fusë atë në Xhennet.”** (“Biharul Anvar”; vëll, 74, kreu 10, hadithi/28)

Shakaja

Kur flitet për fytyrën e qeshur dhe buzëqeshjen, në mendime vjen shakaja dhe përkëdhelia. Në qoftë se duam ta njohim qëndrimin e Sheriatit Islam për shakanë këtë e gjejmë në hadithet e përcjella. Ato janë dy grupesh: Grupi i parë e pëlqen shakanë, grupi tjetër nuk e pëlqen atë.

Grupi i parë

Profeti Muhammed (s.a.s.) ka thënë: **“Besimtari është përkëdhelës dhe i butë, ndërsa dyfytyraku (hipokriti) është i ashpër dhe zemërzi.”** (“Biharul Anvar”; vëll, 77, kreu 7, hadithi/1)

Dhe: **“Unë bëj shaka dhe them të vërtetën.”** (“Biharul Anvar”; vëll, 16, kreu 10, hadithi/2)

Imam Sadiku (a.s.) ka thënë: **“Besimtar është ai që në veten e tij ka deabetun.”** Atij i thanë: **“Çështë deabetu?”** Ai (a.s.) tha: **“Shakaja.”** (“Biharul Anvar”; vëll, 71, kreu 80, hadithi/18)

Imam Sadiku (a.s.) e ka pyetur Junus ibn Shejbanin: **“Si është shakaja juaj me njëri-tjetrin?”** Unë (Junusi) i thashë: **“E pakët”** Imami i tha: **“Bëjeni, sepse shakaja është prej moraleve të mira dhe me anë të saj t'i gëzon vëllanë tënd. Profeti Muhammed (s.a.s) ka bërë shaka me dikë me qëllim që ta gëzonte atë.”** (“Biharul Anvar”; vëll, 76, kreu 106, hadithi/13)

Grupi i dytë

Profeti Muhammed (s.a.s.) ka thënë: **“O Ali, mos bëj shaka, sepse ikën personaliteti dhe mos gënje sepse të ikën nuri.”** (“Biharul Anvar”; vëll, 77, kreu 3, hadithi/10)

Imam Aliu (a.s.) ka thënë: **“Askush nuk e arrin besimin e vërtetë derisa të mos e bëjë shakanë dhe gënjeshtren dhe e lë debatin edhe pse ka të drejtë.”**

Dhe: **“Shakaja trashëgon smirën.”** (“Biharul Anvar”; vëll, 77, kreu 3, hadithi/10)

Dhe: **“Çdo gjë ka një zanafillë dhe zanafilla e armiqësisë është shakaja.”** (“Gurerul Hikem”; f. 436)

Dhe: **“Armiku i respektit është shakaja.”** (“Gurerul Hikem”; f. 436)

Dhe: **“Ai që bën shaka nënvleftësohet.”** (“Biharul Anvar”; vëll, 77, f.237)

Imam Sadiku (a.s.) ka thënë: **“Mos bëj shaka, sepse do të flasin për ty.”** (“Biharul Anvar”; vëll, 77, kreu 106, hadithi /10)

Dhe: **“Mjerë ju dhe shakaja, sepse shakaja largon dinjitetin dhe dashurinë e njeriut.”** (“El- Vesail”; vëll. 12f. 118)

Dhe: **“Mjerë ju dhe shakaja, sepse shakaja largon nderimin.”** (“Biharul Anvar”; vëll, 73, f. 60)

Në këto dy grupe hadithesh zbulojmë se Islami nuk ka qëndrim të prerë për punën e shakasë dhe e quan atë të kushtëzuar, sepse Islami nuk ia pëlqen besimtarit el-hezl (kotësinë) në jetën e tij. Prandaj kërkohet prej myslimanit që të jetë realist në jetën e tij drejt përsosurisë. Shakaja çon nganjëherë në fyerjen e të tjerëve dhe mbjell urrejtje tek ta. Përderisa Islami ka si qëllim të përhapë rrezet e dashurisë dhe shpirtin e gjallërisë, ai e pëlqen buzëqeshjen dhe shakanë, por me kusht që shakaja të mos e kalojë rrethin e së vërtetës dhe të mos përdoren fjalë të rënda, të cilat e prishin

moralin. Shakaja është si kripa e gjellës, që hidhet në të për ta bërë ushqimin të shijshëm. (Siç thotë populli: *“gjella me kripë por kripa me karar (me masë).”* R.)

Grupi i tretë

Kur lexojmë grupin e tretë të haditheve e kuptojmë se e papëlqyeshmja në shaka është vetëm tepria e saj.

Profeti Muhammed (s.a.s.) ka thënë: **“Tepria në shaka e ul dinjitetin.”** (“El-Kafj”; vëll. 2, f. 665)

Imam Aliu (a.s.) ka thënë: **“Shakaja e tepërt rrëzon respektin.”** (“Gurerul Hikem”; vëll.4 f. 591)

Dhe: **“Shakaja e tepërt largon nderimin dhe sjell poshtërimin.”** (“Gurerul Hikem”; vëll.4 f. 597)

Dhe: **“I bie respekti atij që e tepron shakanë.”** (“Gurerul Hikem”; vëll.5 f. 293)

Pra, tepria në shaka çon në humbjen e dinjitetit, të dashurisë e respektit në jetë. Tepria mbjell edhe urrejtje në shpirtërat e të tjerëve dhe shkatërron lidhjet shoqërore e miqësore mes anëtarëve të shoqërisë. Në qoftë se lexojmë jetëshkrimin e Profetit Muhammed (s.a.s.) dhe të familjes së tij të pastër, do të shohim mjaft shembuj kur shakaja fut gëzim te njerëzit dhe sjell buzëqeshje në fytyra. Prej atyre shembujve përmendim:

Një grua e moshuar shkoi te Profeti Muhammed (s.a.s.) dhe i kërkoi atij që të bënte lutje për të për të hyrë në Xhennet. Profeti (s.a.s.) i tha: **“Në Xhennet nuk ka të moshuar.”** Kur gruaja e moshuar filloi të qante Profeti i lexoi asaj ajetet e Kur’anit: **“Ne i kemi krijuar ato në një formë të re, dhe ato i kemi bërë virgjëresha.”** (Surja “Vakia”: 35-36). Kur dëgjoi këto ajete, e moshuara buzëqeshi dhe e kuptoi se All-llahu (xh.sh.) do t’i ringjallte njerëzit në moshë të re.”

Një ditë Um Ejmen shkoi te Profeti (s.a.s.) dhe i tha: **“Burri im të çon selam.”**

Profeti Muhammed (s.a.s.) i tha: **“Burri yt është ai që ka të bardhë në sy?”** Um

Ejmen kujtoi se Profeti e kishte fjalën për sëmundjen dhe i tha: **“Në sytë e tij nuk**

ka të bardhë.” Profeti i tha: **“Po ai ka të bardhë në sytë e tij.”** Ajo i tha: **“Të**

betohem në All-llahun që nuk ka.” Profeti me buzëqeshje i tha: **“E kush është ai**

në sytë e të cilit nuk gjendet e bardha? Atëherë, Um Ejmen buzëqeshi me këtë shaka.

Një burrë që banonte në shkretëtirë, shkante te Profeti dhe i dërgonte dhuratë.

Mirëpo ai nuk çohet pa kërkuar vlerën e saj. Profeti buzëqeshte dhe të tjerët që ndodheshin me të qeshnin. Sa herë që Profeti ndihej i hidhëruar, thoshte: “Ah sikur të vinte ai a’rabi (banori i shkretëtirës)!”

Një burrë shkon te Profeti (s.a.s.) dhe i kërkon devenë për të mbarur diçka. Profeti

(s.a.s.) i tha: “Nuk kemi deve por kemi fëmijën e saj.” Ai burri i tha: “Mallrat e mia

janë të rënda dhe fëmija e devesë nuk mund t’i mbajë.” Profeti (s.a.s.) duke

buzëqeshur i tha: **“A nuk ka për çdo deve fëmijë!”** Ai burri qeshi.”

Një ditë Profeti (s.a.s.) po hante hurma me imam Aliun (a.s.) dhe farat e hurmës i

vendoste nga ana e imam Aliut. Kur mbaruan së ngrëni Profeti i tha imam Aliut

(a.s.): **“Sa shumë që i ha ti hurmat.”** Kur ktheu sytë imam Aliu pa se farat e hurmës

ishin nga ana e tij e te Profeti nuk kishte asnjë farë. Duke buzëqeshur, tha: **“Hamësi**

më i madh është ai që i hëngri hurmat me gjithë farat e tyre!” Në ato momente në fytyrën e Profetit (s.a.s) shkëlqeu buzëqeshja.

Në këta shembuj shihet qartë dallimi mes shakasë së pastër nga gënjeshtria e kotësia. Nga shembujt mësojmë se si duhet të bëjmë shaka me vëllezërit tanë dhe si të fusim në zemrat e tyre gëzimin, harmoninë e si të shtohen e të forcohen kështu lidhjet dhe marrëdhëniet tona.

Përmbledhje

Fëtyra e qeshur është prej moralit islam. Kjo cilësi zhvillohet nëpërmjet fisnikërisë dhe sjelljes së mirë. Ajo luan rol në forcimin e marrëdhënieve vëllazërore mes pjesëtarëve të shoqërisë. Shakaja është prej shkaqeve të fytyrës së qeshur, me kusht që të mos ketë tepri në të, sepse përndryshe, njolloset morali.

Pyetje

- 1- Cilat janë ndikimet e fytyrës së qeshur në shoqëri siç na e sqarojnë Profeti (s.a.s.) dhe imamët e pastër?
- 2- Kur kërkohet shakaja?
- 3- Përmendni një hadith nga imam Aliu (a.s.) rreth fytyrës së qeshur. .
- 4- Cilat janë ndikimet dhe frytet e fytyrës së qeshur në Ahiret?

Mësimi 14

SOLIDARITETI DHE BASHKËNDIMESA PËR PËRMBUSHJEN E NEVOJAVE TË TË TJERËVE

Në mësimin e dytë mësuam se besimtarët janë vëllezër dhe vëllazëria ka nevojë për solidarësi dhe bashkëpunim. Besimtarët janë pjesëtarë të një familjeje të përbashkët

në shoqërinë islame. Prej rregullave dhe moralit të vëllazërisë është: vëllai ta ndihmojë vëllanë e tij kur ky ka ndonjë problem a vështirësi.

Sa e bukur është kjo tablo të cilën e vizaton hadithi i njohur i Profetit Muhammed (s.a.s.): **“Në mëshirë e në dashuri besimtarët janë të njëjtë me trupin. Kur një organ i trupit ankohet prej tij edhe organet e tjera do të goditen me dhimbjen dhe lëndimin.”** (“Biharul Anvar”; vëll, 74, f. 234)

Individi në jetën e tij përballet me probleme e vështirësi. Por, kur shikon se vëllezërit e tij solidarizohen me të dhe i qëndrojnë pranë, ai do të ndiejë ngrohtësi dhe shpresë. Edhe ai qëndron pranë tyre kur vëllezërit e tij kanë nevojë për përkrahjen dhe ndihmën e tij. Në këtë mënyrë rrënjohet shpirti i dashamirësisë dhe i vëllazërisë mes anëtarëve të shoqërisë.

All-llahu (xh.sh) thotë: **“... ndihmoni njëri-tjetrin në të mira dhe në të mbarë, e jo në mëkate e në armiqësi...”** (Surja “Maide”, 2).

Bashkëpunimi ka nevojë për shpirt dhe interesim mes myslimanëve.

Profeti Muhammed (s.a.s) ka thënë: **“Kush gdhahet dhe nuk interesohet për punët e myslimanëve, nuk është prej myslimanëve.”** (“Biharul Anvar”; vëll, 77, kreu 20, hadithi /120)

Dhe: **“Ai që dëgjon një mysliman, i cili thërret “o mysliman” dhe nuk i përgjigjet, nuk është mysliman.”** (“Biharul Anvar”; vëll, 75, kreu 59, hadithi /12)

Solidarësia, ndihma dhe përkrahja e besimtarëve është detyrë islame. Nëse dikujt i dhurohet pasuri dhe ai nuk u jep vëllezërve të tij, tregohet koprrac, nuk i plotëson kërkesën nevojtarit, nuk e ndihmon atë nuk është më mysliman, sepse prej rregullave të moralit islam është shpirti i bashkëpunimit.

Imam Bakiri (a.s.) ka thënë: **“Ai që tregon koprraci për të ndihmuar vëllanë e tij mysliman dhe për t'i kryer atij nevojën që i duhet, do të përballet me ndihmën e tij që bën gjunah dhe nuk shpërblehet.”** (“Biharul Anvar”; vëll, 75, kreu 59, hadithi /8)

Imam Sadiku (a.s.) ka thënë: **“Besimtarit që i shkon një vëlla i tij për t'i kërkuar ndihmë dhe ai nuk e ndihmon kur ka mundësi për ta ndihmuar, All-llahu do ta sprovtojë në kryerjen e nevojës armiqve tanë dhe All-llahu do ta dënojë për këtë veprim në Ditën e Gjykimit.”** (“Biharul Anvar”; vëll, 75, kreu 59, hadithi /21)

Imam Musa Kadhimi (a.s.) ka thënë: **“Kushdo, të cilit i shkon një vëlla (mysliman) dhe i kërkon diçka dhe ai nuk e ndihmon dhe ka mundësi që ta ndihmojë, e ka shkëputur kujdestarinë e All-llahut (xh.sh.)”** (“Biharul Anvar”; vëll, 75, kreu 59, hadithi /21)

Në një hadith të përcjellë nga imam Sadiku (a.s.), i cili neglizhencën për të plotësuar nevojat e quan tradhti, thuhet: **“Cilido besimtar që nuk e ndihmon besimtarin për atë që ka nevojë dhe ka mundësi për ta ndihmuar vetë, ose nëpërmjet një tjetri, do të dalë para All-llahut me fytyrë të nxirë, me sy të nxirë dhe me duar të lidhura në qafën e tij. Atij do t'i thuhet: Ky është tradhtar, tradhtoi All-llahun dhe të Dërguarin e Tij. Pastaj e hedhin në zjarr.”** (“Biharul Anvar”; vëll, 7, kreu 8, hadithi /83)

Thënia tregon se mundësia për të ndihmuar besimtarin nuk është e kufizuar vetëm në ndihmë personale, ndihma mund të jepet edhe nëpërmjet të tjerëve; besimtarë, institucione, etj. Transmetohet nga Uakidij (dijetar islam): “Unë kam pasur dy shokë dhe njëri prej tyre ishte hashimij (prej gjenezës së Profetit). Ne ishim një shpirt në tre trupa. Një vit prej viteve, kur po afrohej Bajrami, kisha nevojë për para.

Bashkëshortja ime më tha: “Unë e ti durojmë, por fëmijët kur të shohin fëmijët e fqinjëve të veshur me rroba të reja, do t’u thyhet zemra. Prandaj merr borxh që t’u blejmë rroba të reja. Unë i shkrova letër shokut tim hashimijut që të më dërgonte para. Shoku im më çoi një qese të lidhur. Më shkruante se në qese ishin një mijë derhem. Kur po hapja qesen, trokiti dera. Njeru që trokiti më dha një letër që ma dërgonte shoku tjetër. Ai më shkruante se kishte nevojë për një shumë parash. I dhashë qesen me derhem dhe u nisa për në xhami i turpëruar nga bashkëshortja ime. Në xhami takova shokun tim hashimij, i cili mbante në dorë qesen e dërhemeve. Ai më tha: “Çfarë bëre me paratë që të dërgova?” Unë i tregova atij ngjarjen. Ai më tha: “A e di se ato para që të dërgova ishin gjithçka që kisha?” Kur t’i dërgova ato, unë i shkrova letër shokut tonë dhe e lajmërova për nevojën që kisha, por ai nuk kishte para. Për këtë ai të shkroi ty letër për të të kërkuar para dhe ti i dërgove atij këto derhem dhe ai mi dha mua. Siç e sheh kjo shumë derhemësh iu kthye përsëri të zotit. Tani, përderisa puna është kështu, paratë t’i ndajmë më tresh së bashku, sepse të gjithë ne kemi nevojë për para.”

Shiko se çfarë bën lidhja shoqërore! Për ndihmën dhe përkrahjen imam Aliu (a.s.) ka thënë: **“Shoku nuk është shok nëse nuk e ruan vëllanë e tij në tri çështje; kur është në vështirësi, kur nuk është i pranishëm dhe pas vdekjes së tij.”** (“Biharul Anvar”; vëll, 74, kreu 10, hadithi / 28)

Pra, shoku e ndihmon shokun e tij në vështirësi, e mbron familjen e tij kur ai nuk është i pranishëm dhe kur vdes, është i pari që shkon për të kryer detyrën e shoqërisë për këtë rast (vdekje). Kur’ani Famëllartë thotë: **“Dhe ata që përgatitën vendin (Medinen) dhe besimin para tyre, i duan ata që shpërguleshin te ata dhe nuk ndiejnë në gjokset e tyre ndonjë nevojë (për zili a tjetër) nga ajo që u jepej atyre (muhaxhirëve); madje, edhe sikur të kishin vetë nevojë për të, ata u jepnin përparësi atyre para vetvetes. Kush është i ruajtur prej lakmsë së vet, është i shpëtuar,”** (Surja “Hasbr”, 9).

Imam Sadiku (a.s.) ka thënë: **“Nëse një person më kërkon një nevojë, unë përpiqem në kryerjen e saj prej frikës se do të bëhet i mjaftueshëm prej saj dhe nuk do t’i gjejë asaj vend.”**

Vërtet, bashkëpunimi dhe ndihma mes besimtarëve luajnë rol të madh në forcimin e marrëdhënieve shoqërore në këtë jetë dhe kanë shumë mirësi në ahiret.

Imam Aliu (a.s.) ka thënë: **“Përkrahja e vëllait për hir të All-llahut i shton mirësitë.”** (“Biharul Anvar”; vëll, 74, kreu 28, hadithi / 22)

Nga imam Sadiku (a.s.) na vjen thënia e tij; **“Afrohuni tek All-llahu duke ndihmuar vëllezërit tuaj.”** (“Biharul Anvar”; vëll, 74, kreu 28, hadithi / 5)

Dhe: **“Kush i mbaron një nevojë vëllait të tij besimtar, All-llahu do t’i mbarojë atij njëqind prej nevojave të tij në Ditën e Gjykimit. Prej tyre, e para do të jetë Xhenneti, do të fusë në Xhennet të afërmit e tij, të njohurit dhe vëllezërit e tij të cilët nuk e meritonin Xhennetin.”** (“Biharul Anvar”; vëll, 74, kreu 20, hadithi / 90)

Ky moral i lartë vlerësohet deri në adhurim. Për këtë Profeti ynë Muhammedi (s.a.s.) ka thënë: **“Betohem në All-llah! T’i mbarosh një nevojë besimtarit është më e mirë sesa agjërimi i muajit dhe i’ tikafi i tij.”** (“Biharul Anvar”; vëll, 74, kreu 20, hadithi / 8)

Një prej shokëve të imam Sadikut transmeton: “Një vit, shkova në Haxh dhe shkova tek Ebi Abdullahi Sadik. Xhafer ibën Muhammed (a.s.) i cili më tha: **“Nga erdhët?”**

Unë i thashë: *“U bëfsha kurban për ty, isha në haxh.”* Ai më tha: *“A e di se çfarë shpërblimi ka ai që kryen haxhin?”* - I'a ktheva: *“Nuk e di derisa të ma mësosh.”* Ai tha: *“Vërtet, kur robi bën Tauaf në këtë Shtëpi shtatë herë, fal dy rekatet e tauafit, kryen sa'jin mes Safasë e Mervasë, All-llahu do t'i shkruajë atij gjashtë mijë të mira, do t'i fshijë gjashtë mijë të këqija, do ta lartësojë në gjashtë mijë shkallë, do t'i plotësojë gjashtë mijë nevoja në këtë jetë dhe në Jetën tjetër.”* Unë i thashë: U bëfsha kurban për ty! Kjo është shumë. Ai tha: *“A të të tregoj se çfarë është më shumë se kjo?”* - i thashë: *“Po, ma trego.”* Ai (a.s) tha: *“T'i mbarosh nevojën besimtarit është më e mirë sesa Haxhi, Haxhi, Haxhi..... e tha dhjetë herë.”* (*“Biharul Anvar”*; vëll, 74, kren 20, hadithi /4)

Këto janë disa shembuj të përcjellë nga Ehli Bejti (a.s.) për vlerësimin e ndihmës së besimtarit për besimtarin.

Përmbledhje

Vërtet, anëtarët e shoqërisë islame janë si organet e një trupi të vetëm. Solidarësia, bashkëpunimi, ndihma, plotësimi i nevojave të besimtarëve është prej moralit të tyre islam. Në këto vepra ka shpërblim të madh nga All-llahu. E kundërta, mënjanesia dhe moszbatimi i tyre sjell zemërimin e All-llahut (xh.sh.).

Pyetje

- 1- Përse Profeti Muhammed (s.a.s.) ka thënë se të jesh mysliman do të thotë të interesohesh për çështjet e myslimanëve?
- 2- Si i cilëson Kur'ani marrëdhëniet e besimtarëve me njëri-tjetrin? Thoni ajetin.
- 3- Përmendni shembuj për të mirat që sjell plotësimi i nevojave të besimtarëve, siç thonë hadithet.
- 4- Përmendni hadithin e imam Sadikut që flet për përmbushjen e kryerjes së nevojave të besimtarit.

Mësimi 15

HARMONIA DHE PAJTIMI MES BESIMTARËVE

Në mësimin e kaluar u tha se përmbushja e nevojave të njerëzve dhe interesimi për problemet e tyre është në krye të etikës. Islami i nxit myslimanët që të zbukurohen me këtë moral. Në këtë mësim do të mësojmë për harmoninë dhe pajtimin mes besimtarëve.

E pyetën Profetin Muhammed (s.a.s.) një ditë: **“Cila është vepra më e pëlqyer tek All-llahu (xh.sh.)?”** Ai tha: **“Përhapja e gëzimit të besimtarit.”** Atij i thanë: **“Çështje përhapja e gëzimit?”** Ai tha: **“Ngopja e tij kur është i uritur, lehtësimi i problemit (vështirësisë) të tij, dhe shflyerja e borxhit të tij.”** (“Biharul Anvar”; vëll, 74, kreu 20, hadithi /2)

Imam Aliu (a.s.) i ka thënë shokut të tij Komejl ibn Zijadit: **“O Komejl! Urdhëroje familjen tënde në fitimin e moraleve të mira dhe të kryejnë nevojat e atij që është në gjumë. Beto hem në Atë i Cili dëgjon zërat, ai njeri që gëzon një zemër, All-llahu do t'ia krijojë si mirësi për të atë gëzim. Nëse i vjen ndonjë fatkeqësi, si pasojë e asaj veprë, ajo do t'i largohet njësoj siç ecën uji që largon pengesat, ose siç e përze deveja të panjohurën.** (“Biharul Anvar”; vëll, 74, kreu 20, hadithi /82)

Imam Bakir (a.s.) ka thënë: **“Buzëqeshja e një personi në sy të vëllait të tij është mirësi dhe largimi i të keqes nga ai është mirësi. Nuk ka adhurim më të pëlqyeshëm për All-llahun se sa gëzimi i zemrës së besimtarit.”** (“Biharul Anvar”; vëll, 74, kreu 20, hadithi /15)

Profeti Muhammed (s.a.s.) ka thënë: **“Ai që e gëzon besimtarin, më ka gëzuar mua dhe kush më gëzon mua, vërtet ka gëzuar All-llahun (xh.sh.)”** (“Biharul Anvar”; vëll, 74, kreu 20, hadithi /14)

Imam Sadiku (a.s.) ka thënë: All-llahu (xh.sh.) e frymëzoi Daudin (a.s.) duke i thënë: **“Vërtet nëse një prej robve të Mi do të bëjë një të mirë, Unë e kam bërë të lejuar Xhennetin për të.”** Daudi (a.s.) tha: **“O Zot, cila është ajo e mirë?”** All-llahu tha: **“Ta gëzojë robin Tim besimtar duke i dhënë edhe një kokërr hurme (temër).”** Daudi tha: **“Vërtet, ai që të njeh Ty nuk duhet t'i shkëpusë shpresat prej Teje.”** (“Biharul Anvar”; vëll, 14, kreu 3, hadithi /5)

Profeti Muhammed (s.a.s.) ka thënë: **“Ai që mirëson vëllanë mysliman me fjalë të mira dhe i lehtëson atij vështirësitë, vazhdon të qëndrojë nën hijen e mëshirës së All-llahut.”** (“Biharul Anvar”; vëll, 74, kreu 20, hadithi /34)

Nga këto hadithe dalim me një përfundim ndriçues; futja e gëzimit, e harmonisë dhe e lumturisë në zemrën e myslimanit është pjesë e pandarë e moralit dhe e Sheriatit islam tolerues. Mënyrat për të gëzuar zemrat e myslimanëve janë të shumta. Takohesh me një të uritur dhe i jep të hajë; takon një të zemëruar dhe ia lehtëson problemin e i heq zemërimin; takon një borxhli dhe ia shlyen borxhin, etj. Jo vetëm kaq: edhe një buzëqeshje dashurie e respekti shtie gëzim në zemër. Ky moral fisnik shndërrohet në veten e njeriut në gjendje sigurie dhe ndjenjë për paqe. Kjo është dhuratë nga All-llahu, Krijuesi, i Cili ia dhuroi robit të Tij që fut gëzimin në zemrat e njerëzve të mirë. Kur i gëzojmë zemrat e besimtarëve, kemi gëzuar Profetin Muhammed (s.a.s.), dhe familjen e tij dhe kemi fituar kënaqësinë e All-llahut (xh.sh.).

Pajtimi mes besimtarëve

Përpyekja për pajtim dhe rikthimi i marrëdhënieve vëllazërore mes besimtarëve është prej detyrave shoqërore në Islam. Sheriati islam qorton për ndërprerjen e marrëdhënieve vëllazërore mes besimtarëve. Hadithet e transmetuara nga Profeti ynë Muhamedi

(s.a.s.) e familja e tij flasin për rolin e shejtanit në ndërprerjen e marrëdhënieve vëllazërore mes besimtarëve. Pra, s'ka dyshim se ndërprerje e vijueshme dhe këmbëngulja për mospajtim ka ndikime të këqija në jetën e myslimanit.

Profeti Muhammed (s.a.s.) ka thënë: **“Nëse dy myslimanë ndërpresin marrëdhëniet me njëri-tjetrin deri në tri ditë e nuk pajtohen, ata të dy kanë dalë nga Islami. Për ata të dy nuk do të ketë vilajet mes tyre. Ai që i flet më parë vëllait të tij ai do të jetë i pari që do të hyjë në Xhennet Ditën e Gjykimit.”** (“Biharul Anvar”; vëll, 75, kreu 60, hadithi / 5)

Imam Sadiku (a.s.) ka thënë: **“Të mos ndahen dy njerëz duke ndërprerë marrëdhëniet, sepse njëri prej tyre do të meritojë mallkimin, por ndoshta mallkimin e meritojnë që të dy.”** (“Biharul Anvar”; vëll, 75, kreu 60, hadithi / 1)

Morali islam e konsideron mungesën e vëllazërisë mes myslimanëve vepër prej veprave të shejtanit. Kur’ani Famëllartë thotë: **“Shejtani nuk dëshiron tjetër, përveçse nëpërmjet verës dhe bixhozit të hedhë armiqësi ndërmjet jush, t’ju pengojë që të përmendni Zotin dhe t’ju largojë nga namazi. Pra, a po u jepni fund (alkoolit e bixhozit)?”** (Surja “Maide”: 91).

Këtë rol e ndikim të ndyrë të shejtanit, e dëshmojnë edhe thëniet e Ehli Bejtit (a.s.).

Imam Bakiri (a.s.) ka thënë: **“Vërtet, djalli tenton të hedhë mashtrim mes besimtarëve derisa ta nxjerrë njërin prej tyre nga feja e tij. Nëse e bëjnë këtë, djalli qetësohet. Pastaj ai (djalli) thotë: “Fitova.” Allahu e mëshiroftë atë njeri i cili bën pajtim në mes dy të dashurve tanë. O mysliman; pajtohuni dhe duhuni me njëri-tjetrin.”** (“Biharul Anvar”, vëll 75, kreu,60, hadithi/ 6).

Transmetohet nga imam Sadiku (a.s.): **“Djalli vazhdon të qëndrojë i gëzuar kur dy myslimanë janë grindur me njëri-tjetrin. Kur ata pajtohen dhe takohen me njëri-tjetrin, atij i thyhen gjunjët dhe i ndahen kyçet e pastaj thërret: “O ç’mjerim!”** (“Biharul Anvar”, vëll. 75, kreu 6, hadithi/ 7.”

Vërtet, marrëdhëniet mes besimtarëve ngrihen mbi bazën e dashurisë e të respektit dhe çdo veprim që i prish këto marrëdhënie është veprim i djallëzuar. Kur’ani nxit për pajtim dhe rikthim të marrëdhënieve të ndërprera, ku thotë: **“S’ka dyshim se besimtarët janë vëllezër; pra, bëni pajtim ndërmjet vëllezërve tuaj dhe kijeni frikë All-llahun, që të jeni të mëshiruar (nga Zoti).”** (Surja “Huxhurat”:10).

Dhe: **“Të pyesin ty (o Muhammed) për plaçkën (e fituar në luftë), thuaju: “Plaçka, (mënyra e ndarjes së saj) është çështje që i takon All-llahut dhe të Dërguarit, prandaj kijeni frikë All-llahun, përmirësoni gjendjen e unitetit tuaj dhe nëse jeni besimtarë, respektojeni All-llahun dhe të Dërguarin e Tij.”** (Surja “Enfalë”:1).

All-llahu (xh.sh.) na ka premtuar shpërblim të madh prandaj le të bëjmë pajtim mes njerëzve.

All-llahu (xh.sh.) thotë: **“Në shumë biseda të tyre të fshehta nuk ka kurrfarë dobie, përveç (bisedës) kur këshillohet për lëmoshë, për ndonjë të mirë ose pajtim mes njerëzve. E, kush i bën këto duke pasur për qëllim vetëm kënaqësinë e All-llahut, Ne do t’i japim më vonë (në botën tjetër) shpërblim të madh.”** (Surja “Nisa”:114).

Profeti Muhammed (s.a.s.) ka thënë: **“A të të tregoj për sadekanë që e pëlqen All-llahu (xh.sh.) dhe i Dërguari i Tij? Të bësh pajtim mes njerëzve nëse përçahen dhe largohen nga njëri-tjetri.”** (“Kenzul Ummal), vëll. 3 f. 59, hadithi / 5488)

Imam Sadiku (a.s.) ka thënë: **“Sadekaja që e pëlqen All-llahu (xh.sh.) është pajtimi mes njerëzve, kur ata përçahen dhe largohen mes tyre.”** (“Biharul Anvar”, vëll. 76, kreu 101, hadithi / 6)

Në testamentin e imam Aliut për dy djemtë e tij, Hasanin dhe Husejin (a.s) thuhet: ***“Ju porosis ju dhe të gjithë fëmijët e mi, familjen time dhe të gjitha ata që do t’u mbërrijë shkresa ime, që të jenë të devotshëm ndaj All-llahut, të sistemoni punët tuaja dhe të bëni pajtim mes njerëzve, sepse pajtimi mes njerëzve është më i përsosuri (i mirë) se falja e namazit dhe agjërimi.”*** (“Biharul Anvar”, vëll.42, kreu, 127, hadithi / 51)

Pra, pajtimi mes njerëzve ka një pozitë të lartë në islam, e cila arrin deri në shkallën e sadekasë, të cilën e pëlqen All-llahu (xh.sh.). Jo vetëm kaq. I Dërguari i All-llahut ka thënë: ***“Pajtimi mes njerëzve është më e mirë se falja dhe agjërimi.”*** (“Biharul Anvar”, vëll.72, f. 24)

Në jetën e Ehli Bejtit (All-llahu qoftë i kënaqur me ta!), lexojmë se ata interesoheshin për pajtimin mes njerëzve. Po përmendim si vijon:

1- Imam Sadiku (a.s.) caktoi një pjesë të pasurisë së tij për t’u shpenzuar në misionin e pajtimit dhe zgjidhjen e konflikteve mes myslimanëve. Mufadali, i cili ka qenë prej shokëve të imam Sadikut (a.s.), transmeton: Ebu Abdilahi Sadik ka thënë: ***“Nëse shikon konflikt mes dy njerëzve prej ihtarëve tanë, ti zgjidhe me paratë e mia.”*** (“Biharul Anvar”, vëll, 76, kreu 101, hadithi / 8)

2- Të gjithë e dimë se gënjeshtria është prej cilësive më të këqija dhe prej mëkateve të mëdhaja. Kur’ani flet ashpër për gënjeshtarët. Por, kur ajo është mënyrë për pajtim dhe ndreqjen e marrëdhënieve të shkëputura, atëherë ajo hyn në rrethin tjetër. Për këtë imam Sadiku (a.s.) ka thënë: ***“Vërtet pajtuesi nuk është gënjeshtar.”*** (“Biharul Anvar”, vëll,73, f. 48). Pra, pajtimi mes besimtarëve ka një rëndësi të madhe në etikën morale.

Përmbledhje

Futja e gëzimit në zemrat e njerëzve është prej moraleve shoqërore në Islam. Ky moral fisnik ka ndikime e fryte në këtë jetë dhe në Ahiret. Pajtimi mes besimtarëve dhe rikthimi i marrëdhënieve vëllazërore është një tjetër detyrë shoqërore në Sheriatin islam. Profeti Muhammed (s.a.s.) dhe imamët e ndershëm nxisin për këtë veprim në thëniet e tyre. Ky veprim ka një ndikim të madh në jetën e individit dhe të shoqërisë.

Pyetje

- 1- Cila është vepra më e pëlqyer tek All-llahu (xh.sh.)? Përmendni tekstin e hadithit të Profetit (s.a.s.)
- 2- A kufizohet futja e gëzimit në zemrën e besimtarëve me ndikime materiale?
- 3- Përse djalli zemërohet kur besimtarët pajtohen?
- 4- Përse imam Sadiku (a.s.) pati caktuar një pjesë të pasurisë së tij në misionin e pajtimit?

Mësimi 16

NDERIMI I JETIMËVE DHE I TË VARFËRVE

Islami është burim i mëshirës, i zemërbutësisë dhe i dashurisë njerëzore. Nuk duhet të habitemi kur shohim që feja jonë e drejtë e cila interesohet për fëmijët jetimë, ka dhembshuri për ata dhe mundohet të sigurojë ngrohtësi për zemrat e tyre. Kur'ani i nxit myslimanët që ta përmbushin këtë përgjegjësi njerëzore islame.

All-llahu (xh.sh.) i përmend të Dërguarit të Tij mirësinë e dashurinë që i siguroi atij pas vdekjes së babait të tij duke i thënë: **“A nuk të gjeti ty jetim dhe të bëri vend (të dha përkerahje).”** (Surja “Duba”/ 6). Pastaj All-llahu (xh.sh.) e porosit, duke thënë: **“Pra, mo e përul jetimin!”** (Surja “Duba”/ 9)

Edhe Profeti ynë e ka përjetuar idhësinë e jetimësisë kur nuk njohu babanë, sepse babai pati vdekur kur ai ishte ende në barkun e nënës së tij (Eminesë), e kur pas pak vjetësh do t'i vdiste edhe nëna e tij e dashur. Por All-llahu (xh.sh.) i përgatiti atij njeriun që do të kujdesej për të e ai ishte gjyshi i vet, Abdul Mutalibi dhe pas tij, Ebu Talibi, xhaxhai i vet.

Për këtë Profeti (s.a.s.) thotë: **“Shtëpia më e dashur tek All-llahu (xh.sh.) është ajo ku rri jetimi.”** (“El-Xha'ferijat”; f. 167)

Dhe: **“Bëhu për jetimin si babai zemërbutë. Dhe dije mirë se çfarë do të mbjellësh atë do të korrësh.”** (“Biharul Anvar”; vëll.77, kreu 18, hadithi/ 23)

Dhe: **“Në Xhennet ndodhet një vend i cili quhet, vendi i gëzimit. Në atë vend nuk hyn kush tjetër përveç atyre që gëzuan jetimët e besimtarëve.”** (“Kenzul Ummal”, vëll. 3, f. 170, hadithi/ 60008).

Dhe: **“Kush kujdeset për tre jetimë, do të jetë i njëjtë me atë që falet natën, agjëron ditën dhe sakrifikon në rrugën e All-llahut (xh.sh). Ai do të jetë vëllai im në Xhennet, siç janë edhe këto të dy.”** (“Sunen ibn Maxbah”, vëll. 2, f. 12-13, hadithi/ 3680).

Meqenëse, Sheriati islam e quan përkujdesjen dhe nderimin për jetimët çështje të rëndësishme, ai ka caktuar që një pjesë e zeqatit të shpenzohet për ata. Po ashtu, shpenzimi për ta është prej veprave që e afron njeriun tek All-llahu (xh.sh).

All-llahu (xh.sh) thotë: **“... dhe pasurinë që e do, ua jep të afërmve, jetimëve...”**

(Surja “Bekare”:177). Historia e sadekasë së Ehli Bejtit (All-llahu qoftë i kënaqur me ta) me ushqim tri ditë me radhë është e njohur derisa për ta zbritën këto ajete: **“Ata janë që për hir të Tij, u japin ushqim të varfërve, jetimëve dhe robërve.” “Ne po ju ushqejmë vetëm për hir të All-llahut dhe prej jush nuk kërkojmë ndonjë shpërblim e as falënderim.”** (Surja “Insan”: 8-9).

Prej detyrave shoqërore në islam është interesimi për jetimët, shpenzimi për ata. Dhe sigurimi i një jete të kënaqshme për ata. Kjo kufizohet vetëm në anën ekonomike, sepse jetimi nuk ka nevojë vetëm për para; jetimi ka nevojë edhe për ndienjën e ngrohtësi, dhe dashurisë që ai humbi.

Kur'ani Famëllartë e ndalon poshtërimin e jetimëve ku thotë: **“Pra, mo e poshtëro jetimin!”** (Surja “Duba”: 9).

Po ashtu Kur'ani sqaron ndikimin e ashpër për atë shoqëri e cila poshtëron jetimët dhe nuk i siguron atij ngrohtësi e dashuri. All-llahu (xh. sh) thotë në Kur'an: **“Jo nuk është ashtu! Por (bëni edhe më keq) ju nuk e përfillni jetimin.” “Nuk nxisni njëri-tjetrin për t'i dhënë të varfrit.”** (Surja “Fexhr”:17-18).

Në ajetin e parë vëmë re se nderimi i jetimit i kalon më tej kufijtë e nevojës ekonomike, sepse ka jetim i cili nuk ka nevojë për ndihma ekonomike, por ai kërkon për një njeri i cili e mbush me ndjenjat e dashurisë e të ngrohtësisë. "Ikram" do të thotë nderim e respektim i personalitetit të jetimit dhe bashkëpunim me të me mënyra pozitive. Përsa i përket nxitjes për t'u dhënë ushqim të varfërve, kjo përmendet pas nderimit të jetimëve,

sepse kafshata e gojës për të vobektët mund të sigurohet nga inividë a institucione të bampirësisë, etj, kurse ngrohtësia e dashuria do njerëz me zemër.

Të përzësh jetimin dhe të mos i japësh të vobektit do të thotë të përgënjeshtrosh mesazhet e All-llahut, i Cili thotë: ***“A e ke parë ti (a e njeh ti) atë, që përgenjeshtron përgjegjësinë dhe llogarinë në Botën Tjetër? Është ai që e përzë në mënyrë të vrazhdë jetimin dhe që nuk nxit për të ushqyer të varfrin.”*** (Surja “Maun”:1-3).

Për anën e dashamirësisë flet edhe tradita profetike.

Profeti ynë Muhammedi (s.a.s.) ka thënë: ***“Cilido që vë dorën e tij mbi kokën e jetimit si shenjë dhembshurie, do të ketë shpërblim sa numri i fijeve të flokut që prek dora.”*** (“Kenzul Ummal”, vëll. 3, f.177).

Një nga shokët e Profetit (s.a.s.) transmeton: “Një ditë, ne ishim me Profetin (s.a.s.). Erdhi një djalë. Ai i tha Profetit (s.a.s.): “Unë jam jetim dhe kam një motër. Nëna jonë ka mbetur e ve, prandaj na ushqe me ato që të ka ushqyer All-llahu dhe na jep prej asaj që të ka dhënë All-llahu dhe të jesh i kënaqur.” Profeti (s.a.s.) tha: “Sa bukur që fole o djalë!” Pastaj, i tha Bilalit: “Shko dhe merr çfarë të ketë nga ushqimet tona!”. Bilali shkoi dhe mori me vete njëzet e një kokrra hurma. Profeti (s.a.s.) ia dha djalit hurmat dhe i tha: ***“Shtatë kokrra janë për ty, shtatë për motrën tënde dhe shtatë për nënën tënde.”*** Në ato çaste, Meadh ibn Xhebel u ngrit dhe vuri dorën në kokën e djalit me përkëdheli dhe i tha: ***“All-llahu ta lehtësoftë jetimërinë tënde dhe të bëftë trashëgues të mirë të babait tënd!”*** Profeti (s.a.s.) i tha: “Ku e pate qëllimin me atë që bëre?” Meadhi tha: ***“E bëra për dashuri ndaj tij.”*** Profeti (s.a.s.) tha: ***“Cilido që merr nën kujdes një jetim dhe kujdeset për atë duke vënë dorën e tij mbi kokën e jetimit dhe e përkëdhel, për çdo fije floku të cilën e prek dora, All-llahu (xh.sh) do t’i japë të mira dhe për çdo fije floku do t’ia fshijë atij të këqijat dhe për çdo fije floku do ta lartësojë.”***

Transmetohet se Profeti (s.a.s.) ka thënë: ***“Kur qan jetimi, tronditet Arshi dhe Zoti (xh.sh.) thotë: “Kush e bëri të qajë robin Tim të cilit Unë ia mora prindërit? Ai që do t’ia ndalojë atij të qarin, Unë do ta fus në Xhennet.”***

Një njeri u ankua te Profeti (s.a.s.) për zemërfortësinë e tij. Profeti (s.a.s.) i tha: ***“A dëshiron që të zbutet zemra jote dhe të përmbushen nevojat e tua? Mëshiro jetimin dhe përkëdheli kokën dhe jepi nga ushqimi yt, sepse kështu do të të zbutet zemra dhe do të plotësohen nevojat e tua.”***

Tani të shohim se si ky moral i lartë ndaj jetimëve ka qenë i mishëruar tek imam Aliu (a.s) në jetën e tij. Historia thotë: "Kur imam Aliu (a.s) ishte prijës i myslimanëve pa një grua që po mbante në supe një kacek me ujë. Ai ia mori kacekun dhe ia dërgoi aty ku banonte dhe e pyeti për gjendjen e saj. Ajo i tha: “Ali ibn Ebi Talibi e dërgoi tim shoq në disa beteja. Ai u vra dhe më ka lënë të ve dhe fëmijët jetimë. Unë nuk kam asgjë dhe nevoja më ka shtyrë që t’u shërbej njerëzve. Imam Aliu (a.s) u pezmatua dhe u largua. Atë natë ai ndenji i mërziur. Kur zbardhi dita, mori një trastë me ushqime. Disa që e pane, i thanë: “Na e jep se e mbajmë ne.” Imami u tha: “Kush e mban barrën time në Ditën e Gjykimit?” Ai shkoi te shtëpia e asaj gruas dhe trokiti në derë. Ajo pyeti: “Kush troket?” Imami i tha: “Unë jam ai robi i cili mbajti kacekun tënd, prandaj hape derën se kam sjellë diçka për fëmijët” Ajo i tha: “All-llahu qoftë i kënaqur me ty dhe Ai të gjykojë mes meje dhe Ali ibn Ebi Talibit.” Imam Aliu hyri dhe i tha: “Unë dua të fitoj shpërblim, prandaj ti zgjidh: ose të gatuash brumin ose të rrish me fëmijët dhe unë të gatuaj bukën.” Ajo i tha: “Unë e di si gatuhet buka, prandaj ti rri me fëmijët e luaj me ta derisa të mbaroj gatimin.” Gruaja filloi gatimin, ndërsa imam Aliu filloi të ushqejë fëmijët me mish e me hurma. Kur brumi u bë gati për ta pjekur gruaja i tha: “O robi i

Zotit ndize furrën.” Imami e ndezi. Kur e ndezi, flaka i ra në fytyrë. Imami tha: “Provo o Ali, ky është ndëshkimi i atij, i cili nuk interesohet për të vejat dhe jetimët.” Një grua që po kalonte aty pranë dhe që e njihte imamin tha: “E mjera ti, ky është prijësi i besimtarëve.” Kur dëgjoji këto fjalë, e zonja e shtëpisë tha: “Unë u turpërova o prinjës i besimtarëve.” Imami ia ktheu: “Unë jam i turpëruar nga ti o robinjë e Zotit, sepse nuk jam interesuar për gjendjen tënde.” Pasi fëmijët u ngopën, imami u largua me sy të përlotur. (*“Biharul Anvar”, vëll 41, kreu 104, f. 52*).

Të varfrit dhe të mjerët kanë të drejta tek të pasurit. Shoqëria islame e cila mbështetet në marrëdhëniet vëllazërore mes individëve, përkujdeset për të varfërin dhe nevojtarin dhe i përkrah ata. Një prej pjesëve të zekatit shpenzohet për t’u ardhur në ndihmë të varfërve e nevojtarëve.

All-llahu (xh.sh) thotë në Kur’an: **“Dhe në pasurinë e tyre kishin përcaktuar të drejtë për lypësin dhe për nevojtarin (që ka nevojë dhe nuk lyp).”** (Surja “Dharijatë”:19). **“Dhe për ata që në pasurinë e vet kanë ndarë një pjesë të caktuar për lypësin dhe për nevojtarin që nuk lyp.”** (Surja “Mearixh”: 24-25). Nëpërmjet këtyre ajeteve na bëhet më se e qartë ndihma për të vobektit dhe ndihma dhe përkrahja që kryejmë për ta, nuk është lëmshë, por detyrë islame, sepse All-llahu (xh.sh.) ka vendosur të drejtë për të varfërit në pasuritë e të pasurve dhe të pasurit këtë detyrë duhet ta kryejnë dhe jo ta quajnë si mirënjohje ndaj tyre. Cilido që jep prej pasurisë së tij dhe këtë dhënie e quan mirënjohje, ajo vepër e tij është e pavlefshme, sepse All-llahu (xh.sh) thotë në Kur’an: **“O ju që besuat, mos i prishni lëmshat tuaja me të krenuar e me fyerje ...”** (Surja “Bekare”: 264).

Përmbledhje

Nderimi i jetimit dhe përmbushja e nevojës së të varfërve konsiderohet prej shkaqeve të gëzimit të zemrave. Kjo vepër është prej etikës shoqërore në Islam. Vërtet, nderimi i jetimit dhe sigurimi i nevojave të tij materiale e shpirtërore është detyrë shoqërore dhe myslimanët duhet ta përmbushin atë. S’ka dyshim detyra ndaj jetimëve dhe të vobektëve është pjesë e të drejtave të tyre dhe nuk duhet të quhet mirënjohje e as të jetë vepër për t’i bërë ata të ndiehen si nevojtarë.

Pyetje

- 1- Përmendni një porosi të Profetit tonë Muhammedit (s.a.s.) për jetimët.
- 2- Përmendni shkurtimisht shpërblimin që e pret atë njeri që nderon jetimët dhe përkujdesjet për ata?
- 3- Si mund t’i sigurojmë nevojat e jetimëve?
- 4- Çfarë i ka premtuar All-llahu atij që gëzon zemrën e jetimit?
- 5- Bëni dallimin mes nevojave të jetimit dhe të të vobektit.
- 6- Përse sadakaja prishet me mirënjohjen?

VIZITATEK I SËMURI

Vizita tek i sëmuri është prej vërtetësisë së “Gëzimit të zemrave” të besimtarëve. Kjo vepër është prej moralit islam. Vërtet, vizita e të sëmurëve qofshin ata, shokë, miq, të afërm e të njohur forcon marrëdhëniet mes individëve.

Çështje vizita? Cilat janë rregullat e saj? Si e shikon Islami këtë vepër?

1- Vizita

Feja islame e quan vizitën detyrë shoqërore të myslimanit ndaj vëllait të tij besimtar. Myslimani i sëmurë ka të drejta ndaj vëllait të tij besimtar.

Profeti ynë, Muhammedi (s.a.s.) ka thënë: **“Prej të drejtave të myslimanit ndaj myslimanit janë: kur ta takojë, ta përshëndesë; kur të sëmuret, ta vizitojë; kur të vdesë, të shoqërojë xhenazën e tij.”** (“Mekarimul Ablak”, f.259)

Imam Aliu (a.s.) transmeton nga Profeti Muhammed (s.a.s.) i cili ka thënë: **“Vëllai musliman ka tridhjetë të drejta kundrejt vëllait të tij mysliman, nuk mund t'i shmanget asnjërës prej tyre vetëm nëse i kryen ato ose jo ... ta vizitojë kur është i sëmurë.”** (“Biharul Anvar”, vëll. 74, kreu 15, hadithi/ 36).

Mual-la ibn Khunejsi e pyeti imam Sadikun (a.s.): **“Cila është e drejta e myslimanit ndaj myslimanit?”** Ai tha: **“Ato janë shtatë të drejta dhe nëse nuk e zbaton njërën prej tyre ka dalë prej kujdestarisë së All-llahut (xh.sh) dhe bindjes ndaj Tij dhe nuk do të marrë asgjë prej All-llahut.”** Unë i thashë: **“U bëfsha fli për ty! Cilat janë ato?”** Ai tha: **“O Mual-la, unë të frikësohem ty sepse do të harrosh (humbasësh) e nuk do ta kujtosh, do ta mësosh e nuk do ta bësh.”** Unë i thashë: **“La kuuete il-la bil-lahi”** Ai tha: **“Të drejtat më të lehta janë t'i duash atij atë që ia do vetes tënde dhe t'i përbuzësh atij atë që ia përbuz vetes sate ... dhe e drejta e shtatë është që të ta shpërblesh për mirësitë që të bën, ta pranosh ftesën e tij, të vizitosh të sëmurin, ta shoqërosh xhenazën e tij, dhe nëse e di se është nevojtar nxito t'ia përmbushësh e nevojat.”** (“Biharul Anvar”, vëll. 74, kreu 15, hadithi/ 40)

Muavie ibn Uhab e pyeti imam Sadikun (a.s.): **“Si duhet të veprojmë mes nesh, mes popullit tonë dhe mes njerëzve me të cilët jetojmë?”** Ai tha: **“Të çoni në vend amanetet e tyre, të zbatoni dëshminë për ata ose kundër atyre, të vizitoni të sëmurët e tyre dhe të shoqëroni xhenazet e tyre.”** (“El-Kafij”, vëll 2, f. 635)

Pa dyshim, vizita e të sëmurit është një vepër morale, e cila e lumturon dhe e kënaq zemrën e të sëmurit. Kjo vepër ndikon edhe në lehtësimin e sëmundjes dhe në shërimin e njeriut.

2- Nxitja për vizitën

Islami e konsideron vizitën detyrë shoqërore dhe myslimani duhet ta zbatojë atë. Për këtë vepër All-llahu (xh.sh.) ka caktuar shpërblim të madh.

Profeti ynë, Muhammedi (s.a.s.) ka thënë: **“Kur myslimani e viziton vëllanë e tij mysliman, All-llahu (xh.sh.) thotë: “Ti je i lumtur dhe vepra jote është lumturuese. Me këtë vepër ti do të kesh një vend në Xhennet.”**

Dhe: **“Besimtarin që viziton vëllanë e tij besimtarë kur është i sëmurë, do ta shoqërojnë 70 mijë meleke kur zgjohet. Kur ulet, është i mbuluar me mëshirë dhe**

melekët kërkojnë falje për të derisa të ngryset. Kur të vijë darka, do ta shoqërojnë përsëri 70 mijë melekë derisa të agojë.” (“El- Kafj”, vëll2, f.120, hadithi/ 6)

Imam Bakiri (a.s) ka thënë: **“Prej lutjeve që bënte Musai biri i Imranit, Zotit të Tij ishte: “O Zot! Çfarë shpërblimi ka vizitimi i të sëmurit?”** Zoti i tha: **“Unë i caktoj një melek atij i cili e viziton atë në varrin e tij derisa të vijë Dita e Tubimit.”**

(“Biharul Anvar”, vëll 81, kreu 4, hadithi/ 11)

Imam Sadiku (a.s) ka thënë: **“Ai që viziton një të sëmure për hir të All-llahut dhe i sëmuri lutet për vizitorin, All-llahu do t’ia pranojë lutjen.”** (“Biharul Anvar”, vëll 81, kreu 4, hadithi/ 10)

3- Rregullat e vizitës

Për vizitën ka rregulla dhe parime të cilat duhet t’i njohim.

a) Kur të shkojmë për të vizituar një të sëmure, të marrim për atë një dhuratë që ta gëzojë zemrën e tij, ose t’i japim diçka për të cilën ai ka nevojë.

Profeti Muhammed (s.a.s.) ka thënë: **“Cilindo që i ushqen të sëmurit dëshirën tij, All-llahu do ta ushqejë me frutat e Xhennetit.”** (“Biharul Anvar”, vëll 81, kreu 4, hadithi/ 32)

Në librat e haditheve thuhet se një të sëmuri po i shkonin për vizitë disa vëllezër besimtarë. Në rrugë ata u takuan me imam Sadikun (a.s.) i cili i pyeti se ku po shkonin. Ata i thanë: **“Do të shkojmë për vizitë te filani.”** Imami u tha: **“Ndaloni!”** dhe ata ndaluan. Pastaj u tha: **“A ka marrë ndonjë prej jush ndonjë mollë, ftua, shishe me erzinë, ndonjë copë prej udit erëmirë?”** Ata i thanë: **“Për çfarë duhen këto?”** Ai u tha: **“A nuk e dini se i sëmuri lehtësohet me ato që i dërgohen atij?”** (“Biharul Anvar”, vëll 81, kreu 4, hadithi 39)

b) Vizitori të mos rrijë gjatë tek i sëmuri e të mos e mërzisë atë. Profeti Muhammed (s.a.s.) ka thënë: **“Vizita duhet të jetë sa koha që çlodhet deveja.”** (“El- Kafj”; vëll. 3f. 118)

Imam Aliu (a.s) ka thënë: **“Vizita më e shpërblyer është kur shkon për tek i sëmuri dhe nuk rri gjatë, përveç kur i sëmuri do që të rrish.”** (“Biharul Anvar”, vëll 81, kreu 4, hadithi/ 1)

c) I sëmuri të pyetet për sëmundjen dhe të lutemi për shërimin e tij dhe të takohet me përmallje e me dashuri.

Profeti Muhammed (s.a.s.) ka thënë: **“Vizita e plotë e të sëmurit është kur e takon dhe pyet si është, si ka gdhirë dhe si ka ngrysur.”** (“Biharul Anvar”, vëll 81, kreu 4, hadithi/ 32)

Dhe: **“Vizitoni të sëmuret...dhe bëni lutje për ta duke thënë: “O Zot, shëroje atë me shërimin Tënd dhe lehtësoje prej sprovave Tuaja.”** (“Biharul Anvar”, vëll 81, kreu 4, hadithi/ 32)

ç) Të sëmurit t’i shprehim ndienjën e shpresës për shërim, t’i flasim me fytyrë të qeshur dhe të mbjellim në shpirtin e tij forcën.

Profeti Muhammed (s.a.s.) ka thënë: **“Kur të hyni tek i sëmuri jepini kurajo atij, sepse kjo ndikon në shërimin e tij”** (“Biharul Anvar”, vëll 81, kreu 4, hadithi/ 33)

Edhe nëse gjendja e të sëmurit është e vështirë dhe ai është i mërziur, duhet që ta vizitojmë dhe t’i flasim për shërim sepse kjo e lehtëson dhe e qetëson të sëmurin.

d) Të mos hamë tek i sëmuri dhe të mos presim që familja e tij të na ushqejnë. Nuk është e përshtatshme që myslimani të hajë ushqim në prani të sëmurit. Qëllimi i vizitës të jetë gëzimi i zemrës së të sëmurit, t'i japë shpresë shërimit atij dhe të bisedojë me të për t'i lehtësuar sëmundjen.

Imam Aliu (a.s) ka thënë: **“Profeti Muhammed (s.a.s.) e ka ndaluar që vizitori të hajë tek i sëmuri, sepse All-llahu nuk do t’ia shpërblejë atij vizitën.”** (“Biharul Anvar”, vëll 81, kreu 4, hadithi/ 41)

Përbledhje

Vizita e të sëmurit është prej etikës shoqërore në Islam. Ajo është shkak i gëzimit të zemrës së besimtarëve. Ka shpërblim të madh kur viziton një të sëmure.

Për vizitën ka rregulla të cilat duhet t’i respektojmë. Dërgimi i dhuratave tek i sëmuri, mosqëndrimi gjatë tek ai, pyetja për gjëndjen e të sëmurit dhe lutja për shërimin e tij janë disa nga këto rregulla.

Pyetje

- 1-Përse vizita tek i sëmuri quhet si vërtetësi e gëzimit të zemrave?
- 2-Çfarë përfundimi nxjerrim kur themi se vizita tek i sëmuri është prej të drejtave të besimtarëve?
- 3-Thoni shkurtimisht rregullat e vizitës.

PJESËMARRJA NË GËZIME E NË HIDHËRIME

Përderisa besimtarët janë vëllezër, dhe bashkëpunojnë me njëri-tjetrin, ata marrin pjesë në gëzime e në hidhërime. Kur një njeri gjen pranë tij një person i cili merr pjesë në hidhërimet e tij, ai ndien ngrohtësi dhe i lehtësohet hidhërimi a fatkeqësia. Për këtë arsye, pjesëmarrja në gëzimet dhe hidhërimet e të tjerëve është prej faktorëve të marrëdhënieve vëllazërore. Njeriu, në natyrën e tij, e pëlqen pjesëmarrjen e njerëzve në gëzimet dhe hidhërimet e tij. Prandaj, është detyra jonë që të marrim pjesë në gëzimet dhe në hidhërimet e të tjerëve. Po përmendim rastet e pjesëmarrjeve vëllazërore.

1- Pranimi i ftesës

Prej detyrave të myslimanit kundrejt vëllait të tij në fe është që t'i përgjigjet ftesës së tij, kur e fton.

Imam Sadiku (a.s) ka thënë: **“Prej të drejtave të myslimanit ndaj myslimanit është që t'i përgjigjet ftesës së tij.”** (“Biharul Anvar”, vëll. 75, kreu 99, hadithi/5)

Nuk është mirë që besimtari të mos i përgjigjet ftesës së vëllait të tij besimtar. Nëse i përgjigjet ftesës së tij, duhet të hajë prej ushqimit të përgatitur.

Imam Sadiku (a.s) ka thënë: **“Tri vepra janë të pahijshme; të ftohet një person që ftohet për gosti dhe nuk i përgjigjet, apo i përgjigjet ftesës dhe nuk ha ushqim.”** (“Biharul Anvar”, vëll. 75, kreu 89, hadithi/6)

S'ka dyshim se ftesa për gosti dhe mikëpritje është e përhapur më shumë në shoqërinë islame. Është e natyrshme se ftuesi përgatitet për pritjen e miqve. E nëse të ftuarit nuk i përgjigjen ftesës së tij ai do të hidhërohet. E nëse i përgjigjen, s'ka dyshim se ai do të gëzohet sepse shikon të ftuarit pranë tij dhe e kupton se sa shumë e respektojnë atë. Me këtë veprim të ftuarit ia mbushin zemrën me gëzim. Pra, përgjigjja e ftesës është detyrë për të ftuarin dhe e drejta e ftuesit. Për këtë, Profeti Muhammed (s.a.s.) ka thënë: **“Porosis të pranishmit dhe ata që do të vijnë nga ymmeti im që t'i përgjigjen ftesës së myslimanit, edhe sikur të jetë 5 milje (9-10 km) sepse kjo është prej fesë.”** (“Biharul Anvar”, vëll 75, kreu 89, hadithi/7)

Në një hadith tjetër Profeti (s.a.s.) ka thënë: **“Ai që nuk i përgjigjet ftesës, nuk i është bindur All-llahut dhe të Dërguarit të Tij.”** **“Është e përbuzur që të pranohet ftesa në gostinë e të pasurve, ku nuk ka të varfër.”** (“Biharul Anvar”, vëll. 75, kreu 89, hadithi 11)

Vërtet, Islami i ka rregulluar marrëdhëniet mes individëve sipas etalonit të vëllazërisë dhe të barazisë. Për këtë arsye, kundërshtimin e ftesës dhe mospërgjigjen për ftesën e ka bërë mëkat ndaj All-llahut dhe të Dërguarit të Tij. Në të shumtën e rasteve, gostitë e të pasurve organizohen për krenari dhe dukje për pasurinë që ata kanë. Kjo është në kundërshtim me etikën islame dhe vlerat morale. Historia na tregon se Othman ibn Hunejfin, i cili ka qenë shok i njohur dhe mëkëmbës në qytetin e Basrës në kohën e imam Aliut (a.s), e ftoi një prej të pasurve të Basrës për gosti dhe mëkëmbësi e pranoi ftesën e tij. Kur lajmi mbërriti tek imam Aliu (a.s.), i dërgoi atij një letër, në të cilën i tha: **“O biri i Hunejfit, më lajmëruan se një burrë prej të pasurve të Basrës të ka ftuar për gosti dhe ti shpejtove të shkoje. Ata shtruan për ty**

gjellëra të ndryshme dhe tu afruan pjata të mëdha. Kurrë nuk e kisha menduar se ti do ta pranoje gostinë e njerëzve të cilët i dëbojnë lypësit dhe ftojnë të pasurit. Mendo për kafshatat që i ha. Lëri ato në të cilat dyshon dhe ha ato për të cilat je i sigurtë se janë fituar në mënyrë ligjitime ...” (“Biharul Anvar”, vëll. 33, kreu 29, hadithi/ 686). Në këtë letër gjejmë po atë kuptim që transmetohet në hadithet e Profetit Muhammed (s.a.s.) rreth përbuzjes së gostitë në të cilat nuk ka të varfër.

2- Pjesmarrja në hidhërimë

Prej detyrave të besimtarëve kundrejt njëri-tjetrit është pjesëmarrja në hidhërimë dhe përkujtime. Vërtet, ka mjaft hadithe të cilat e vërtetojnë pjesëmarrjen në përcjelljet varrimore dhe në ngushëllimin e familjes së të vdekurit e të pjesëtarëve të saj. Edhe larja, qefinosja dhe falja e namazi të xhenazeve janë detyrë (uaxhib kifaji) në jurisprudencën islame. Më poshtë po përmendim një grup hadithesh që flasin për këtë çështje.

Imam Bakiri (a.s.) ka thënë: *“Cilido, që shoqëron xhenazën e myslimanit, do t’i jepet në Ditën e Gjykimit katër shefaata dhe kur kërkon ndonjë gjë meleku do t’i thotë: Do të ta sjell.”* (“Biharul Anvar”, vëll. 80, kreu 7, hadithi/ 2).

Imam Sadiku (a.s.) ka thënë: *“Cilido, që shoqëron xhenazën e një besimatri derisa të varroset, All-llahu do të caktojë për të 70 mijë meleke që do të shoqërojnë atë dhe do të ndërhyjnë për falje për të kur të dalë nga varri (në Ditën e Gjykimit).”* (“Biharul Anvar”, vëll. 8, kreu 7, hadithi/ 1).

Dhe: *“Cilido, që shoqëron xhenazën e një besimtari, i fshihen 25 gjynahe të mëdha.”* (“Biharul Anvar”, vëll. 81, kreu 7, hadithi/ 6).

Imam Sadiku (a.s.) i ka thënë njërit prej shokëve të tij: *“O Kjathemetel! Dërgoji selam dashamirësve tanë dhe porositi ata që t’i frikësohen All-llahut (xh.sh.) ... Dhe të gjallët prej tyre të shoqërojnë xhenazetë e të vdekurve të tyre.”* (“Biharul Anvar”, vëll. 71, kreu 7, hadithi/ 9).

Imam Bakiri (a.s.) ka thënë: *“Cilido besimtar që lan xhenazën e një besimtari dhe kur e kthen thotë; “O Zot, ky është trupi i robit Tënd besimtar dhe Ti ia nxorre shpirtin prej trupit të tij dhe i ndave ata, prandaj kërkoj faljen Tënde, faljen Tënde”, All-llahu (xh.sh.) do t’ia falë gjynahet e një viti përveç gjynaheve të mëdha.”* (“Biharul Anvar”, vëll. 81, kreu 9, hadithi/ 5). Imam Sadiku (a.s.) ka thënë: *“Ai që e lan xhenazën e një besimtari dhe e zbaton amanetin, do të jetë i falur.”* Ata i thanë: *“Si ta zbatojë amanetin?”* Ai tha: *“Të mos flasë për atë që shikon (gjatë larjes).”* (“Biharul Anvar”, vëll. 81, kreu 8, hadithi/ 6).

Imam Hasani (a.s.) transmeton se gjyshi i tij, Profeti Muhammed (s.a.s.) i cili ka thënë: *“Ai besimtar që fal xhenazetë, All-llahu do ta fusë në Xhennet, përveç kur është dyfytyrak a kur nuk respekton prindërit e tij.”* (“Biharul Anvar”, vëll. 78, f. 347).

Imam Sadiku (a.s.) transmeton se Profeti Muhammed (s.a.s.) ka thënë: *“Për atë që fal xhenazën, luten 70 mijë meleke dhe All-llahu do t’ia falë gjynahet. Nëse qëndron deri në varrimin e tij dhe hedh dhe mbi të, për çdo hap që ai e ka mbajtur xhenazën do të ketë një karat me shpërblim dhe karati është njësoj si mali i Uhudit.”* (“Biharul Anvar”, vëll. 76, kreu 6, hadithi/ 1). Këto hadithe na thonë se duhet të marrim pjesë në larjen, qefinosjen, shoqërimin e xhenazesë dhe në faljen e

xhenazesë. Ato na sqarojnë, gjithashtu, shpërblimin për këto vepra. Detyrë tjetër për besimtarët është ngushëllimi dhe përkujtimi. Transmetohet se Profeti (s.a.s.) ka thënë: **“Ai që ngushëllon atë që i bie fatkeqësi, do të ketë shpërblim të njëjtë me të.”** (“Biharul Anvar”, vëll. 82, kreu 16, hadithi/ 49).

Dhe: **“Ai që e ngushëllon vëllanë e tij besimtar për fatkeqësinë që e ka goditur, Allahu do ta mbulojë me rrobën e fisnikërisë në Ditën e Gjykimit.”** (“Biharul Anvar”, vëll. 82, kreu 16, hadithi/ 46).

Transmetohet se imam Aliu (a.s.) ka thënë: **“Ai që i ngushëllon ata që u bie fatkeqësi, në Ditën e Gjykimit do të jetë nën hijen e Zotit e në atë Ditë nuk ka hije tjetër përveç hijes së Tij (xh.sh.).”** (“Biharul Anvar”, vëll 82, kreu 26, hadithi/ 57).

Po kështu, vizita e varrezave e sidomos atyre të prindërve ka shpërblim të madh, sepse ky veprim i gëzon banorët e varrezave. Imam Aliu (a.s.) thotë: **“Vizitoni të vdekurit tuaj, sepse ata gëzohen me vizitën tuaj...”** (“Biharul Anvar”, vëll 10, kreu 7, hadithi/ 1).

Në jetëshkrimin e Ehli Bejtit (a.s.) thuhet se një prej shokëve të imam Sadikut (a.s.) e ka pyetur atë : **“Dikush viziton varrin e prindërve të tij ose të një shoku. A ka dobi për të vdekurin në këtë veprim?”** Ai i tha: **“Po. Kjo vizitë është për të njësoj si një dhuratë që ju vjen ju dhe gëzoheni.”** (“Biharul Anvar, vëll 79, f. 64).

Transmetohet se imam Sadiku (a.s.) ka thënë: **“Vërtet, i vdekuri gëzohet kur kërkohet mëshirë e falje për atë, njësoj siç gëzohet i gjalli me dhuratën që i dhurohet atij.”** (“Biharul Anvar”, vëll 82, kreu 14, hadithi/ 1).

Përbledhje

Është detyrë për besimtarit që t'i përgjigjet ftesës së vëllait të tij besimtar. Prej detyrave të besimtarëve kundrejt njëri-tjetrit është edhe pjesmarrja në gëzime, në hidhërimë dhe ngushëllimi i familjes së të vdekurit.

Pyetje

- 1- Përse mospërgjigja e ftesës së besimtarit quhet vepër e pahijshme?
- 2- Cilat ftesa janë të përbuzura? Argumentojeni me hadithe nga Profeti.
- 3- Cila është detyra jonë për të vdekurit besimtarë?
- 4- Cila është detyra jonë për familjen e të vdekurit?
- 5- A mund të gëzohet zemra e besimtarit pas vdekjes së tij? Si?

Mësimi 19

MIKPRITJA DHE VIZITAT

Një tjetër etikë shoqërore islame është shkëmbimi i vizitave mes besimtarëve dhe mikpritja mes tyre. Është e domosdoshme që besimtari të interesohet për vëllanë e tij besimtar, ta vizitojë dhe ta pyesë atë për gjendjen e tij. Ky veprim çon në forcimin e lidhjeve vëllazërore mes besimtarëve.

Nëse vizitat mes besimtarëve do të jenë të pakta, do të shtohet largesa mes zemrave dhe do të dobësohen marrëdhëniet vëllazërore mes tyre. Prandaj, është detyrë e çdo besimtari që të ruajë lidhjet me vëllezërit e tij nëpërmjet vizitave. Nëse nuk është e mundur vizita, t'i dërgojë letra si shprehje e dashurisë, respektit dhe interesimit për gjendjen e tij.

Nuk ka dyshim se Islami i ka bërë marrëdhëniet vëllazërore për hirë të All-llahut, si dhe shkak për vizitat mes besimtarëve. Pra, vizita e besimtarit për vëllanë e tij besimtar të jetë për hir të All-llahut (xh.sh.).

Profeti Muhammed (s.a.s) ka thënë: **“Ai që viziton vëllanë e tij besimtar, pa patur nevojë për atë, do të jetë prej vizitorëve të All-llahut dhe vërtet All-llahu i bujaron vizitorët e Tij.”** (“Biharul Anvar”, vëll. 75, kreu 81, hadithi/77).

Dhe: **“Ai që e viziton vëllanë e tij në shtëpi, All-llahu do t'i thotë: “Ti je miku im dhe vizitori im, Unë do të të kënaq dhe do të të fus në Xhennet për dashurinë që ke ndaj tij (vëllait besimtar).”** (“Biharul Anvar”, vëll. 74, kreu 21, hadithi/6).

Imam Sadiku (a.s.) ka thënë: **“Atij, që e viziton vëllanë e tij për hir të All-llahut, All-llahu i thotë: “Ti më ke vizituar Mua dhe shpërblimi yt është tek Unë, e shpërblimi më i pëlqyer është Xhenneti.”** (“Biharu Anvar”, vëll. 74, kreu 21, hadithi/4).

Imam Bakiri (a.s.) sjell një hadith nga baballarët e tij se Profeti Muhammed (s.a.s.) ka thënë: **“Xhebraili më ka thënë se All-llahu (xh.sh.) zbriti një melek në tokë. Kur, meleku arriti tek dera e një shtëpie, pa një burrë që po merrte leje nga i zoti i shtëpisë.”** Meleku i tha: **“Çfarë nevojë ke ti për të zotin e kësaj shtëpie?”** Burri ia ktheu: **“Ky është vëllai im mysliman dhe unë e bëra vizit për hir të All-llahut (xh.sh.).”** Meleku e pyeti: **“Ti ke ardhur vetëm për ta vizituar?”** Burri i tha: **“Po, unë kam ardhur vetëm për ta vizituar.”** Meleku i tha: **“Unë jam i dërguar nga All-llahu tek ti dhe Ai të çon selam e të thotë: “Kam caktuar Xhennetin për ty.”** Në fund, meleku i tha: **“Vërtet, All-llahu (xh.sh.) thotë: “Cilido mysliman që viziton një mysliman tjetër, ai nuk vizituar atë, por më ka vizituar Mua dhe shpërblimi im për atë do të jetë Xhenneti.”** (“Biharul Anvar”, vëll. 59, kreu 23, hadithi/39).

Në këto hadithe si dhe tek të tjerët të ngjashëm me to kuptojmë se vizita tek besimtari për hir të All-llahut (xh.sh.) është sikur ke vizituar All-llahun (xh.sh.). Prandaj është detyra jonë që ta kemi këtë moral të lartë islam.

Nuk ka dyshim se shkëmbimi i vizitave mes besimtarëve ka dobi kulturore islame për të gjithë dhe shton dashamirësinë.

Profeti Muhammed (s.a.s.) ka thënë: **“Vizita mbjell dashamirësi.”** (“Biharul Anvar”, vëll. 76, kreu 21, hadithi/36).

Mikpritja

Është e natyrshme se një person kur dëshiron të presë miq ai përgatit një vend të posaçëm për pritje (që sot quhet dhoma e pritjes) duke i krijuar atij ambient dhe kushte

të përshtatshme. Mikpritja islame forcon lidhjet vëllazërore mes besimtarëve. Ka hadithe të cilat i nxisin besimtarët për këtë mikpritje dhe e vlerësojnë shumë atë. Profeti Muhammed (s.a.s.) ka thënë: **“Në atë shtëpi ku nuk hyjnë miq, nuk hyjnë as melekët.”** (“Biharul Anvar”, vëll. 75, kreu 93, hadithi/14).

Dhe: **“Nuk ka mirësi për atë njeri, i cili nuk pret miq.”** (“Mabaxh-xhetul Bejda”, vëll. 3, f. 32). Në disa thënie të tjera, Profeti e ka ndaluar shpenzimin e tepërt për mikun me qëllim që ky veprim të mos jetë shkak i zemërimit të tij (mikut). Profeti (s.a.s.) ka thënë: **“Mos shpenzoni tepër për mikun dhe ta zemëroni atë, sepse ai që e zemëron mikun, ka zemëruar All-llahun dhe ai që zemëron All-llahun, Ai do të jetë i zemëruar prej tij.”** (“Mebaxh-xhetul Bejda”, vëll. 3, f. 31).

Dhe: **“Miku vjen me riskun e tij dhe ikën me gjynahet e pjestarëve të familjes.”** (“Biharul Anvar”, vëll. 75 kreu 93, hadithi/14).

Imam Aliu (a.s.) ka thënë: **“Ai, të cilit All-llahu i ka dhënë pasuri, le tu japë të afërmve të tij dhe të përsosë mikpritjen.”** (“Biharul Anvar”, vëll.76, kreu 30, hadithi/35).

Rregullat e mikëpritjes

Për mikëpritjen ka rregulla. Disa prej tyre kanë të bëjnë me ftuesin dhe disa të tjera me mikun. Ndër këto rregulla po përmendim:

1- interesimi për etalonin e fesë. Në mikpritje dhe në gostinë tënde le të jenë të pranishëm besimtarë të devotshëm. Profeti Muhammed (s.a.s.) ka thënë: **“Mos ha ushqim tjetër përveç ushqimit të të devotshmit dhe në ushqimin tënd të mos hajë askush tjerët, përveç të devotshmit.”** (“Biharul Anvar”, vëll. 74, f. 86).

Dhe: **“Mos e ha ushqimin e fasikëve (të shturave, të pandërgjegjshmëve).”** (“Biharul Anvar”, vëll. 77, kreu 4, hadithi/2).

Dhe: **“Shtroje gostinë për ata që i do për hir të All-llahut.”** (“Biharul Anvar”, vëll. 75, kreu 93, hadithi/15).

2- Mos bëni dallim në përgjigjet e ftesave mes të pasurve dhe të varfërve. Vlerësimi i vetëm është që ftuesi të jetë besimtarë dhe i devotshëm. Në jetëshkrimin e nipit të Profetit (s.a.s.), imam Hasanit (a.s.) thuhet: **“Një ditë imam Hasani kaloi pranë disa të varfërve, të cilët kishin mbledhur copa buke dhe po i hanin ulur në anë të rrugës. Ata e ftuan imamin që të hante me to dhe imami e pranoi ftesën e tyre. “Vërtet, All-llahu nuk i do mëndjemdhentë.”, - tha imami. Kur mbaruan së ngrëni imam Hasani i ftoi për gosti në shtëpinë e tij. Ai i gostiti i veshi dhe u dha harxhë.”** (A'janu Shiatu).

Nuk duhet të rrimë pa shkuar e të shfajsohemi duke thënë se është larg etj, sepse në mësimin e kaluar lexuam hadithin e Profetit (s.a.s.): **“Porositi të pranishmit dhe jo të pranishmit prej ymmit tim që t'i përgjigjen ftesës së myslimanit edhe nëse është larg pesë milje (9-10 km), sepse kejo është prej fesë.”** (“Biharul Anvar”, vëll.72, f. 447).

6- Prej etikës së mikëpritjes është: miku të mos mendojë që të ulet në krye të tryezës, por të ulet aty ku mbaron tryeza, sepse të ftuarit e tjerë mund të mërzhiten për vendet e tyre. Miku të pritët me fjalë të ëmbla dhe të zgjedhë vendin e uljes.

7- Ftuesi të mos i shfrytëzojë të ftuarit për punë.

Imam Sadiku (a.s.) ka thënë: **“Profeti (s.a.s.) e ka ndaluar që miku të punojë.”** (“Biharul Anvar”, vëll. 75, kreu 41, hadithi/49).

8- Ftuesi të mos shpenzohet mbi mundësitë e tij, sepse familja e tij do të vihen në pozitë të vështirë. Në jetëshkrimin e imam Aliut (a.s.) thuhet: **“Një burrë e ftoi imam Aliun në shtëpinë e tij. Imam Aliu i vuri kusht tri gjëra: “Mos sill asgjë nga jashtë për mua, mos shto asgjë për mua për nga shtëpia dhe mos e dëmto**

familjen.” Kur burri i pranoi kushtet, imam Aliu e pranoi ftesën. (“*Biharul Anvar*”, vëll. 75, kreu 91, adithi/ 4).

Nuk ka dyshim se shpenzimi i tepërt për mikpritjen është në kundërshtim me marrëdhëniet vëllazërore. Miku do të shohë se ftuesi ka shpenzuar tepër para duke vënë në pozitë të vështirë familjen e tij. Mikut do t’i vijë keq dhe do të mendojë që të mos shkojë më për vizitë. Miku mund të mendojë që ai vetë duhet të përgatisë gosti më të madhe se kjo; kështu ata do të hyjnë në garë me njëri-tjetrin. Mirëpo, më pas do të ketë vakësi në marrëdhëniet vëllazërore.

9- Duhet që ftuesi të fillojë i pari për të ngrënë.

Imam Sadiku (a.s.) ka thënë: **“Kur Profeti hante me të tjerët, ishte i pari që fillonte dhe pastaj e ngrinte dorën për të ngrënë të tjerët.”** (“*Biharul Anvar*”, vëll. 75, kreu 91, hadithi/22). Ky veprim i ftuesit është në përshtatje me psikologjinë e mikut sepse ai ndoshta ka turp që të fillojë i pari.

10- Prej etikës shoqërore islame është që i zoti i shtëpisë t’i përcjellë miqtë deri tek dera e shtëpisë, kur largohen.

Profeti Muhammed (s.a.s.) ka thënë: **“Prej synetit të mikut është që të përcillet deri tek dera e shtëpisë.”** (“*Biharul Anvar*”, vëll. 75, kreu 91, hadithi/22). Miku nuk duhet të largohet pa marrë lejen e të zotit të shtëpisë. I zoti i shtëpisë duhet ta përshëndesë me fytyrë të qeshur dhe t’i shfaqë respekt dhe lumturi.

Përmbledhje

Mikpritja mes besimtarëve forcon lidhjet vëllazërore dhe është faktor për forcimin e respektit dhe të dashurisë mes tyre. Edhe hadithet e dëshmojnë këtë. Prej etikës islame është që të ftohen besimtarët dhe të devotshmit dhe jo të shthururit e të devijuarit.

Duhet që miku të hyjë në shtëpinë e ftuesit me fytyrë të qeshur dhe të largohet duke e falënderuar dhe duke i shprehur kënaqësinë. Miku duhet të ulet aty ku mbaron radha dhe të mos mëtojë për t’u ulur në krye të sofrës.

Duhet që i zoti i shtëpisë së gostisë të mos i ngarkojë të ftuarit me punë, të mos shpenzojë tepër, deri sa të vështirësojë veten e vet dhe familjen e tij dhe t’i përcjellë miqtë gjer tek dera e shtëpisë kur largohen.

I zoti i shtëpisë së gostisë duhet të fillojë i pari për të ngrënë dhe të mos çohet nga tryeza pa mbaruar të tjerët.

Pyetje

- 1-Ç’thonë hadithet për rëndësinë e vizitave mes myslimanëve?
- 2-Cili është etaloni i vizitave? Cili është qëllimi i vizitave sipas moralit islam?
- 3-Ç’vlera kanë vizitat mes besimtarëve?
- 4-Cilat janë rregullat e mikpritjes?

Mësimi 20

PËRSHËNDETJA DHE DHËNIA E SELAMIT

Përshëndetja është prej zakoneve të popujve dhe të kombeve. Nëpërmjet përshëndetjes, takimit dhe shtrëngimit të duarve njeriu shpreh dashamirësinë e tij dhe ndjenjat e tij. Në etikën islame njeriu përshëndet me: **“Es- selamu alejkum”**. Fjala “selam” është e mjaftueshme. Më pas vjen shtrëngimi i duarve dhe përqaftimi mes besimtarëve.

Imam Sadiku ka thënë: **“Selami është përshëndetje e bashkësisë sonë dhe siguri për ata që janë nën mbrojtjen tonë.”** (“Biharul Anvar”, vëll. 76, kreu 97, hadithi/46)

Kur’ani Famëlartë e përmend këtë përshëndetje të bekuar në disa vende. Po përmendim disa prej tyre:

All-llahu (xh.sh.) ka thënë: “Kur të hyni në ndonjë shtëpi, përshëndetni me përshëndetjen ...” **“Nuk është mëkat për të verbrin, as për të çalin, as për të sëmurin, as për ju vetë të hani në shtëpitë tuaja, ose në shtëpitë e etërve tuaj, në shtëpitë e nënave tuaja, në shtëpitë e vëllezërve e të motrave tuaja, në shtëpitë e xhaxhallarëve, të hallave, të dajave tuaj, në shtëpitë e tezeve tuaja ose të atyre që u janë besuar çelësat e tyre, ose në shtëpitë e miqve tuaj. Mund të hani bashkarisht ose veçmas, nuk është mëkat. Kur të hyni në ndonjë shtëpi, përshëndetni (ata që janë në to) më një përshëndetje të caktuar nga All-llahu (me “Selamun alejkum!”) që është e bekuar dhe e këndshme. Kështu All-llahu ua sqaron argumentet që t’i kuptoni.”** (Surja “Nur”:61)

All-llahu (xh.sh.) ka thënë: **“E, robtë e Zotit janë ata që ecin nëpër tokë të qetë e kur atyre të paditurit u drejtohen me fjalë, ata thonë: “Paq!”** (Surja “Furkanë”: 63). Në këtë ajet na thuhet se besimtari nuk ua vë veshin thënieve të Xhahilijetit dhe përgjigjet me “selam!”

Kur Azeri e kërcënoi Ibrahimin (a.s.) dhe e urdhëroi që të kthehet në adhurimin e statujave, Ibrahimiu iu përgjigj: **“Ai (Ibrahimi) tha: Qofsh i lirë prej meje! Unë do ta lus Zotin tim për të të falur ty, pse ai (babai) ishte i kujdesshëm ndaj meje.”** (Surja “Merjem”: 47).

Kur melekët shkuan tek Ibrahimiu si miq dhe kur hynë në shtëpinë e tij e përshëndetën duke i thënë: **“Edhe Ibrahimit i patën ardhur të dërguarit (melekët) tanë me siahariq dhe i thanë: “Selam!” Ai u përgjigj: “Gjithnjë paçi selam!” dhe nuk vonoi t’ju sillte një viç të pjekur (të fërguar me gurë).”** (Surja “Hudë”, 69).

Surja “Safat” ka përshëndetje të All-llahut për të dërguarit e Tij. Në sure thuhet: **“Selami qoftë Nuhut (prej All-llahut e prej krijesave) në mbarë botën (si kujtim ndaj tij)! “Selam (shpëtim) e paqë pastë “Ibrahimi!” (Përkujtimin) “Selamun”- qofshin të mëshiruar Musai e Haruni”. “Selamun”- qoftë i mëshiruar Iljasi (ose edhe besimtarët e Iljasit)!”** (Surja “Safat”: 79,109,120,130).

Në çatin kur shpirti i besimtarit shpëputet nga trupi i tij, e presin melekët me këtë përshëndetje të bekuar dhe e përgëzojnë për përfundimin e mirë: **“Atyreve që janë të pastër, melekët ua marrin shpirtin, duke u thënë: “Selamun alejkum!” Gjetët shpëtimin. Hyni në Xhennet, për hir të asaj që bëtë.”** (Surja “Nabl”, 32). Në Xhennet melekët i përshëndesin njerëzit e mirë duke u thënë: **“(Përfundimi i mirë është) Xhennete të Adnit ku do të hyjnë ata, edhe prindërit, gratë dhe fëmijët e tyre, të cilët kanë qenë vepërmirë. Ata do t’i vizitojnë melekët duke hyrë në secilën derë.”** (Dhe u thonë) **“Selamun alejkum!” Me durimin tuaj gjetët shpëtimin. Sa fund i lavdishëm është ky vend!”** (Surja “Rrad”, 23, 24)). Edhe banorët e Xhennetit e përshëndesin njëri-tjetrin me këtë përshëndetje: **“Lutja e tyre aty është: “I lartë je o**

All-llah!" E përshëndetja e tyre është: Selam! Dhe lutja e tyre e fundit: "Falënderimi i qoftë All-llahut, Zotit të botëve!" (Surja "Junus", 10).

Dhe: "E, ata që besuan dhe bënë vepra të mira, me urdhrin e Zotit të tyre u vendosën në Xhennete, nën pallatet e të cilëve rrjedhin lumenj, ku do të jenë përgjithmonë. Përshëndetja e tyre në të është "Selam" (paqe!)." (Surja "Ibrahim", 23).

Rëndësisë e kësaj përshëndetjeje dhe rolin e saj në forcimin e marrëdhënieve dhe të lidhjeve vëllazërore e gjejmë edhe në hadithet e Profetit (s.a.s.) dhe të Ehli Bejtit (a.s.). Po përmendim disa prej haditheve.

Profeti Muhammed (s.a.s.) ka thënë: **"Në Xhennet ka dhoma ku nga jashtë duket se ç'ka brenda dhe nga brenda duket ç'ka nga jashtë. Në ato dhoma banojnë ata që flasin fjalë të mira dhe japin ushqim, përhapin selamin dhe falen natën, kur njerëzit janë në gjumë."** ("Biharul Anvar", vëll. 8, kreu 23 hadithi / 5)

Transmetohet nga imam Sadiku se Profeti Muhammed (s.a.s.) ka thënë: **"O fësi i Abdul Mutalibit, përhapeni selamin, mbani lidhjet farefisnore, çohuni natën kur njerëzit janë në gjumë, ushqeni të varfrit dhe flisni fjalë të mira që të hyni në Xhennet."** ("Biharul Anvar", vëll. 69, kreu 38 hadithi / 74)

Dhe: **"Përshëndeti ata që takon sepse, Zoti do t'i shtojë të mirat! Përshëndete familjen tënde, që All-llahu t'i shtojë bereqetet e tua."** ("Biharul Anvar", vëll. 69, kreu 38 hadithi / 81)

Dhe: **"A t'ju them për moralin më të mirë të banorëve të kësaj jete dhe të jetës tjetër?"** Ata i thanë: **"Po, o i Dërguari i All-llahut."** Ai i tha: **"Përhapja e selamit në të gjithë botën."** ("Biharul Anvar", vëll. 76, kreu 98 hadithi / 50)

Dhe: **"Vërtet, selami është emër prej emrave të All-llahut (xh.sh.), prandaj përhapeni atë mes jush."** ("Biharul Anvar", vëll. 84, kreu 17 hadithi / 30)

Imam Sadiku (a.s.) ka thënë: **"Ai që thotë "selamu alejkum ue rahmetullahi", ai do të shpërblehet me dhjetë të mira"**. ("Biharul Anvar", vëll. 76, kreu 98, hadithi / 46)

Dhe: **"Prej shkaqeve të faljes janë përhapja e selamit dhe fjalët e mira."** ("Biharul Anvar", vëll. 76, kreu 98, hadithi / 47)

Dhe: **"Thjeshtësia është që t'i përshëndesësh ata që takon."** ("Biharul Anvar", vëll. 75, kreu 51, hadithi 9)

Përderisa përshëndetja është fjalë e mirë, ajo nuk e mundon njeriun. Mosthënia e saj është koprraci e njeriut të ashpër. Për këtë na kumtohet se Profeti Muhammed (s.a.s.) ka thënë: **"Njeriu më koprrac është ai që nuk jep selam."** ("Biharul Anvar", vëll. 100, kreu 5 hadithi / 26)

Rregullat e përshëndetjes dhe të selamit

Në Islam ka rregulla për përshëndetjen dhe selamin e ne duhet të kujdesemi.

1- Mirësia e fillimit të thënies së selamit. Përderisa përshëndetja është prej punëve të mira, atëherë kush jep më shumë selame është i lavdëruar. All-llahu (xh.sh.) ka thënë: **"...prandaj ju (besimtarë) përpiquuni për punë të mira!..."** (Surja "Maide", 48)

Historia tregon se Profetit Muhammed (s.a.s.) ishte i pari i cili përshëndeste. Transmetohet se Profeti (s.a.s.) ka thënë: **“Selami ka shtatëdhjetë të mira; gjashtëdhjetë e nëntë janë për atë që e thotë i pari dhe një për atë që e kthen.”** (“Biharul Anvar”, vëll.76, kreu,98 hadithi /46)

2- Duhet që selami të thuhet me zë të qartë e të dëgjueshëm; po ashtu, edhe kthimi i tij. Imam Sadiku (a.s.) ka thënë: **“Nëse ndonjë prej jush jep selam, ta thotë me zë të lartë dhe të mos thotë unë dhashë selam, por ju nuk ma kthyet (nuk u përgjigjet). Ndoshta ai përshëndeti dhe nuk u dëgjua. Nëse ndonjëri prej jush përgjigjet, të përgjigjet me zë të lartë me qëllim që përshëndetësi të mos thotë unë përshëndeta dhe ju nuk u përgjigjet.”** (“El-Kafij”, vëll. 2 f. 465, hadithi /7) Përshëndetja dhe selami jepet kur nis biseda. Profeti Muhammed (s.a.s.) ka thënë: **“Ai që fillon bisedën para se të japë selam, mos iu përgjigjni.”** (“Biharil Anvar”, vëll. 76, kreu 98, hadithi /6).

Imam Sadiku (a.s.) ka thënë: **“Selami jepet para fillimit të bisedës.”** (“Biharul Anvar”, vëll. 93, kreu 17, hadithi /17).

3- Selamit duhet të jepet nga të gjithë, sado në pozitë të lartë të jetë. Profeti Muhammed (s.a.s.) i nxiste pasuesit e tij për selamin. Ai (s.a.s.) ka thënë: **“Pesë gjëra nuk i lë pa vepruar derisa sa të më vijë vdekja. Ndër ato është përshëndetja e të vegjëlve, që të jetë synnet pas meje.”** (“Biharul Anvar”, vëll. 16, kreu 6, hadithi /37).

Etikën e selamit e përkufizon Profeti (s.a.s.) kur thotë: **“Është prej synnetit që të përshëndetet i hipuri mbi kafshë, të vegjëlit të përshëndesim të mëdhenjtë, të paktit të përshëndesin të shumtit, ai që është në këmbë të përshëndesë të ulurin.”**

4- Prej moralit dhe rregullave të Islamit në punë të përshëndetjes është që përgjigja për të të jetë e njëjtë ose më e mirë. All-llahu (xh.sh.) thotë në Kur’an: **“Kur përshëndeteni me ndonjë përshëndetje, ju ktheni përshëndetje edhe më të mirë, ose kthenie ashtu. All-llahu llogarit për çdo send.”** (Surja “Nisa”, 86).

Në jetëshkrimin e profetit Muhammed (s.a.s.) thuhet: **“Një ditë Profeti ishte ulur me një grup shokësh. Në ato çaste erdhi një burrë dhe përshëndeti me “es-selamu alejkum ue rahmetullahi.” Profeti ia ktheu: “Ue alejke selam ue rahmetullahi.” Më pas erdhi një tjetër e tha: “Es selamu alejkum ue rahmetullahi.” Profeti ia ktheu: “Ue alejke selam ue rametullai ue berekatuhu.” Pasa erdhi një i tretë dhe përshëndeti: “Es selamu alejke ue rahmetullahi ue berekatuhu.” Profeti ia kthen: “Ua alejke selam ua rahmetullahi ue berekatuhu.” Njërit prej shokëve të Profetit i bëri përshtypje ky veprim i tij, sepse, kur erdhën dy të parët dhe përshëndetën, Profeti shtoi një përgjigje, ndërsa kur përshëndeti i treti, Profeti ia ktheu po ashtu. Ai e pyeti për shkakun dhe Profeti iu përgjigj: **“I treti përshëndeti me përshëndetje të plotë.”** (“Biharul Anvar”, vëll. 81, f. 274).**

Nga hadithi kuptojmë se përshëndetje e plotë është që të themi “es-selamu alejkum ue rahmetullahi ue berekatuhu.”

Takimi dhe përqaftimi

Prej moralit islam dhe rregullave të tij është takimi dhe përqaftimi. Imam Aliu (a.s.) ka thënë: **“Kur të takoheni me vëllezërit tuaj (në fe), shtrëngoni duart dhe jepuni atyre buzëqeshjen e pastaj ndahuni. Nëse veproni kështu do t’ju largohen gjynahet.”** (“Biharul Anvar”, vëll. 76, kreu 100, hadithi /3).

Për rëndësinë e shtrëngimit të duarve (kur takohen vëllezërit besimtarë), Profeti Muhammed (s.a.s.) ka thënë: **“Shtrëngoni duart, sepse shtrëngimi i duarve largon smirën dhe urrejtjen!”** (“Biharul Anvar”, vëll 77, kreu 7, hadithi / 1).

Dhe: **“Përshëndetja e plotë kur njihemi është shtrëngimi i duarve dhe përshëndetja e plotë për udhëtuesin është përqaqimi.”** (“Biharul Anvar”, vëll 77, kreu 23, hadithi / 108).

Në jetëshkrimin e profetit Muhammed (s.a.s.) thuhet se kur Profeti takohej me dikë, nuk e hiqte dorën nga dora e tij derisa tjetri ta hiqte dorën e tij nga dora e Profetit (s.a.s.). Ky veprim shpreh dashurinë dhe respektin për tjetrin.

Përmbledhje

Përshëndetja, shtrëngimi i duarve dhe përqaqimi janë prej etikës islame dhe synetit të tij. Hadithet sqarojnë se si duhet të përshëndesë njeriu, se si të shpejtojmë të japim selamin si ta kthejmë atë- njësoj ose edhe më të plotë. Kjo etikë duhet të respektohet nga myslimanët. Hadithet sqarojnë se selami duhet dhënë para fillimit të bisedës.

Pyetje

- 1-Çfarë përfitojmë nga ajetet që flasin për selamin dhe përshëndetjen?
- 2- Çfarë do të thotë “përhapja e selamit”?
- 3- Përmendni rregullat e përshëndetjes sipas haditheve?
- 4- Si ta kthejmë përshëndetjen?
- 5- Shpjegoni hadithin e Profetit Muhammed (s.a.s.), i cili flet për përshëndetjen e plotë.

Mësimi 21

RUAJTJA E SHENJTËRIVE

All-llahu (xh.sh.) i ka krijuar njerëzit dhe ka caktuar për ta të drejta, kufij dhe shenjtëri. Ai i ka urdhëruar ata që të interesohen për këto dhe i ka ndaluar që të mos i shkelin të drejtat dhe kufijtë.

S'ka dyshim se nëse anëtarët e shoqërisë i zbatojnë këto parime, ata do të jenë të sigurt, të lumtur e të qetë. E nëse nuk do të ndodhë e kundërta, shoqërinë do ta udhëheqë anarkia dhe rrëmuja. Ajo shoqëri që mendon se individët e saj nuk kanë

shenjtëri personale, as kufij, as liri, as nder e dinjitet, do të jetë e prapambetur, e shkatërruar dhe do të shkojë drejt zhdukjes.

Për këtë All-llahu (xh.sh.) ka caktuar për robtë e Tij të shenjta e të drejta e ka dërguar profetë për t'ua sqaruar ato njerëzve. Më poshtë po paraqesim tri çështje të rëndësishme rreth të drejtave të njerëzve:

Të shenjtat individuale

Çdo njeri ka jetën e tij vetjake. Secili jeton në liri të plotë në shtëpinë e tij dhe është i mbrojtur nga ndërhyrjet e të tjerëve. Morali islam kërkon të respektohet jeta vetjake e individit. Këtë e përforcon edhe ajeti i Kur'anit: ***“O ju që keni besuar, mos hyni në shtëpi të huaja pa kërkuar leje dhe pa përshëndetur njerëzit e saj. Kjo është më mirë për ju, që të merrni mësim. Por nëse nuk gjeni aty asnjë, atëherë mos hyni në to derisa t’ju jepet leje. E nëse nuk ju lejojnë të hyni, kthehuni. Kjo është më e ndershme për ju. All-llahu di gjithçka që bëni ju.”*** (Surja “Nur”: 27-28).

Në kohën e Padijes (xhahilijetit) arabët e lejonin hyrjen në shtëpitë, qoftë edhe prej dritareje. Kur erdhi Islami vendosi për këtë rregulla, të cilat duhet të zbatohen nga myslimanët. Kur'ani Famëlartë thotë: ***“Në shtëpi hyni nga dyert e tyre dhe krijeni frikë All-llahun që ashtu të gjeni shpëtim.”*** (Surja “Bekare”, 189).

Islami ka rregulluar marrëdhëniet e rregullat brenda familjes. Kur'ani Famëlartë thotë: ***“O ju që keni besuar, ata të cilët i keni në pronësinë tuaj (shërbëtorët) dhe ata të cilët nuk kanë arritur moshën e pjekurisë duhet të kërkojnë leje prej jush (për të hyrë te ju) në tri kohë: para namazit të mëngjesit, në kohën e drekës kur i hiqni rrobat tuaja (për të pushuar) dhe pas namazit të jaciesë, që të tria këto kohë janë kur ju nuk jeni të veshur. Përveç këtyre tri kohëve nuk është mëkat as për ju as për ata të vizitoni njëri-tjetrin. Kështu All-llahu jua sqaron argumentet e veta. All-llahu është i dituri i urti.”*** “E, kur femijët tuaj ta arrijnë moshën e pjekurisë, le të kërkojnë leje (për të hyrë) ashtu siç kërkuan ata para tyre. All-llahu ju shpjegon dispozitat e Veta, sepse Ai është më i Ditur dhe më i Urti.” (Surja “Nur”: 58-59).

Mbulimi i të këqijave

Nuk ka njeri që të mos ketë të meta. Nuk ka njeri që të mos gabojë. Në hadithe thuhet se bijtë e Ademit gabojnë. Nuk ka njeri që nuk përpiket t'i mbulojë të metat dhe të këqijat. Mbuluesi i vertetë i të këqijave dhe i të metave është All-llahu (xh.sh.) dhe Ai i do ata që i mbulojnë të metat dhe të këqijat. S'ka dyshim se përhapja e të këqijave është veprim i shëmtuar dhe njëherazi e ndaluar (haram).

Profeti Muhammed (s.a.s.) ka thënë: ***“All-llahu do t'ia mbulojë të këqijat në Ditën e Gjykimit cilitdo që ia mbulon një të keqe vëllait të tij.”*** (“Tergib ue Terhib, vëll. 3, f. 239. “Musnedi i Ahmedit”, vëll. 4, f. 104).

Në jetëshkrimin e Profetit (s.a.s.) thuhet se një burrë i tha atij (s.a.s.): ***“Unë dëshiroj që All-llahu të m'i mbulojë të këqijat e të metat e mia.”*** Profeti Muhammed (s.a.s.) i

tha: ***“Mbuloji të këqijat e vëllezërve të tu, që All-llahu të t’i mbulojë të këqijat e tua.”*** (“Kenzul Ummal, vëll. 16, f. 129 hadithi /44154).

Transmetohet se Profeti (s.a.s.) ka thënë: ***“Ai që flet për vëllanë e tij dhe me fjalën e tij ka si qëllim që ky të mos shihet me sy të mirë te njerëzit, All-llahu do ta nxjerrë prej vilajetit të Tij dhe do ta fusë në vilajetin e shejtanit (djallit) e as ky nuk do ta pranojë atë.”*** (“Biharul Anvar”, vëll. 75, kreu 57, hadithi /40).

Imam Bakiri (a.s.) ka thënë: ***“Robi është më afër kufrit kur vëllazërohet me një tjetër në fe për të ditur të këqijat e tij dhe të vijë një ditë që me këta ta sulmojë atë.”*** (“Biharul Anvar”, vëll. 7, kreu 65, hadithi /13).

Çuarja e amanetit

Prej të drejtave të myslimanëve është përmbushja e amanetit, qoftë para, a sekret, a mall. Pa dyshim, përmbushja e amanetit është edhe detyrë e myslimanit dhe çdo tradhti në amanet konsiderohet mëkat dhe mohim i të drejtave dhe detyrave islame.

Morali islam e konsideron përmbushjen e amanetit prej cilësive të besimtarëve ndërsa tradhtinë në amanet e quan mëkat të madh. Kur’ani Famëlartë thotë: ***“Dhe ata të cilët me kujdes i ruajnë ato që u janë besuar (sende ose fjalë), e ruajnë edhe premtimin e dhënë.”*** (Surja “Mu’minun”: 8).

Në një ajet tjetër thotë: ***“All-llahu ju urdhëron që t’ua jepni amanetin të zotëve të tyre dhe kur të gjykoni, gjykoni me të drejtë mes njerëzve. Sa e mirë është kjo që ju këshillon! All-llahu dëgjon dhe sheh si veproni.”*** (Surja “Nisa”: 58).

Profeti Muhammed (s.a.s.) ka thënë: ***“Ai që nuk e çon në vend amanetin, nuk ka fe.”*** (“Kenzul Ummal”, vëll. 3, f. 677, hadithi /8436). Dhe: ***“Nuk është prej nesh ai që tradhton amanetin.”*** (“Biharul Anvar”, vëll. 75, kreu 58, hadithi /14).

Dhe: ***“Shenjat e dyfytyrësisë janë tri: Kur flet, gënjen; kur premtion, nuk e mban fjalën; dhe kur i besohet diçka, tradhton.”*** (“Biharul Anvar”, vëll. 72, kreu 106, hadithi /6).

Imam Sadiku (a.s.) ka thënë: ***“Mos shikoni sa gjatë rri një njeri në ruku e në suxhud, sepse ai është mësuar me këtë nëse e lë atë do të ndihet i vetmuar, por shiheni a thotë të vërtetën dhe a e çon në vend amanetin.”*** (“Biharul Anvar”, vëll. 71, kreu 60, hadithi /10).

Përmbushja e amanetit është pjesë e moralit të njeriut dhe e natyrës së tij krijuese, dhe xhevahiri i mesazheve të All-llahut.

Imam Sadiku (a.s.) ka thënë: ***“Vërtet, All-llahu (xh.sh.) i ka dërguar Profetët që të thonë të vërtetën dhe të çojnë në vend amanetin si për të mirët, ashtu edhe për të këqijtë.”*** (“Biharul Anvar”, vëll. 11, kreu 2, hadithi /21).

Imam Aliu (a.s.) ka thënë: ***“Mos e tradhto amanetin e atij që ta beson ty, edhe pse ai të tradhton dhe mos i përfol sekretet e tij, edhe pse ai i përflet sekretet e tua.”*** (“Biharul Anvar”, vëll. 77, kreu, 8, hadithi /10). Ky moral i lartë islam ka fryte për këtë jetë dhe shpërblim të madh në Ahiret.

Profeti Muhammed (s.a.s.) ka thënë: ***“Përmbushja e amanetit sjell pasuri dhe mospërmbushja e tij sjell varfëri.”*** (“Biharul Anvar”, vëll. 75, kreu 85, hadithi /4).

Imam Aliu (a.s.) ka thënë: ***“Kur forcohet amaneti, shtohet e vërteta.”*** (“Gurerul Hikem”, vëll. 4, f. 134).

Dhe: ***“Amaneti të çon të thuash të vërtetën.”*** (“Gurerul Hikem”, vëll. 2, f. 7).

Kemi thënë se amaneti nuk kufizohet vetëm te sendet e çmueshme, por edhe te sendet e pavlera, dhe te sekretet. Prandaj myslimani duhet ta mbajë amanetin dhe të mos tradhtojë kurrë amanetin. Vërtet, përmbushja e amanetit është detyrë e caktuar nga All-llahu për çdo mysliman dhe myslimane.

Përmbledhje

Çdo njeri ka jetën e tij vetjake. Çdo njeri ka shenjtëri. Prandaj nuk lejohet shkelja e tyre. Çdo njeri ka pasuri, dinjitet, dhe sekrete. Amaneti i tyre nga të gjithë duhet të respektohet dhe të çohet në vend. Nuk lejohet hyrja në shtëpinë e tjerit pa lejen e tij. Nuk lejohet përhapja e sekretit të tij. Ai që e bën këtë është tradhtar.

Pyetje

- 1- Cilat janë të shenjtat personale?
- 2- Cilat janë kohët që cakton ajeti kur'anor për të marrë leje për të hyrë në shtëpinë e tjetrit?
- 3- Përse Islami e quan përhapjen e të këqijave okupim për të shenjtat e njerëzve?
- 4- Çfarë përfshin amaneti?

Mësimi 22

MIKU DHE SHOKU (1)

Shoqëria a miqësia është prej dukurive më të qarta në jetën njerëzore. Në të shumtën e rasteve njeriu zgjedh shokun a mikun sipas provave të jetës së tij. Shoku është njeri tjetër i cili përputhet me zemrën, me shpirtin dhe është tërheqës. Po ashtu jeta shoqërore e kërkon shokun a mikun, kur njeriu përballlet me ndonjë problem apo fatkeqësi ai gjen mbështetje te shoku. Morali islam e nxit krijimin e shoqërisë e të miqësisë dhe ka caktuar për atë pozitë të veçantë.

Profeti Muhammed (s.a.s.) ka thënë: **“Njeriu njihet nga shoku i tij, prandaj shikoni atë me të cilin ai shoqërohet.”** (“Biharul Anvar”, vëll. 72, kreu 14, hadithi /12).

Dhe: **“Provojini njerëzit me shokët e tyre, sepse njeriu zgjedh atë që i pëlqen.”** (“El-Mustedrek”, vëll. 8, kreu 10, f. 327, hadithi /9568).

Imam Aliu (a.s.) ka thënë: **“Ai që nuk ka shok nuk ka krenari.”** (“Gurerul Hikem”, vëll. 11, f. 177).

Dhe: **“Shokët janë një shpirt në dy trupa.”** (“Gurerul Hikem”, vëll. 2, f. 123).

Nëse duam të njohim personalitetin e një njeriu atë mund ta bëjmë nëpërmjet njohjes së personalitetit të shokut të tij.

Imam Aliu (a.s.) ka thënë: **“Çdo njeri anon nga ai me të cilin është i njëjtë.”** (“Gurerul Hikem”, vëll. 4, f. 376).

Dhe: **“Të mirët shoqërohen me të mirët dhe të këqijtë shoqërohen me të këqijtë e i duan ata që janë të njëjtë me ta.”** (“Gurerul Hikem”, vëll. 6, f. 376).

Nga këto thënie kuptojmë se duhet pasur kujdes në zgjedhjen e shokëve. Cilat janë karakteristikat e shokut të kërkuar sipas Kur’anit dhe Haditheve?

Kur’ani Famëlartë i konsideron besimtarët një familje e përbashkët mënyrë të përgjithshme, të aftë për shoqëri e miqësi. Faktori i parë për këtë është besimi. All-llahu (xh.sh.) thotë: **“Dhe mos i largo ata që në mëngjes dhe në mbrëmje i luten Zotin të tyre duke dëshiruar mirësinë e Tij. Ti për ata nuk mban përgjegjësi asgjë nga llogaria e tyre e as ata nuk kanë kurfarë përgjegjësie, pra, nuk japin llogari për ty. Po i përzure do të jesh mëkatar.”** (Surja “El-Enam”:52).

Dhe: **“Përkufizojë veten tënde me ata që lusin Zotin e tyre mëngjes e mbrëmje e që kanë për qëllim kënaqësinë e Tij, dhe mos i hiq sytë e tu prej tyre e të kërkosh bukurinë e kësaj bote dhe mos iu bind atij që ia kemi shmangur zemrën prej kujtimit ndaj Nesh dhe i është dhënë epshit të vet, sepse puna e tij ka mbaruar.”** (Surja “Kehf”:28).

Të mirët i meritojnë më shumë marrëdhëniet shoqërore e miqësore. Profeti Muhammed (s.a.s.) ka thënë: **“Njeriu më i lumtur është ai që bashkohet (shoqërohet) me njerëzit e mirë.”** (“Biharul Anvar”; vëll. 1, kreu 4, hadithi /13).

Dhe: **“Pyetëni dijetarët, bashkohuni me të urtët dhe uluni me të varfërit.”** (“Biharul Anvar”; vëll. 1, kreu 3, hadithi,5)

Imam Askeriu (a.s.) transmeton nga gjyshi i tij, imam Zejnul Abedin një hadith i cili e shtjellon më së miri si ta zgjedhim shokun. Ai ka thënë: **“Nëse shikoni një njeri, i cili është i njohur në mesin e njerëzve me fjalë e me vepra, kujdesuni që të mosmashtroheni. Sa të shumtë janë ata që janë të paaftë për këtë jetë dhe në veprimin e të ndaluarve të saj, për shkak të dobësisë së trupit të tij dhe dobësisë së zemrës së tij. Ai e ka bërë fenë kurth të kësaj jete dhe vazhdon të mashtrojë njerëzit me pamjen e jashtme. Nëse ballafaqohet me diçka haram (të ndaluar) sprovoje atë. Nëse e shihni atë se nuk i afrohet fitimeve të ndaluara, kujdesuni që të mos ju mashtrojë, sepse dëshirat e njerëzve janë të ndryshme ... Nëse shikoni se mendja e tij është e fortë, kujdesuni të mos ju mashtrojë derisa të shihni se a është mendja e tij sunduese e dëshirave të tij, apo është pasuese e dëshirave të tij... Por njeriu më i mirë është ai që dëshirat e tij i bën ndjekëse të urdhrave të All-llahut dhe fuqitë e tij i përdor në ato punë që kënaqet All-llahu (xh.sh.)...”**

Etaloni themelor që përmend Imam Zejnul Abedin në këtë hadith për personalitetin e shokut e të mikut është ndjekja e sheriatit të All-llahut (xh.sh.), sepse ti e sheh një

person aktiv, energjik në çdo vepër që e pëlqen All-llahu. Nëse është me drejtësinë, ai e pranon poshtërimin nga mendjemadhësia. Ai është i durueshëm për çdo gjë që mund t'i ndodhë. Imam Sexhadi (a.s.) na thotë që të mos mashtrohemi me pamjen e jashtme të disa njerëzve.

Imam Aliu (a.s.) ka thënë: **“Shoqërohu me të urtit, ulu me të diturit dhe kundërshtojë dynjanë që të hysh në Xhennet.”** (“Gurerul Hikem”; vëll. 4. f. 205).

Imam Hasani (a.s.) cakton kushtet në zgjedhjen e shokut kur i thotë njërit prej shokëve të tij: **“Shoqërohu me atë që të zbukuron kur e shoqëron, të mbron kur i shërben, të përkrrah kur ke nevojë për përkrrahje, të beson kur flet, të jep kur i kërkon, të ndihmon kur të bie ndonjë fatkeqësi**”

Përmbledhje

Duke parë rëndësinë e shokut dhe rolin e tij në jetën e njeriut dhe në moralin e tij, hadithet na nxitin që të zgjedhim shokun mbi bazat e besimit dhe të devotshmërisë.

Pyetje

- 1- Cili është etaloni themelor në zgjedhjen e shokut?
- 2- Cilat janë kushtet dhe karakteristikat kryesore të cilat duhen të kenë shokët?

Mësimi 23

MIKU DHE SHOKU (2)

Në mësimin e kaluar mësuam se njeriu duhet të tregojë kujdes për zgjedhjen e mikut dhe të shokut, sepse kjo ndikon shumë në jetën e tij vetjake. Prandaj duhet që të zgjedhim atë shok i cili ndikon për mirë në jetën tonë. Në këtë mësim do të flasim për cilësitë e atyre njerëzve nga të cilët duhet të kujdesemi dhe të mos i zgjedhim për miq dhe shokë. Duhet të dimë që ne nuk jemi plotësisht të lirë në shoqërim dhe as të lirë për të folur çfarë të duam.

Imam Zejnul Abedini ka thënë: **“Ti nuk je i lirë të ulesh me këdo, sepse All-llahu (xh.sh.) thotë: “Kur sheh ata se janë thelluar (me tallje) në çështjet Tona, largohu prej tyre derisa të kalojnë në bisedë tjetër. Nëse djalli të bën të harrosh (e rri me ta) pastaj të**

bie ndërmend, mos rri me popullin mizor.” (Surja “En’am”: 68). Nuk je i lirë të flasësh çfarë të duash, sepse Allahu (xh.sh.) thotë: **“Mos iu qas asaj për të cilën nuk ke njohuri, sepse për veshin, për syrin dhe për zemrën, për të gjitha këto ka përgjegjësi.”** (Surja “Isra”:36), sepse i Dërguari i All-llahut ka thënë: **“All-llahu e mëshiroftë atë njeri i cili flet fjalë të mira dhe mjaftohet, ose hesht dhe është i ruajtur.”** Ti nuk je i lirë të dëgjosh çfarë të duash, sepse All-llahu (xh.sh.) thotë: **“Dhe jepi çdo të afërmi të drejtën që i takon, edhe të varfrit, edhe atij në kurbet, po mos shpenzo tepër e pa arsye.”** (Surja “Isra”:26).

Ndikimet e shokut të shturur e të pandërgjegjshëm arrijnë deri në ato kufij, saqë e çojnë njeriun në shkatërrim dhe në ndëshkimin e All-llahut.

Sulejman Xha’ferij transmeton: “Dëgjova ebu Hasanin, imam Rizain (a.s.) duke i thënë babait tim: “Unë të pashë tek Abdu Rrahman ibn Ja’kub.” Babai i tha: “Ai është daja im.” Imami i tha: “Ai thotë fjalë të mëdha për All-llahun (xh.sh.). Ai thotë për All-llahun ato që nuk i meriton. Atëherë ai i tha: “Ose të qëndrosh me të e të largohesh prej nesh, ose të qëndrosh me ne e të largohesh prej tij.” Babai im i tha: “Ai është i lirë të flasë çfarë të dojë. Çfarë gjynahu kam unë për ato që ai thotë e unë nuk i them?” Ebu Hasani tha: “A nuk frikësohesh që mbi të bie dënimi dhe do t’ju godasë edhe ju? A nuk e di historinë e shokut të Musait (a.s.) babai i të cilit ishte prej shokëve të Faraonit? Kur kalorësit e Faraonit ndiqnin (i shkonin pas) Musait (a.s.), ai u nda nga Musai që të këshillonte babanë e tij dhe ta bënte prej ndjekësve të Musait (a.s.) dhe u mbytën që të dy. Lajmi i shkoi Musait dhe ai e pyeti Xhebrailin për gjendjen e shokut të tij. Xhebraili i tha: “U mbyt, All-llahu e mëshiroftë, por nuk ka qenë i një mendimi me babanë e tij. Kur vjen ndëshkimi i All-llahut, për atë që gjindet pranë gjynahqarit nuk ka shpëtues.” Cilët janë ata njerëz me të cilët nuk duhet të rrimë me ta e nuk duhet të shoqërohemi? Ajetet e Kur’anit dhe hadithet a e zbulojnë këtë çështje. Ata janë:

1- Njerëzit që tallen me fenë. All-llahu (xh.sh.) thotë: **“O ju që besuat! Mos i merrni për miq ata, të cilëve u është dhënë Libri para jush edhe as jobsimtarët, që tallen e luajnë me fenë tuaj. Kijeni frikë All-llahun po qe se jeni besimtarë.”** (Surja “Maide”: 57). Nuk na lejohet ne që të bashkohemi me të tillë njerëz dhe t’i bëjmë shokë këta njerëz, sepse ato shkelin kushtin e parë të shoqërisë e të miqësisë i cili është respekti i ndërsjelltë.

2- Ata që nuk e respektojnë shenjtërinë e Profetit dhe familjes së tij. Në jetëshkrimin e Profetit (s.a.s.) thuhet se Ukbetu ibn ebi Muijt rrinte shpesh me Profetin (s.a.s.). Një ditë e fton Profetin (s.a.s.) në gosti, por Profeti refuzoi ta hante ushqimin e tij derisa të dëshmonte dy dëshmitë dhe ai pranoi. Shoku i tij ibn ebi Khalef e qortoi për këtë veprim: “U bëre fëmijë.” Ukbetu iu përgjigj: “Jo, pasha All-llahun, por ai nuk pranoi të hante ushqimin tim dhe ndodhej në shtëpinë time. Unë u turpërova nga ai dhe i dëshmova atij dy dëshmitë.” Shoku i tha: “Unë nuk jam i kënaqur nga ti nëse nuk e godet dhe nuk e pështyn në fytyrë.” Ai e gjeti Profetin (s.a.s.) duke u falur në shtëpinë e Neduetu. Pasi përfundoi namazin Ukbetu e goditi dhe e pështyu. Profeti i tha: “Mos të pafsha jashtë Mekës, sepse po të pashë, do ta vendos kokën tënde mbi majën e shpatës. Ukbetu u kap rob në luftën e Bedrit dhe Profeti e urdhëroi Aliun që ta vriste dhe Aliu ashtu veprroi. Pastaj zbritën ajetet: **“Atë ditë keqbërësi do t’i kafshojë duart e veta dhe do të thotë: “I mjeri unë, të kisha marrë rrugën e Pejgamberit!” “O shkatërrimi im! Ah të mos e kisha bërë filanin mik!” “Në të vërtetë, pasi e gjeta rrugën e drejtë, ai më largoi mua prej saj, e djalli është ai që e humb dhe e lë njeriun të vetmuar.”** (Surja “Furkan”: 27-29). I tillë do të jetë fundi i Ukbetu dhe i të tjerëve si ai në Ditën e Gjykimit, përshkak se i bënë padrejtësi vetes së tyre duke ndenjur me shokë të këqinj.

Ne duhet ta përfytyrojmë këtë skenë, kur Ditën e Gjykimit disa njerëz do të kafshojnë gishtërinjtë e tyre prej pendimit, sepse zgjodhën shokë të këqij, të cilët i mashtruan, i larguan nga rruga e drejtë dhe i çuan në humbje.

Imam Sadiku (a.s.) ka thënë: **“Ai që ulet me fyesit e eulijave të All-llahut ka bërë mëkat.”** (“Biharul Anvar”, vëll. 74, kreu 14, hadithi /5).

Dhe: **“Ai që beson në All-llahun dhe në Ditën e Gjykimit të mos ulet në ato vende ku shahet prijësi a ku fyhen besimtarët.”** (“Biharul Anvar”: vëll. 74, kreu 14, hadithi /48).

3- Bidatçinjtë dhe ata që përhapin dyshime për fenë e bazat e saj. Profeti Muhammed (s.a.s.) ka thënë: **“Nëse shikoni dyshimtarë dhe bidatçijnë pas meje kundërshtoni ata, që të mos lakmojnë për fesad (shkatërrim) në Islam. Njerëzit të kenë kujdes prej tyre dhe të mos i mësojnë bidatet e tyre. Nëse veproni kështu All-llahu, do t’ju shpërblejë me të mira dhe do t’ju ngrejë pozitën në ahiret.”** (“Biharul Anvar”, vëll. 74, kreu 14, hadithi /41). Dhe: “Njeriu (vazhdon

Imam Sadiku (a.s.) ka thënë: **“Mos u shoqëroni me bidatçijtë dhe mos rrini me ta, sepse njerëzit do t’ju quajnë të tillë si ata.”** (“El- Kafij”; vëll. 2, f. 642).

4- Të këqijtë, të shtururit dhe ata që bëjnë gjynahe.

Imam Aliu (a.s.) ka thënë: **“Myslimani nuk duhet të vëllazërohet me të shtururin, sepse ai ia zëbukuron veprat e veta, që myslimani të jetë njësoj si ai. Ai nuk e përkerah në punët e jetës së tij e as të ahiretit...”** (“El Kafij”, vëll. 2, f. 640, hadithi /2).

Imam Sadiku (a.s.) ka thënë: **“Myslimani nuk duhet të shoqërohet me të shtururin, as me të çmendurin e as me gënjeshtarin.”** (“El- Kafij”; vëll. 2, f. 640, hadithi /2).

Imam Aliu ka thënë: **“Shoqërimi i të mirëve me të këqijtë sjell paragjykim të keq për ta (të mirët) dhe shoqërimi i të këqijve me të mirët bën që të këqijtë të ndjekin të mirët... Nëse nuk keni dyshim për një njeri dhe nuk e dini fenë e tij, atëherë shikoni atë me të cilin shoqërohet. Nëse shoku i tij është fetar, edhe ai do të jetë fetar; nëse shoku i tij nuk është fetar, edhe ai është i tillë. Vërtet, i Dërguari i All-llahut (xh.sh.) ka thënë: “Ai që beson në All-llahun dhe në Ditën e Gjykimit, të mos shoqërohet me jobesimtarin dhe me të shtururin. Ai do të jetë si ata.”** (“Biharul Anvar”; vëll. 74, kreu 14, hadithi /31).

5- Përqeshësit, budallenjtë, të çmendurit dhe gënjeshtarët.

Imam Aliu (a.s.) ka thënë: **“Myslimani nuk duhet të shoqërohet dhe të vëllazërohet me budallanjtë, të çmendurit dhe gënjeshtarët.”** (“Biharul Anvar”; vëll. 74, kreu 14, hadithi 43).

Imam Sadiku (a.s.) transmeton se Ebi Ali Husejn ka thënë: **“O biri im me pesë njerëz mos u shoqëro e as mos bisedo!”** Unë i thashë: **“O babai im, cilët janë ata?”** Ai tha: **“I mjeri ti dhe shoqërimi i gënjeshtarit, sepse ai të afron të largëtën dhe të largon të afërtën. I mjeri ti dhe shoqërimi i të pandershmit, sepse ai të shet ty për një kafshatë ose për më pak. I mjeri ti dhe shoqërimi i koprracit, sepse ai të poshtëron me pasurinë e tij. I mjeri ti dhe shoqërimi i të çmendurit, sepse ti do që të të fitosh e ai të dëmton. I mjeri ti dhe shoqërimi atij që shkëput lidhjet farefisnore, sepse unë kam parë në Librin e All-llahut në tre vende që ai është i mallkuar.”** Pastaj imami lexoi ajetet: **“A pritët prej jush (dyfytirakëve, hipokritëve) që nëse merrni sundimin (ose zëbrapseni prej fesë islame) të bëni trazira në tokë dhe të ndërprisni lidhjet farefisnore?”** **“Të tillë janë ata që All-llahu i mallkoi, i bëri të shurdhët dhe ua vërboi sytë.”** (Surja “Muammed” :22,23).

Dhe: **“E ata që e thyen besën e dhënë All-llahut pasi qenë zotuar, e këpusin atë për të cilën All-llahu ka urdhëruar të jetë e pakëputur, bëjnë shkatërrime në tokë, ata janë të mallkuar dhe ata kanë përfundim të keq.”** (Surja “Rra’ad” :25).

Dhe: *“Ata që e thyejnë besën e dhënë All-llahut pasi është lidhur ajo dhe e këpusin atë që All-llahu ka urdhëruar të jetë e kapur edhe bëjnë shkatërrime në tokë, të tillë janë ata të dështuarit.”* (Surja “Bekare” :27). (Shiko mësimin e katërt).

Imam Bakiri (a.s.) ka thënë: *“Mos u shoqëro e mos u vëllazëro me katër llojë njerëzish: të çmendurin, kopracin, frikacakun dhe gënjeshtarin. I çmenduri, kërkon të të ndihmojë por të dëmton; kopraci merr nga ti dhe nuk të jep; frikacakun largohet nga ti dhe nga prindërit, ndërsa gënjeshtari e pranon thënien tënde por nuk thotë të vërtetën.”* (“Biharil Anvar”; vëll. 74, kreu 14, hadithi /8).

Përmbledhje

Islami i porositi besimtarët që të mos shoqërohen me të shtururin, gënjeshtarin, të çmendurin si dhe atë që hedh dyshime për fenë dhe besimin islam.

Pyetje

- 1- Përse nuk duhet të vendoset ura e shoqërisë a e miqësisë me të gjithë?
- 2- Cilat janë të këqijat që vijnë kur shoqërohemi me atë që nuk ka besim të rregullt?
- 3- Çfarë përfitojmë nga historia e Ukbetu ibn ebi Muijt?

Mësimi i 24

PËRGOJIMI

Në mësimin e gjashtë u tha se sistemi shoqëror islam është ngritur mbi parime morale. U tha gjithashtu, vetitë morale islame si, thjeshtësia, drejtësia, fytyra e qeshur, mbajtja e besës, etj konsiderohen si kushte të jetës shoqërore për myslimanin.

Përballë këtyre vetive morale pozitive, ka veti negative, të cilat prishin marrëdhëniet shoqërore dhe i sjellin dëme të mëdha shoqërisë. Prandaj, mënjanimi i vetive negative është një kusht tjetër prej etikës shoqërore në besimin islam. Me fjalë të tjera, mënjanimi i këtyre vetive është detyrë sipas Sheriatit. Mënjanimi dhe largimi prej këtyre cilësive i forcon marrëdhëniet shoqërore dhe bën që të dominojë pastërtia, solidarësia dhe uniteti në shoqërinë islame.

Në këtë mësim do të flasim për një prej vetive negative, e cila është përgojimi.

Ç’është përgojimi?

Përgojim do të thotë “përmendje pas shpine e atyre gjërave që tjetrit nuk i pëlqen që ti përmenden. Pra, po i përmende të këqijat dikujt pas shpine (kur nuk është i pranishëm), do të thotë se e ke përgojuar atë.

Profeti Muhammed (s.a.s.) ka thënë: **“Përgojimi është që të përmendësh për vëllanë tënd ato që ai nuk i pëlqen.”** I thanë: **“Po nëse ato që themi i ka ai?”** Ai tha: **“Nëse i ka dhe ti ia përmend, e ke përgojuar, nëse ato që thua për atë nuk i ka dhe ti ia përmend, ke shpifur.”** (“Biharul Anvar”; vëll. 72, f. 222).

Imam Sadiku (a.s.) ka thënë: **“Përgojim do të thotë që t’i përmendësh vëllait tënd ato që All-llahu ia ka mbuluar.”** (“Biharul Anvar”; vëll. 75, kreu 66, hadithi / 7).

All-llahu ia ka mbuluar të metat nga sytë e njerëzve, kurse ti ia nxjerr. Ky veprim e mbush zemrën e tjetrit me dhimbje e lëndime.

Imam Kadhimi (a.s.) ka thënë: **“Kur ia përmend një njeriu pas shpine ato gjëra që ia njohin të tjerët, nuk e ke përgojuar. Kur i përmend një njeriu ato gjëra që ai i ka dhe njerëzit nuk i dinë, e ke përgojuar. Kur i përmend ato gjëra që nuk i ka, ke shpifur për të.”** (“Biharul Anvar”; vëll. 75, kreu 66, hadithi / 6).

Shpifja është më e keqe se përgojimi, sepse, i përmend të këqijat dhe të metat që nuk i ka dikush.

Në këtë rast qëllimi i përgojimit është poshtërimi i një njeriu para të tjerëve.

Kur i përmendim të këqijat e një njeriu në praninë e një psikologu me qëllim shërimi, nuk quhet përgojim. As përmendja e të këqijave të jobesimtarëve armiq të Islamit nuk quhet përgojim. As përmendja e të këqijave apo të metave dikujt që i bën haptazi, p.sh të thuhet se aksh njeri pi alkool dhe njerëzit e njohin dhe e dinë që ai e bën këtë veprim haptazi nuk është përgojim.

Ndalimi i përgojimit

Ajetet e Kur’anit Famëlartë dhe hadithet islame e sqarojnë më së miri poshtërsinë e përgojimit. All-llahu (xh.sh.) thotë në Kur’an: **“O ju që keni besuar, largohuni prej dyshimeve të shumta, meqë disa dyshime janë mëkat dhe mos gjurmoni për të zbuluar të metat e njëri-tjetrit, dhe mos e përgojoni njëri-tjetrin. A mos ndonjëri prej jush dëshiron të hajë mishin e vëllait të vet të vdekur?! Atë e urreni! Kijeni frikë nga ndëshkimi i All-llahut! E All-llahu është Mëshirues, Ai e pranon shumë pendimin.”** (Surja “Huxburatë”; 12).

S’ka dyshim se përgojimi është prej veprave aq të shëmtuara, siç thotë edhe Kur’ani: përgojimi është njësoj sikur të hahet mishi i njeriut të vdekur. Profeti Muhammed (s.a.s.) ka thënë: **“Është e ndaluar për myslimanin gjakderdhja e myslimanit tjetër, pasuria e tij dhe nderi i tij.”** (“Kenzul Ummal”; vëll. 1, f. 150, hadithi / 747).

Përgojimi është prekje e dinjitetit të besimtarit dhe okupim i shenjtërive të tij.- siç është vrasja krim i shëmtuar: vrasja është mësymje në jetën e njeriut; përgojimi është mësymje në dinjitetin e njeriut. Prandaj, përgojimi quhet krim i shëmtuar dhe mëkat i madh. Prandaj është detyrë e çdo myslimani që kur të dëgjojë një njeri që përgojon besimtarët, ta kundërshtojë atë dhe ta mbrojë dinjitetin e të përgojuarit.

Profeti Muhammed (s.a.s.) ka thënë: **“Nëse poshtërohet një besimtar përpara një tjetri dhe ti je në gjëndje ta mbrosh besimtarin nga poshtërimi dhe nuk e mbron, All-llahu do të të poshtërojë Ditën e Gjykimit para njerëzve.”** (“Biharul Anvar”; vëll. 75, kreu 66, hadithi / 1).

Ka shpërblim të madh për atë njeri i cili mbron dinjitetin e besimtarëve prej përgojimeve.

Profeti Muhammed (s.a.s.) ka thënë: **“Ai që e mbron vëllain e tij nga përgojimi, All-llahu do ta mbrojë atë në Ditën e Gjykimit.”** (Biharul Anvar).

Dhe: **“Atë që ndërhyt në mbrojtjen e nderit të besimtarit prej përgojimit, vërtet All-llahu do ta mbrojë prej zjarrit.”** (“Muhaxhetul Bejda”; vëll. 5, f. 261). Aq i shumtuar është përgojimi saqë Kur’ani e konsideron si ngrënie e mishit të njeriut të vdekur. Ky është i vetmi krahasim që përdor Kur’ani për mëkatet e mëdha. Në një hadith Profeti Muhammed (s.a.s.) ka thënë: **“Atij njeriu që në dynja ka ngrënë mishin e vëllait të tij (duke e përgojuar), në Ditën e Gjykimit do t’i jepet prej mishit të atij dhe do t’i thuhet: hajë siç e hëngre në dynja. Ai do ta hajë dhe do të ulërijë.”** (“Fet’bul Barij”; vëll. 10, f. 392).

Dhe: **“Në udhëtimin e Israsë unë pashë njerëz që gërvishnin fytyrat me thonj.”** Unë thashë: **“O Xhebrail, cilët janë ata?”** Ai tha: **“Janë ata që përgojnin njerëzit dhe flisnin për nderet dhe dinjitetin e tyre.”** (“Biharul Anvar”; vëll. 75, kreu 66, hadithi / 1).

Dhe: **“Mjerë ata që përgojnë! Përgojimi është më i shëmtuar se prostucioni (zinaja). Një njeri kryen zina mund të pendohet e All-llahu ia pranon pendimin. Por, All-llahu nuk e fal përgojuesin derisa i përgojuari ta falë atë (përgojuesin).”** (Biharul Anvar).

Përgojimi është faktor i përhapjes së shpifjeve dhe ngacmimeve në mesin e shoqërisë. Në Kur’an thuhet: **“Ata të cilët dëshirojnë që te besimtarët të përhapet imoraliteti, i pret dënim i dhembshëm në këtë dhe në Botën tjetër. All-llahu di (të fshehtat) e ju nuk e dini.”** (Surja “Nur”, 19).

Transmetohet se Imam Sadiku (a.s.) ka thënë: **“Ai që thotë për besimtarin atë që ia kanë parë sytë dhe i kanë dëgjuar veshët, është prej atyre, për të cilët All-llahu thotë: “Ata të cilët dëshirojnë që te besimtarët të përhapet imoraliteti, i pret dënim i dhembshëm në këtë dhe në Botën tjetër. All-llahu di (të fshehtat) e ju nuk e dini.”** (Surja “Nur”, 19). (“Biharul Anvar”; vëll. 75, kreu 66, hadithi / 2).

Thënia e Imam Sadikut ka kuptimin: nëse shikon te vëllai yt atë që nuk ia kanë parë të tjerët dhe dëgjon atë që nuk i kanë dëgjuar të tjerët, pastaj i përhap ato, ky është përgojim dhe përhapje e intimiteteve.

Përgojimi është ushqim për qentë e zjarrit.

Imam Aliu (a.s.) ka thënë: **“Largohuni nga përgojimi sepse ai është ushqim i qenve të zjarrit.”** (“Biharul Anvar”; vëll. 75, kreu 66, hadithi / 13). Një ditë Imam Hysejmi (a.s.) kaloi pranë një burri i cili po përgojonte dhe i tha atij: **“O rob i Zotit! Mos përgojo, sepse përgojimi është ushqim për qentë e zjarrit.”** (“Biharul Anvar”; vëll. 71, kreu 20, hadithi / 2).

Imam Aliu (a.s.) ka thënë: **“Të këqijtë duan që të shfaqen të metat e të tjerëve që të shfajësohen prej të metave të veta.”** (“Gurerul Hikem”; vëll. 4, f. 38).

Përgojimi është si zjarri. Ashtu siç djeg zjarri drutë, edhe përgojimi djeg punët e mira.

Imam Sadiku (a.s.) ka thënë: **“Përgojimi është i ndaluar, për myslimanin, sepse ai djeg të mirat njësoj siç djeg zjarri drutë.”** (“Keshfu Rijbetu”; f. 9).

Përgojimi është si sëmundja e pashërueshme. Ai e shkatërron dinjitetin dhe personalitetin e të përgojuarit.

Profeti Muhammed (s.a.s.) ka thënë: **“Përgojimi është më i shpejtë se ngrënia e kafshatës.”** (“Biharul Anvar”; vëll. 75, kreu 66, hadithi / 1).

Dhe: *“Në Ditën e Gjykimit sillet një njeri para All-llahut dhe i jepet libri i punëve të veta dhe nuk i sheh aty veprat e mira.”* Ai do të thotë: *“O Zoti im, ky nuk është libri im, sepse unë nuk shoh në të punët e mira që kam bërë?!”* Atij i thuhet: *“Vërtet, Zoti yt nuk humbet askënd dhe nuk harron, por veprat e tua të mira janë fshirë sepse ti ke përgojuar njerëzit.”* Pastaj vjen një tjetër dhe i jepet libri i punëve të veta, i cili sheh shumë vepra të mira. Ai thotë: *“O Zoti im, ky nuk është libri i punëve të mia! Unë nuk i kam bërë këto.”* Atij i thuhet: *“Për shkak se filani të ka përgojuar, të mirat e tij t’i kemi dhënë ty.”* (*“Biharul Anvar”*; vëll. 75, kreu 66, hadithi /53).

Në disa histori përmendet se një njeriu i thanë që aksh njeri e kishte përgojuar. Ai buzëqeshi dhe urdhëroi që atij t’i dërgohej ëmbëlsirë, dhe t’i thuhej: Kjo ëmbëlsirë është shpërblim për atë që ke thënë për mua.

Përbledhje

Përgojim do të thotë: përmendja e të metave dhe të këqijave të njerëzve pas shpine kur nuk janë aty. Islami e konsideron përgojimin mësymje mbi dinjitetin e myslimanit dhe okupim të të shenjtave të tij. Ai është faktor i përhapjes së poshtërsive në shoqërinë islame. Përgojimi është prej mëkateve të mëdha, njësoj si kamata dhe (zinaja) imoraliteti.

Pyetje

- 1- Çështë përgojimi?
- 2- Përmendni dy prej kushteve të përgojimit.
- 3- Si e paraqet Kur'ani përgojimin? Përse e paraqet të tillë?
- 4- Përse Profeti Muhammed (s.a.s.) e ka bërë detyrë mbrojtjen e dinjitetit të besimtarit?

Mësimi 25

Përgojimi (2)

Shkaqet e përgojimit

Në mësimin e kaluar u njohëm me veprën e shëmtuar të përgojimit. U tha se ai është prej mëkateve të mëdha (të pafalshme) dhe se ka ndikime shkatërruese për jetën shoqërore dhe se përgojuesi do të ndëshkohet rëndë në jetën e përjetshme. Në këtë mësim do të flitet për shkaqët e përgojimit. Duke ditur shkaqet zbulojmë mënyrat për t’u larguar prej tij dhe për të treguar kujdes në marrëdhëniet tona me të tjerët. Dijetarët e moralit kanë përmendur disa shkaqe të kësaj sëmundje të rrezikshme. Ndër to janë:

Largimi i mundimit shpirtëror

Disa njerëz përpiqen të zbulojnë të metat e të këqijat e të tjerëve për të shëruar të metat që ai mbart në veten e vet. Përgojuesi vuan nga qortimet e ndërgjegjes. Por, në

vend që ai të shërojë veten e vet ai drejtohet kah gjurmimet: kërkon të meta tek të tjerët e i përhap më pas ato. Këtë ai e bën që të frymëzojë veten e vet: se ka edhe të tjerë si unë, pra me të meta e të këqija. Vërtet, përgojuesi është njeri i goditur nga sëmundje morale: kur përmend të këqijat e të tjerëve, ai i shton vetes së vet një të keqe tjetër dhe tek mëkatet e tij shton edhe mëkat tjetër.

Vetëpëlqimi

Për të ngritur pozitën e tyre, disa njerëz përgojnë e poshtërojnë të tjerët. Përgojuesi, ngre veten e tij e, sipas tij ai është i lartë, ai nuk bën siç bëjnë të tjerët! Ky njeri i sëmurë mendon se të tjerët nuk ia njohin përparësitë dhe i pëlqen vetëm vetja e tij.

Tallja dhe përqeshja

Në shumicën e bisedave ku ka përgojim, qëllimi është të tallet dhe të përqeshet tjetri. Në mësimin e njëzeteshtatë këtë do shtjellojmë më gjerë.

Smira

Prej shkaqeve të përgojimit është edhe smira. Ka njerëz që ndiejnë se kanë një të metë dhe janë të dobët në personalitetin e tyre. Por është për të të ardhur keq se njerëz të tillë nuk përpiqen që të largojnë të metat që kanë dhe të forcojnë personalitetin e tyre: ndienjat e tyre i shtojnë te smira ndaj të tjerëve prandaj përgojnë të metat e të tjerëve. Madje ata kërkojnë të gjejnë të metat tek të tjerët dhe i përgojnë me qëllim që t'i ulin pozitën e tyre në mesin e njerëzve.

Përngjasimi me të tjerët

Nëpër ceremoni a festa njerëzit tërheqin njëri-tjetrin. Në këto vende disa lavdërojnë një person duke përmendur punët e mira të tij; disa të tjerë përmendin të metat dhe të këqijat e një personi tjetër. Ata mendojnë se kjo duhet të bëhet, sepse nëse nuk veprojnë kështu, ata do të kujtojnë se njerëzit nuk ua vënë veshin e as nuk interesohen për ta. Duke qenë të pavëmëndshëm për këtë vepër ata harrojnë që kalimi i kufijve në bisedë dhe në përgojim është e ndaluar. Prandaj duhet që myslimani mos tu përngjasojë njerëzve me biseda përgojimi. Në Kur'anin famëlartë thuhet se banorët e Xhennetit pyesin banorët e Zjarrit për shkakun e përfundimit të tyre në zjarr. Ata përgjigjen: ***“Ata që janë në Xhennete i bëjnë pyetje njëri-tjetrit, përkitazi me kriminelët (e u thonë): “Ç’ka ju solli ju në Sakar”? Ata thonë: Nuk kemi qenë prej atyre që faleshin (që falnin namaz), nuk kemi qenë nga ata që ushqenin të varfrit; dhe përzheshim me të tjerët me punë të kota.”*** (Surja “Muddethir”, 40- 45).

Paraprita

Kur një njeri mendon se një tjetër do t'i përmendë të metat e tij para një tjetri a para të tjerëve, për t'ia ndërprerë bisedën, ai e përgojon para tjerëve përpara se ai ta përgojë.

Të dukurit për habi

Disa njerëz shfaqin habinë e tyre për një person duke thënë: Nuk e besoj që ai bën këtë mëkat. Është e qartë se me këtë veprim ai kërkon poshtërimin e atij personi për dy shkaqe:

I pari: Ai ka mundësi t'ia përmendë emrin tjetrit.

Së dyti: Edhe pse ai habitet me veprën e tij, ai e përgojon nëpërmjet habitësë.

Shtirja për keqardhje

Përsëri kemi të bëjmë me përgojim, sepse, kur përgojusi shtiret për keqardhje ndaj një personi për mëkatin që ka bërë, kërkon ta ulë tjetrin në sy të tjerëve.

Rastet kur lejohet përgojimi

Megjithëse përgojimi është prej mëkateve të mëdha, ka raste kur ky lejohet. Ato raste janë si vijon:

1- Ankesa për padrejtësi

Kur ankohesh për padrejtësi, do të thuash veprimet a veprat e tjetrit. All-llahu (xh.sh.) thotë: ***“All-llahu nuk do që të thuhet shprehjet e këqija përveç (publikimit) të atij që i është bërë padrejtësi. All-llahu dëgjon e di.”*** (Surja “Nisa”: 148).

All-llahu (xh.sh.) nuk e pëlqen të thuhet të këqijat, por, kur njeriu ballafaqohet me padrejtësi, atëherë vlera e drejtësisë është shumë më e lartë sesa përgojimi i të padrejtësive edhe nëse ai është mysliman. Duhet të zmpripsim padrejtësinë, prandaj duhet folur për atë.

2- Udhëzimi dhe këshillimi

Kur këshillojmë a udhëzojmë duhet që njeriu t'i përmendë disa të meta; p.sh, kur duam të martohemi me dikë, do të pyesim për ta njohur tjetrin (mashkull ose femër qoftë). Ky “përgojim” lejohet, sepse interesi shoqëror është më i rëndësishëm se interesi vetjak.

3- Përkujdesja

Kur një person a një grup personash dëshirojnë të prishin imazhin moral të shoqërisë, atëherë ne duhet t'i bëjmë të njohura qëllimet dhe të metat e tyre. Ky veprim nuk quhet përgojim. Profeti Muhammed (s.a.s.) ka thënë: ***“A e kundërshtoni përmendjen e të devijuarit me qëllim që të mos e njohin njerëzit?! Përmendëni atë dhe veprat e tij, që njerëzit të kenë kujdes nga ai.”*** (“Biharil Anwar”; vëll. 75, kreu 66, hadithi / 1).

4- Parandalimi i veprave të këqija.

Lejohet dhe është detyrë e çdo myslimani që të vërë në dijeni institucionet përkatëse e përgjegjëse për një vepër të keqe. Kjo ndihmon që të pastrohet shoqëria prej fesadit.

5- Hedhja poshtë dhe pranimi.

Është një mënyrë e vlerësimit e cila mund të krahasohet me vërtetimin e anasjelltë. Në disa raste, siç është transmetimi i haditheve apo dëshmitë në gjykata, etj, duhet të vërtetohet sinqeriteti dhe besnikëria e transmetuesit a e dëshmitarit, duke verifikuar vetitë e tyre psikologjike e morale. Nëse duam të nxjerrim në pah vetitë e transmetuesit apo të dëshmitarit, kjo nuk do të thotë se i përgojmë ata, sepse në të tilla raste, verifikimi është i lejuar me qëllim që të realizohet drejtësia.

6- Nofka (llagapi)

Është e njohur se disa njerëz njihen me nofkë (llagape). Kur një personi i përmendet emri i tij ai nuk njihet. Por nëse përmendet llagapi i tij, si p.sh., topall, i verbër, sybardhë etj, atë e njohin menjëherë. Në islam ky veprim nuk lejohet, është haram, por meqenëse ky person njihet vetëm me këtë llagap, nëse thirret me të ky nuk quhet përgojim.

7- Bidadçijte

Përfolja e bidadçinjve, të cilët duan mashtrimin e njerëzve dhe devijimin e tyre nga rruga e drejtë është detyrë e çdo myslimani. Ky veprim nuk quhet përgojim, sepse bidadçinjte kanë për qëllim shkatërrimin e fesë dhe heshtja ndaj tyre është haram (e ndaluar).

8-I shthururi

Është i lejueshëm përgojimi i tyre që veprojnë haptazi vepra të pa pëlqyeshme dhe të pa hijshme. Profeti Muhammed (s.a.s) ka thënë: ***“Tre njerëz lejohen të përgojohen: imami i padrejtë, i shthururi, (i njohur për shthurje) dhe bidadçi i cili fton njerëzit në bidatet e tij.”*** (“Derul Menthuri”; vëll. 6, f. 97).

Dëgjimi i përgojimit

S’ka dyshim se përgojimi i njerëzve është vepër e shëmtuar dhe për këtë folëm gjërë. Ka edhe një vepër tjetër, e cila është e shumtuar njësoj si përgojimi dhe kjo vepër është ta dëgjosh përgojimin me vëmendje.

Profeti Muhammed (s.a.s) ka thënë: ***“Ai që dëgjon përgojimin është prej përgojuesve.”*** (“Biharul Anvar”; vëll. 75, kreu 66, hadithi / 1).

Imam Sadiku (a.s.) ka thënë: ***“Përgojimi është kufër. Ai që e dëgjon atë dhe ai që e pranon atë janë ortakë.”*** (“El-Mustedrek”; vëll. 9, kreu 136, hadithi / 10462).

Sheriati islam na mëson që ta kundërshtojmë përgojimin dhe ta mbrojmë dinjitetin e besimtarit në biseda kur e përgojmë atë. Transmetohet se Profeti Muhammed

(s.a.s.) ka thënë: **“Atij, që kundërshton përgojimin që dëgjon për vëllanë e tij në një bisedë, All-llahu do t’i largojë një mijë porta të sherrit në dynja dhe në Ahiret.”** (“Biharul Anvar”; vëll. 76, kreu 67, hadithi /30). Nëse një person nuk mund ta bëjë këtë, atëherë është i detyrueshëm që të largohet nga tubimi, që mos të jetë prej dëgjuesve të përgojimit; përndryshe, do të jetë ortak i tyre në mëkat.

Përmbledhje

- Shkaqet kryesore të përgojimit janë: vetëpëlqimi, tallja me të tjerët, përngjasimi me biseduesit, nënvlefsimi i njerëzve dhe përpjekja për largimin e mundimit shpirtëror.

- Këshillimi, udhëzimi, tërheqja e vëmendjes, kundërshtimi i veprave të këqija dhe çdo gjë që bëhet për largimin e fesadit në shoqëri nuk konsiderohet përgojim, sepse interesi shoqëror është më parësor sesa interesi vetjak.

- Dëgjimi i përgojimit është haram (i ndaluar). Dëgjimi është vepër e shumtuar njësoj si vetë përgojimi.

Pyetje

- 1- Sqaro shkurtimisht disa shkaqe të përgojimit.
- 2- Përse lejohet përgojimi kur bëhet padrejtësi dhe kërkohet drejtësi?
- 3- Përse duhet ta shprehim zemërimin ndaj bidatçijve dhe devijuesve nga feja?

Mësimi 26

SHPIFJA DHE PARAGJYKIMI PËR TË KEQ

Shpifja është prej veprimeve të shumtuara në marrëdhëniet shoqërore. Në mësimin e kaluar mësuam se përgojimi ishte përmendja e të metave të njerëzve. Shpifje do të thotë, t’i përmendësh dhe t’i veshësh një tjetri ato cilësi që nuk i ka ai. Atëhere, kuptohet se shpifja është mëkat më i madh se përgojimi dhe për shpifjen do të ketë ndëshkim të rëndë në Ditën e Gjykimit. Kur’ani Famëlartë thotë: **“Kush bën ndonjë gabim ose mëkat e pastaj atë ia hedh një të pafajshmi, ngarkohet me një shpifje e një mëkat të hapët.”** (Surja “Nisa”: 112).

Profeti Muhammed (s.a.s.) ka thënë: **“Cilindo që shpif për besimtarin a për besimtarene ose thotë ato që nuk i ka, All-llahu do ta vendosë mbi një kodër zjarri në Ditën e Gjykimit, ku do të qëndrojë derisa të dalin prej tij ato që ka thënë për besimtarin.”** (“Biharul Anvar”; vëll. 75, kreu 62, hadithi/5).

Imam Sadiku (a.s.) ka thënë: **“Besimtarit që shpif për vëllanë e tij, do t’i shkrihet besimi njësoj si shkrihet kripa në ujë.”** (“Biharul Anvar”; vëll. 75, kreu 62, hadithi/19).

Pa dyshim, besimi nuk e pranon këtë veprim të njeriut, sepse ai që është besimtar i vërtetë, nuk shpif për vëllanë e tij.

Shpifjet mund të jenë:

- 1- Kur nuk sigurohesh se diçka e keqe është e vërtetë.
- 2- Kur ke bindje se diçka e keqe nuk ekziston.
- 3- Kur të këqijat e tua ua vesh të tjerëve.

Edhe pse të tria këto grupe akuzimesh janë të shumtuara, shëmtimi ndryshon në to. Shpifje do të thotë okupim i shenjtërive të besimtarit, dinjitetit dhe personalitetit e tij. Vërtet, Sheriati ka marrë përsipër mbrojtjen dhe sigurinë e myslimanit. S'ka dyshim se ndjenja e sigurisë mundëson përsosurinë për të gjithë pjestarët e shoqërisë. Kur në individët e shoqërisë përhapet shpifja, atëherë mundësia e përsosurisë do të jetë e paktë dhe si pasojë do të kemi një kthim prapa të shoqërisë nga ana morale. Përderisa Sheriati islam i ndalon akuzat dhe i dënon shpifjet, ai i nxit myslimanët që të kujdesen për veten e tyre në rast akuzash dhe trillimesh.

Transmetohet se profeti Muhammed (s.a.s.) ka thënë: **“Njeriu më meritues për akuzime është ai që shoqërohet me akuzuesit.”** (“Biharul Anvar”; vëll. 75, kreu 46, hadithi/ 3).

Imam Aliu (a.s.) ka thënë: **“Ai që rri me të akuzuarit, të mos fajsojë tjetërkënd përveçse vetveten.”** (“Biharul Anvar”; vëll. 72, f. 91).

Imam Sadiku (a.s.) transemeton: **“Babai më ka thënë: “O biri im, ai që shoqërohet me shokun e keq, nuk është i mbrojtur, ai që hyn tek të këqijat, akuzohet dhe ai që nuk sundon të folurin (gjuhën) e tij, pendohet.”** (“Biharul Anvar”; vëll. 75, kreu 46, hadithi/ 1).

Të menduarit keq për të tjerët

Prej veprimeve të këqija e të shumtuara në marrëdhëniet shoqërore është edhe të menduarit keq për dikë domethënë; të mendosh për atë diçka që nuk e ka tjetri. Përveç që është veprim i shumtuar, është mëkat dhe burim për mëkate të tjera.

All-llahu (xh.sh.) në Kur'an thotë: **“O ju që keni besuar, largohuni prej dyshimeve të shumta, meqë disa dyshime janë mëkat dhe mos hulumtoni për zbulimin e të metave të njëri-tjetrit...”** (Surja “Huxburat”, 12).

Ajeti i mësipërm tregon se disa paragjykime janë të pabaza dhe ato që nuk janë të vërteta, janë mëkate. Mendimi për të keq është veprim i shumtuar sepse çon në përgojim: njeriu shtyhet të spiunojë dhe të vërtetësojë ato që i mendonte, që i paragjykonte dhe prej mjeteve të spiunllëkut është përgojimi. Përballë të menduarit të keq morali islam ka rregullën: “realiteti është saktësia” që do të thotë se themeli në marrëdhëniet shoqërore është të menduarit mirë për të tjerët.

Imam Aliu (a.s.) ka thënë: **“Kij mendim të mirë për vëllanë tënd, derisa të të qartësohet e kundërta. Nëse vëllai yt thotë diçka mos mendo keq për ato që thotë kur ti gjen diçka të mirë në atë thënie.”**

Pasojat e të menduarit për të keq

Në transmetimet islame gjejmë mjaft thënie të cilat tregojnë për pasojat e të menduarit keq. Ndër ato përmendim:

Imam Aliu (a.s.) ka thënë: **“Ai që mendon keq ka frikë nga çdo njeri.”** (“Gurerul Hikem”; vëll. 5, f.442). Kjo do të thotë se njeriu që mendon keq, nuk do të ketë sukses në marrëdhëniet me të tjerët sepse nuk mund të shtrojë dorën e shoqërisë e të vëllazërisë; ai do të qëndrojë i vetëm dhe në konflikt me vesveset dhe fantazitë e tij.

Imam Aliu (a.s.) ka thënë: **“Të menduarit keq i prish punët dhe sjell të këqija.”** (“Gureru Hikem”; vëll. 4, f.132).

Përkundrazi, besnikëria e ndërsjelltë dhe të menduarit për mirë janë faktorë të suksesit në shoqëri, ndërsa humbja e besimit dhe të menduarit keq në mesin e individëve të shoqërisë çojnë në dështimin e planeve shoqërore.

Imam Aliu (a.s.) ka thënë gjithashtu, të menduarit për keq vret pastërtinë, paqen dhe miqësinë mos shokëve. Ai ka thënë: **“Ai që e sundon të menduarit keq, nuk do të ketë mirësi me shokun e vet.”** (“Gurerul Hikem”; vëll. 5, f. 406).

Të menduarit keq ka ndikime negative në adhurimet që kryen njeriu. Për këtë imam Aliu (a.s.) ka thënë: **“Mjerë ti që mendon keq, sepse ti i bën të pa vlefshme adhurimet...”** (“Gurerul Hikem”; vëll. 6, f. 362).

Krahas këtyre transmetimeve ka transmetime të tjera, të cilat e lavdërojnë të menduarit për mirë dhe nxisin për të.

Transmetohet se Profeti Muhammed (s.a.s.) ka thënë: **“Mendoni mirë për vëllezërit tuaj, që të fitoni prej tij pastërtinë e zemrës dhe kthjelltësinë e natyrës.”** (“Biharul Anvar”).

Imam Aliu (a.s.) ka thënë: **“Të menduarit për mirë është më i përsosur se aroma dhe betimi.”** (“Gurerul Hikem”; vëll 3, f. 384).

Dhe: **“Të menduarit për mirë është qetësi për zemrat dhe mbarëvajtje për fenë.”** (“Gurerul Hikem”; vëll. 3, f.384).

Kjo do të thotë që gjendja shpirtërore e atij njeriu që mendon për mirë për vëllezërit e tij do të jetë e mirë dhe do të jetë i shëruar nga sëmundjet shpirtërore.

Imam Aliu (a.s.) ka thënë: **“Mendimi për të mirë të lehtëson vështirësitë dhe të shpëton prej mëkateve.”** (“Gurerul Hikem”; vëll. 5, f. 375).

Ky hadith tregon se mendimi për të mirë lë ndikime të kënaqshme te njeriu, të cilat i sjellin njeriut dashurinë dhe mirësinë.

Të menduarit për të mirë është fryt i besimit të pastër dhe i shpirtit të shëndoshë.

Imam Sadiku (a.s.) ka thënë: **“Të menduarit për mirë e ka burimin tek besimi i pastër i njeriut dhe te shpirti i tij i shëndoshë.”** (“Biharul Anvar”; vëll. 75, kreu 72, hadithi/ 12).

S'ka dyshim se shpirti i shëndoshë, zemra e pastër dhe natyra e kthjellët, të gjitha pasqyrojnë shëndoshje psikologjike e shpirtërore. Nga këtu del në pah se të menduarit për mirë i forcojnë edhe më shumë marrëdhëniet vëllazërore mes individëve të shoqërisë. E kundërta ndodh me të menduarit për keq që çon në përhapjen e urrejtjes dhe të smirës në mesin e individëve të shoqërisë.

Nga të gjitha ato që u përmend më lart na bëhet e qartë se të menduarit për mirë është burimi dhe etaloni në marrëdhëniet shoqërore. Edhe pse është i tillë, për atë ka kushte dhe kufinj, nëse tejkalohe, të menduarit për mirë nuk janë veti e lavdërueshme. Në disa transmetime islame shoqërohen më së mirë këto kufinj.

Përmbledhje

Shpifja është veshja e të metave një njeriu.

Shpifja është prej mëkateve të mëdha në sheriati Islam.

-Themeli i marrëdhënieve shoqërore është të menduarit mire. Të menduarit për keq është veprim i shumtuar.

-Të menduarit për mire për të tjerët shton dashurinë mes individëve të shoqërisë. E kundërta ndodh kur mendohet për të keq: acarohen marrëdhëniet shoqërore. Nëse duhet të sundojë drejtësia dhe e mira në shoqëri, atëherë nuk është e lejueshme për myslimanin që të mendojë keq për të tjerët.

Pyetje

- 1- Ç'është shpifja sipas atyre që mësuat nga ajetet e hadithet?
- 2- Numëroni llojet e shpifjes.
- 3- Ç'është thotë: “realiteti është saktësia?”
- 4- Shpjegoni shkurtimisht ndikimet që sjell të menduarit për të keq.
- 5- A duhet që njeriu të mendojë gjithnjë mirë për të tjerët?

Mësimi 27

THASHETHEMJA DHE TALLJA

Thashethemja është sëmundje shpirtërore dhe veprim i shumtuar e me pasoja të këqija në marrëdhëniet shoqërore. Prej ndikimeve negative të thashethemes është ligësia dhe mosbesimi mes individëve të shoqërisë. Po ashtu kjo cilësi çon në shfaqjen e urrejtjes dhe armiqësisë mes njerëzve. Thashethemja është ndër faktorët që çon në përçarjen e shoqërisë. Sheriati islam e kundërshton me të gjitha forcat këtë sëmundje të rrezikshme shpirtërore. Për këtë kemi shumë ajete kur'anore dhe hadithe. Dijetarët islamë e kanë quajtur thashethemen prej mëkateve të mëdha.

Thashethemja është: kur një njeri flet për një tjetër me fjalë fyese dhe të këqija, pastaj një tjetër luan rolin e thashethemit duke ia transmetuar ato fjalë personit, për të cilin u fol. Thashethemi është njeri i sëmurë. Ai nuk çon kurrë fjalë të mira, por vetëm fjalë të cilat shkaktojnë urrejtje, armiqësi e më pas shkatërrim. Përhapja e armiqësisë dhe e urrejtjes mes shokëve dhe vëllezërve në fe është fitneh e madhe, për të cilën Kur'ani thotë për këtë: **“Provokimi (fitneja) është më i rëndë se vrasja.”** (Surja “Bekare”: 191).

Dhe: **“... e provokimi (kundër myslimanëve) është më i madh se mbytja** (Surja “Bekare”: 217).

Dhe: **“Mjerë për atë që fyen dhe përqesh (njerëzit)”** (Surja “Humeze”: 1).

All-llahu (xh.sh.) i thotë Profetit Muhammed (s.a.s.): **“Mos e respekto atë që betohet shumë dhe është i poshtër, që është përgojues e çon fjalë ndër njerëz (thashethemi)”** (Surja “Kalem”: 10-11). Ajetet e fundit tregojnë se thashethemi është i ulët moralisht dhe nuk duhet të respektohet. Profeti Muhammed (s.a.s.) u ka thënë shokëve të tij: **“A t’ju them cilët janë të këqijtë tuaj?”** Ata thanë: **“Po, o i Dërguari i All-llahut.”** Ai tha: **“Ata që flasin keq për njerëzit, ata që ndajnë të dashurit dhe zbuluesit e të këqijave.”** (“Biharul Anvar”; vëll. 75, kreu 67, hadithi/17).

Dhe: **“Vërtet, më të këqijtë ndër ju tek All-llahu (xh.sh.) janë përgojuesit, e ndarësit mes të dashurve dhe...”** (“Kenzul Ummal”, vëll. 3, f. 15, hadithi/5215).

Dhe: **“S’ka dyshim se thashethemja dhe urrejtja janë në Zjarr. Ato nuk bashkohen në zemrën e myslimanit.”** (“Kenzul Ummal”; vëll. 16, f. 23, hadithi/43768).

Dhe: **“Thashethemi nuk hyn në Xhennet.”** (“Biharul Anvar”; vëll. 68, kreu 15, hadithi/21).

Imam Aliu (a.s.) ka thënë: **“Mjerë ti dhe veprimi i thashethemes, sepse ajo mbjell urrejtje e armiqësi dhe të largon nga All-llahu dhe nga njerëzit.”** (“Gurerul Hikem”; vëll. 2, f. 269).

Bashkëpunimi me thashethemin

Që të dështojnë përpjekjet e ndyta të thashethemexhiut për të përçarë vëllezërit dhe shokët, ne duhet të veprojmë si vijon:

1- Të mos shoqërohemi me të sepse ai është i shturur, i papërgjegjshëm. All-llahu (xh.sh.) thotë: **“O ju që keni besuar, nëse ndonjë i papërgjegjshëm ju sjell ndonjë lajm, ju shqyrtojeni mirë, që të mos e goditni ndonjë popull pa e ditur realitetin, e pastaj të pendoheni për atë që keni bërë.”** (Surja “Huxburat”: 6).

2-Ta ndalojmë atë nga kjo vepër e përbuzur dhe e shumtuar, sepse thashethemja është e keqe dhe All-llahu na urdhëron që ta ndalojmë veprimin e të këqijave kur thotë: **“O djali im, fale namazin, urdhëro për punë të mira e ndalo nga të këqijat...”** (Surja “Lukman”: 17).

3- Ta konsiderojmë thashethemin armik sepse, ai është armik i All-llahut.

4- Të largohemi nga thashethemja, sepse është të menduar për keq për dikë e për këtë All-llahu (xh.sh.) urdhëron që të largohemi: **“O ju që keni besuar, largohuni prej dyshimeve të shumta, meqë disa dyshime janë mëkat...”** (Surja “Huxburat”: 12).

5-Thashethemja të shtyn në spiunllëk për atë që foli për të keq e All-llahu na ndalon nga spiunllëku kur thotë: **“..dhe mos hulumtoni për zbulimin e të metave të njeri tjetrit...”** (Surja “Huxburat”: 12).

6- Të mos përsëritet veprimi i thashethemes duke çuar fjalët tek të tjerët dhe të këtë vepër mos ia pëlqejmë as vetës.

Në jetëshkrimin e një dijetari thuhet se kur ai u kthye nga udhëtimi, një shok i tij shkoi dhe e takoi. Në bisedën që bënë, shoku i përcolli ç’kishin thënë për të, (pra, tha për atë thashetheme). Dijetari i zemëruar i tha: “Pas kësaj ndarjeje ti më solle tri tradhti:

E para: Ti më bërë të mendoj keq për atë njeriun dhe ke krijuar armiqësi mes meje dhe atij.

E dyta: Ti më bërë që të shqetësohem për atë që the, kur më parë isha i qetë.

E treta: Ti më zhveshe nga besimi ndaj teje, sepse unë tani të akuzoj për tradhti.

Është detyrë që thashethemi të kundërshtohet dhe mos u vihet veshi fjalëve të tij. Ky qëndrim ndaj thashethemexhiut bën që:

1- thashethemi të pendohet për veprat e tij.

2- ai nuk do ta përsërisë më atë vepër.

3- dashuria mes individëve të shoqërisë të jetë e vazhdueshme.

Muhammed ibn Fadijl, (një prej shokëve të imam Musa Kadhim (a.s.)), një ditë iu ankua imamit duke thënë: “ U bëfsha flijim për ty! Një njeri prej vëllezërve të mi. . . .

Transmetohet se një burrë shkoi tek imam Aliu për t'i thënë se çfarë thashteme kishte thënë një tjetër për imamin. Imam Aliu i thotë: **“O ti! Do të të pyesim për atë që the. Nëse je i vërtetë, jemi të zemëruar me ty; nëse je gënjeshtar, do të të dënojmë, po të duash që të të falim ty ne të falim.”** Burri i tha: **“Më fal o prijës i besimtarëve.”** (“*Biharul Anvar*”; vëll. 75, kreu 67, hadithi/19).

Të tallurit dhe të përqeshurit

Të tallurit dhe të përqeshurit e një njeriu është haram (e ndaluar), sepse konsiderohet fyerje e dinjitetit dhe e personalitetit. S'ka dyshim se njeriu në Sheriatin islam është i nderuar, plotësisht. Prandaj, nuk ka të drejtë askush që ta fyejë, ta poshtërojë, etj. All-llahu (xh.sh.) thotë: **“Vërtet, krenaria i takon All-llahut, të dërguarit të Tij dhe besimtarëve..”** (Surja “*Munafikun*”: 8).

Dhe: **“Ndërsa, ata që besuan dhe bënë vepra të mira, të tillët janë krijesa të dobishme.”** (Surja “*Bejjinetu*”:7).

Profeti Muhammed (s.a.s.) ka thënë: All-llahu (xh.sh.) ka thënë: **“Pafsha Madhërinë Time! Unë nuk kam krijuar krijesë më të dashur se sa rob i besimtar.”** (“*Biharul Anvar*”; vëll. 71, f. 63, hadithi/75).

Xhabir Abdullah El- Ensarij, shoku i afërt i Profetit, ka transmetuar se profeti Muhammed (s.a.s.) shikoi një ditë Qaben dhe tha: **“Sa e famshme je, sa e madhe është shejnjëria jote tek All-llahu. Beto hem në All-llahun! Besimtari është më i nderuar tek All-llahu sesa ti, sepse, All-llahu ka ndaluar për ty vetëm një ndërsa për besimtarët ka ndaluar tri; pasurinë e tij, gjakderdhjen e tij dhe të mos mendojë keq për Atë.”** (“*Biharul Anvar*”; vëll. 67, kreu 1, hadithi/ 39).

Transmetohet se imam Bakiri (a.s.) ka thënë: **“All-llahu (xh.sh.) i ka dhënë besimtarit tri veti: “Krenarinë ne jetë e në fe, shpëtimin në Ahiret dhe dashurinë e njerëzve për Atë.”** (“*Biharul Anvar*”; vëll. 68, kreu 15, hadithi/21).

Imam Sadiku (a.s.) ka thënë: **“Shenjësia e besimtarit është më e madhe se e Qabes.”**

Nëpërmjet këtyre ajeteve dhe haditheve që flasin rreth krenarisë së besimtarit, kuptohet më së miri se sa e shumtuar është ta përqeshësh dhe ta tallësh atë. All-llahu (xh.sh.) thotë: **“O ju që keni besuar, nuk bën të tallet një popull me një popull tjetër, meqë të përqeshurit mund të jenë më të mirë nga ata të cilët përqeshin dikë tjetër. E, as grate të mos i përqeshin gratë e tjera, sepse mund të ndodhë që grate e tjera të jenë më të mira se ato që përqeshin ...** (Surja “*Huxhurat*”: 11).

Përmbledhje

Tallja dhe përqeshja është veti dyfaqësie (hipokrizie). Për këtë Kur’ani Famëlartë thotë: **“E kur i takojnë ata që besuan thonë: “Ne kemi besuar!”, por kur veçohen me djajt (parinë) e vet u thonë: “Ne jemi me ju, ne vetëm jemi tallur (me besimtarët).”** (Surja “*Bekare*”: 14). Vërtet, ata që tallin dhe përqeshin besimtarët i pret ndëshkimi i rëndë në Ditën e Gjykimit. All-llahu (xh.sh.) thotë në Kur’an: **“Ata (dyfytirakët) që i përqeshin besimtarët, që me vullnetin e vet japin lëmoshë, i përqeshin edhe ata të**

cilët nuk kanë më shumë se ç'ka është e domosdoshme për jetesën e tyre, e njëkohësisht tallen me ta, All-llahu u dha shpërblimin e talljeve të tyre dënimin më të rëndë.” (Surja “Teube”: 79).

S'ka dyshim se përhapja e të metave, thashethemja dhe përçarja mes vëllezërve besimtarë janë vepra të shumtuara, mëkat i madh dhe mosbindje ndaj All-llahut (xh.sh). Vërtet, All-llahu (xh.sh.) nuk na lejon të veprojmë kështu. Njeriu besimtar gëzon krenarinë, dinjitetin dhe respektin e plotë.

Pyetje

- 1- Përse e ka ndaluar Islami thashethemen?
- 2- Cili duhet të jetë qëndrimi ynë ndaj thashethemit?
- 3- Cilat janë ndikimet që rrjedhin prej talljes dhe të përqeshurit?



Mësimi 28

SMIRA

Smira është cilësi më se e shumtuar dhe prej mëkateve të mëdha. Smira rol i shkatërron e marrëdhënieve shoqërore. Zilitari nuk është në gjëndje të zhvillohet dhe të përparojë në rrugën e përsosurisë njerëzore.

Në Kur'an përmendet smira e djallit për babanë tonë Ademin (a.s.) dhe All-llahu (xh.sh) e përjashtoi djallin nga mëshira e Tij. Smira e shtyu djallin në urrejtjen ndaj Ademit (a.s.) dhe bashkëshortes së tij. Ai i mashtroi ata dhe All-llahu i zbriti nga Xhenneti për të jetuar në tokë.

Kabili pati smirë për vëllanë e tij Habilin dhe pëshpëritjet e djallit e shtynë të vriste të vëllanë. Pra, smira ka qenë gjithmonë burim i urrejtjes dhe armiqësisë në historinë njerëzore.

Njohja e smirës

Smira do të thotë, keqdashje ndaj dikujt kur e shohim më mirë se veten goftë materialisht apo shpirtërisht. Smiraku gjithmonë përpiqet të përmbushë qëllimet e tij lakmitare. Smira është katër llojesh:

Lloji i parë: smiraku uron që të mos i ketë të mirat që ka dikush tjetër por nuk i uron për veten e vet ato të mira.

Lloji dytë: smiraku i uron që të mos i ketë tjetri të mirat që ka dhe lakmon që t'i ketë. Lloji i tretë: smiraku lakmon që të ketë ato të mira që ka një tjetër dhe kur nuk i përmbushet lakmia uron që ato të mira t'i zhduken njeriut tjetër.

Lloji i katërt: Njeriu uron që t'i dhurohen po ato të mira që All-llahu ia ka dhuruar një tjetri. Lloji i katërt nuk quhet smirë dhe nuk është vepër e shumtuar. Ajo quhet (El-Gubtetu). *El- Gubtetu është e kundërta e smirës. Ajo është dëshirë e mirë. Ajo është cilësi e lavdëruar dhe e nxit njeriun për mbarëvajtje, për zhvillim dhe për në rrugën e mirësisë.*

Imam Sadiku (a.s.) ka thënë: **“Besimtari dëshiron mirësi për tjetrin dhe nuk ka smirë ndërsa dyfytiraku (hipokriti) ka smirë dhe nuk dëshiron mirësi për tjetrin”.** (“Biharul Anvar”; vëll. 73, kreu 131, hadithi/ 7).

Smira sipas e ajeteve të Kur'anit Famëlartë

Në Kur'an thuhet që e keqja e smirës ndodhet përkrah veprimeve shkatërruese të djallit. All-llahu (xh.sh.) thotë: **“ Edhe prej dëmit të smirëkeqit kur sipas smirës vepron”** (Surja “Felek”: 5).

Dhe: **“Mos lakmoni në atë, që All-llahu gradoi disa nga ju mbi disa të tjerë...”** (Surja “Nisa”: 32).

All-llahu (xh.sh.) i ka thënë të Dërguait të Tij, Muhammedit (s.a.s.): **“Dhe mos ia ngul sytë bukurisë së kësaj jete, me të cilën i bëmë të kënaqen disa prej tyre (mosbesimtarët), e për t'i sprovuar me të, sepse shpërblimi i Zotit tënd është më i mirë dhe më i përjetshëm.”** (Surja “Ta Ha”: 131)

Dhe: **“E ty mos të të shkojnë kurrsesi sytë në atë me të cilën Ne i pajisëm disa prej tyre, as mos u brengos për ta (pse nuk besuan), kurse ndaj besimtarëve ji i përulur e i butë.”** (Surja “Hixhr”: 88).

Në një ajet të Kur'anit shohim përpjekjet e ehli kitabit për t'i larguar myslimanët nga feja e tyre për shkak të ndienjës së smirës ndaj jetës së përkryer dhe moralit të përkryer të myslimanëve. All-llahu (xh.sh.) thotë: **“Shumë ithtarë të Librit (jabudinj, krishterë), edhe pasi u është bërë e qartë e Vërteta, nga vetë zilia e tyre dëshiruan që pas besimit tuaj t'iu kthejnë në mosbesimtarë. Pra ju largohuni prej tyre derisa All-llahu ta sjellë urdhrin e vet. All-llahu bën gjithçka.”** (Surja “Bekare”: 109).

Smira dhe smiraku në hadithe

Kumtohet se Profeti (s.a.s.) ka thënë: All-llahu (xh.sh.) i tha Musait, birit të Imranit: **“Mos mbart smirë për njerëzit për ato që Unë u kam dhënë atyre prej mirësive të Mia.”** (“Biharul Anvar”; vëll. 73, kreu 131, hadithi/ 1).

Profeti (s.a.s.) u ka thënë shokëve të tij: **“Mos u bëni armiq të mirave të All-llahut.”** I thanë: **“Kush bëhet armik i tyre?”** Ai tha: **“Ata që mbartin smirën.”** (“Biharil Anvar”; vëll. 73, kreu 131, hadithi/2).

Imam Aliu (a.s.) ka thënë: **“Smira është burgim i shpirtit.”** (“Gurerul Hikem”; vëll. 1, f. 100). Pra, shpirti i njeriut që është i goditur me sëmundjen e smirës, nuk e njeh lirinë. Imam Aliu ka thënë, gjithashtu: **“Smira është kreu i të këqijave.”** (“Gurerul Hikem”; vëll. 4, f. 50).

Dhe: **“Fryti i smirës është vuajtje në dynja dhe në Ahiret.”** (“El-Mustedrek”; vëll. 12, kreu 55, hadithi /13401).

Dhe: **“Ai që i shmanget smirës, do të jetë i dashur te njerëzit.”** (“Biharul Anvar”; vëll. 77, kreu 9, hadithi / 1).

Dhe: **“Smiraku gjen shumë vështirësi dhe mbart shumë të këqija.”** (“El-Mustedrek”; vëll. 12, kreu 55, hadithi / 13402).

Dhe: **“Smiraku nuk udhëheq.”** (“Biharul Anvar”; vëll. 73 kreu 131, hadithi/4).

Dhe: **“Smirakun e shëron vetëm zhdueja e të mirave.”** (“Biharul Anvar”; vëll. 12, kreu 55, hadithi / 13 401).

Dhe: **“Smiraku gëzohet me sherr dhe hidhërohet me gëzim.”** (“Mustedrek”; vëll. 12, f.55, hadithi / 13401).

Dhe: **“Smiraku ka mendimin, se zhdueja e të mirës ndaj tij bën smirë është mirësi e tij (smirakut).”** (“El-Mustedrek”; vëll. 12, f. 55, hadithi / 13401).

Dhe: **“Smiraku tregon dashurinë e tij në fjalët që thotë dhe fsheh inatin e tij në veprat që bën. Ai ka emrin e mikut dhe cilësinë e armikut.”** (“Gurerul Hikem”; vëll. 3, f. 253).

Dhe: **“Mos ki smirë, sepse smira e djeg besimin (imanin) njësoj siç djeg zjarri drutë.”** (“Biharul Anvar”; vëll. 77, kreu 2914).

Dhe: **“Smira shkrin besimin në zemër njësoj siç shkrin uji kripën.”** (“Mustedrek Vesail”; vëll. 12, f. 18).

Imam Sadiku (a.s.) ka thënë:

“Për kopracin nuk ka rehati dhe për smirakun nuk ka kënaqësi.” (“Biharul Anvar”; vëll. 77, kreu 10, hadithi / 13).

Dhe: **“Smiraku dëmton veten e tij para se të dëmtojë tjetrin, si ndodhi me djallin i cili nga smira i solli mallkimin vetes së tij ndërsa Ademit lartësim.”** (“Biharul Anvar”; vëll. 73, kreu 131, hadithi/ 23).

Dhe: **“Bazat e kufrit (mosbesimit) janë tri: El-hirsu, mendjemadhësia dhe smira.”** (“Biharul Anvar”; vëll 72, kreu 99, hadithi / 1).

Dhe: **“Zanafilla e smirës është prej verbërisë së zemrës e kundërshtimit të mirësive të All-llahut (xh.sh.) dhe që të dyja këto janë krahë të mosbesimit. Për shkak të smirës birit të Ademit i vijnë fatkeqësitë dhe prej saj shkon në humbje, nga e cila nuk shpëton kurrë.”** (“Biharul Anvar”; vëll. 73, kreu 131).

Dhe: **“Fatkeqësitë për fenë janë: Smira, vetëdashja, dhe mburrja.”** (“Biharul Anvar”; vëll. 73, kreu 131, hadithi / 5).

Profeti Muhammed (s.a.s.) ka thënë: **“Vërtet, ju ju ka goditur sëmundja që goditi popujt para jush dhe kjo sëmundje është smira. Ajo nuk qeth flokët, por qeth fenë.”** (“Biharul Anvar”; vëll. 73, kreu 131, hadithi/ 23).

Transmetohen nga imam Ali (a.s.) demet trupore që sjell smira:

“Smiraku është gjithmonë i sëmurë.” (“El-Mustedrek”; vëll. 12, kreu 55, hadithi / 13401).

Dhe: **“Smira shkatërron trupin.”** (“Gurerul Hikem”; vëll. 1, f. 241).

Dhe: **“Shëndeti i trupit është prej smirës së paktë.”** (“Biharul Anvar”; vëll. 73, kreu 141, hadithi / 28).

Shkaqet e smirës

Më lart u njohëm me smirën dhe ndikimet e saj negative në jetën e individit dhe të shoqërisë. Me qëllim që ta shërojmë këtë sëmundje të rrezikshme, ne duhet të njohim shkaqet e saj, sepse me njohjen e sëmundjes njihet edhe ilaçi për të.

Shtatë shkaqe ka për smirën:

- 1- **Shpirtligësia.** Ka shumë njerëz të cilët vuajnë nga poshtërsia për shkak të smirës që kanë për të tjerët. Ata gëzohen kur njerëzve u ndodh ndonjë fatkeqësi dhe hidhërohen kur njerëzit janë të gëzuar e të lumtur, pa marrë parasysh që kanë marrëdhënie me ta, qofshin këto marrëdhënie dashamirëse apo armiqësie. Të tillë njerëz vuajnë nga ligësia e nuk e duan mbarëvajtjen e shoqërisë.
- 2- **Armiqësia.** Armiqësia dhe urrejtja mes ziliqarit dhe dikujt tjetër janë pasojë e smirës. Nëse smiraku sheh se armikun e tij e godet ndonjë fatkeqësi a vështirësi, ai gëzohet dhe uron që t'i shtohen fatkeqësitë e vështirësitë. Nëse u ndodh e kundërta, pra nëse smiraku sheh mbarëvajtje të armikut të tij, ai hidhërohet dhe mbushet me lëndime..
- 3- **Dashuria për post dhe pasuri.** Vërtet, shumica e ziliqarëve e kanë lakmi pozitën dhe pasurinë dhe këtë e dëshirojnë vetëm për vetat e tyre. Nëse ziliqari sheh ndonjë konkures e ka zili atë. (P.sh. një tregtar të mbarësuar, etj), nuk e pëlqen këtë dhe i uron atij dështim.
- 4- **Konkurrenca.** Të gjithë jemi dëshmitarë dhe po shohim konkurrencën për të zënë postin më të lartë. Kur një person arrin këtë post, konkuresit e tij mbushen me smirë.
- 5- **Mendjemadhësia.** Njeri i goditur me këtë sëmundje shpirtërore nuk përmbahet kur sheh sukses tek tjetri, sepse, mendjemadhi dëshiron t'i shohë të tjerët nën veten e tij dhe të poshtëruar. Nëse mendjemadhi sheh sukses tek të tjerët, ai bëhet ziliqar dhe uron të dështojnë ata.
- 6- **Vetëdashja.** Vetëdashja ndryshon nga mendjemadhësia sepse vetëdashësi i frikësohet fyerjes. Nëse një tjetër është më i përparuar, ai ndihet i fyer në vetvete. Ndërsa mendjemadhi kërkon lartësim dhe nuk ia uron askujt tjetër lartësimin.
- 7- **Çudia.** Prej shkaqeve të smirës tek disa të smirë është se kur ata shohin se ndonjë personi i vijnë mirësi ata e kanë zili atë dhe çuditen nga kjo duke e quajtur poshtërsi për veten e tij dhe urojnë që ato mirësi ti zhduken atij!

Përmledhje

Smira është cilësi e ulët. Smirëziu përpiqet për t'ia zhdukur të mirat tjetrit. Smira ka ndikim shkatërrues për njeriun.

Pyetje

- 1- Ç'është smira?
- 2- Cilat janë llojet e smirës
- 3- Ç'është el-gubbetu?
- 4- Përse smira quhet vepër dyfytirësie?
- 5- Cilat janë ndikimet e smirës për besimin?
- 6- Shpjego shkurtimisht shkaqet e smirës.



Shoqata

Mësimi 29

Flladi

GËNJESHTRA

Gënjeshtra është një prej mëkateve më të mëdha dhe prej cilësive morale më të shumtuara e shkatërruese për marrëdhëniet shoqërore. S'ka dyshim se marrëdhëniet e çiltra njerëzore ngrihen mbi bazat e vërtetësisë. Kur nuk thotë të vërtetën, individi humbet vlerën e tij në shoqëri, uniteti shoqëror shkatërrohet dhe jeta shoqërore bëhet e vështirë dhe e skëterrë.

Kur'ani Famëlartë na flet për gënjeshtrën dhe e kundërshton atë. Po ashtu, edhe hadithet islame. Është për të të ardhur keq, që ka shumë njerëz që e ushtrojnë gënjeshtrën për të arritur synimet e tyre.

Gënjeshtra është prej sëmundjeve shoqërore të rrezikshme.

Përkufizimi i gënjeshtrës

Gënjeshtra është fjalë e thënë e pavërtetë ose të vepruarit në kundërshtim me të vërtetën.

Kur një njeri thotë diçka të kundërt me të vërtetën duke menduar se ka thënë të vërtetën, nuk është gënjeshtrë. Gënjeshtra mund të jetë thënie por edhe vepër: P.sh: një njeri shfaq një mënyrë të caktuar jetese me qëllim që t'u tregojë njerëzve se ai është i përkryer, por në të vërtetë nuk është i tillë. Kjo është gënjeshtrë, sepse është në kundërshtim me të vërtetën, me realitetin.

Gënjeshtra sipas ajeteve të Kur'anit

Ka shumë ajete që flasin për gënjeshtrën dhe gënjeshhtarët. Po përmendim disa:

“...pra largohuni nga ndytësitë e idhujve dhe largojuni fjalës shpifëse” (Surja “Haxh”: 30).

Dhe: *“Gënjeshtren e trillojnë vetëm ata që nuk i besojnë argumentet e All-llahut. Të tillët janë ata gënjeshtarët.” (Surja “Nabl”: 105).*

Dhe: *“... E, është e vërtetë se All-llahu nuk e udhëzon në rrugë të drejtë atë që është gënjeshtar dhe jobesimtar.” (Surja “Zumer”: ajeti 3).*

Dhe: *“..S’ka dyshim se All-llahu nuk e udhëzon në rrugë të drejtë atë që e shkel cakun dhe është gënjeshtar.” (Surja “Gafir”: 28).*

Dhe: *“... dhe mallkimin nga ana e All-llahut ta hedhim kundër gënjeshtarëve.” (Surja “Ali Imran”: 61).*

Dhe: *“... mallkimi i All-llahut qoftë mbi të, nëse ai gënjen!” (Surja “Nur”: 7).*

Nëpërmjet këtyre ajeteve mësojmë se All-llahu (xh.sh.) e ka bërë gënjeshtren sinonim të adhurimit të idhujve. Gënjeshttra flet për dobësim të zemrave. Kur ka gënjeshttra, udhëzimi dobësohet dhe mallkimi i All-llahut zbret mbi gënjeshtarët. Ajetet thonë qartë se sa e shumtuar është gënjeshttra dhe se gënjeshtarët janë larg rrugës së përsosurisë.

Gënjeshttra sipas haditheve islame

Hadithet islame sqarojnë më së miri rrezikshmërinë e gënjeshtres dhe ndikimet e saj shkatërruese në jetën e njeriut.

- 1- Profeti Muhammed (s.a.s.) ka thënë: *“Mjerë ju dhe gënjeshttra, sepse gënjeshttra të largon nga besimi.” (‘‘Kenzul Ummal’’; vëll. 3, f. 620, hadithi /8206).*
- 2- Imam Aliu (a.s.) ka thënë: *“Largohuni nga gënjeshttra, sepse ajo të largon nga besimi. Vërtet, ai që thotë të vërtetën, është i nderuar dhe i shpëtuar, ndërsa gënjeshtari është gjithmonë në fatkeqësi dhe humbje.” (‘‘Biharul Anvar’’; vëll. 77, kreu 14, hadithi /2).*
- 3- Imam Bakiri (a.s.) ka thënë: *“Vërtet, gënjeshttra është shkatërruese e besimit.” (‘‘El- Kafj’’; vëll 3, f. 339, hadithi /4).*

Gënjeshttra është në kundërshtim me besimin. Besimtari kurrë nuk gënjen, por edhe nëse ndodh që të gënjejë ai pendohet thellë për atë që bëri. Ai njeri që e ka zakon gënjeshtren ai nuk është besimtar.

Hasan ibn Mehbub, njëri prej shokëve të imam Sadikut (a.s.), transmeton: Unë i thashë Ebi Abdilahit: *“A mund të jetë besimtari koprrac? ‘‘Ai tha po.’’ Unë i thashë ‘‘Po gënjeshtar?’’ Ai tha: ‘‘As gënjeshtar e as tradhëtar.’’ Pastaj tha: ‘‘Në natyrën e besimtarit nuk gjendet as tradhtia e as gënjeshttra.’’ (‘‘Biharul Anvar’’; vëll. 75, kreu 58, hadithi /11).*

Hadithet islame dëshmojnë se gënjeshttra është fillimi i rënies dhe i devijimit.

Profeti Muhammed (s.a.s.) ka thënë: *“S’ka dyshim se gënjeshttra të çon në djallëzi dhe djallëzia të çon në zjarr.” (‘‘Biharul Anvar’’; vëll 72, kreu 114, hadithi /34).*

Dhe: *“Është tradhti e madhe që të bisedosh me vëllanë tënd e ai të të besojë e ti ta gënjeshtër për ato që thua.” (‘‘Kenzul Ummal’’; vëll. 3, f. 620, hadithi /8210).*

Dhe: **“Mëkati më i madh është të thuash gënjeshtria.”** (“Biharul Anvar”; vëll. 21, f. 210, hadithi / 29).

Imam Askeriu (a.s.) ka thënë: **“Çelësi i të gjitha të këqijave është gënjeshtria.”** (Biharul Anvar; vëll 72, kreu 114, hadithi / 48).

Ka hadithe, të cilat e quajnë gënjeshtren si cilësinë më të keqe morale.

Imam Aliu (a.s.) ka thënë: **“Mbrohuni nga gënjeshtria, sepse ajo është prej moraleve më të ulëta dhe të përbufura. Ajo është rrugë që të çon në poshtërsi.”** (“Biharul Anvar”; vëll. 78, kreu 16, hadithi / 157).

Dhe: **“Moralë më i keq janë, gënjeshtria dhe dyfytërsia (hipokrizia).”** (“Gurerul Hikem”; vëll. 4, f. 166).

Dhe: **“Nuk ka veti më të shumtuar se gënjeshtria.”** (“Gurerul Hikem”; vëll. 6, f. 38).

Dhe: **“E vërteta është amanet ndërsa gënjeshtria është tradhti.”** (“Biharul Anvar”; vëll. 69, kreu 38, hadithi / 35.)

Dhe: **“Thënia më e keqe është gënjeshtria.”** (“Nabxhul Balaga”; Fjalimi 8).

Nëpërmjet këtyre transmetimeve mësojmë se gënjeshtria është tradhti dhe është në kundërshtim me besimin dhe intelektin.

E vërteta në ajetet e Kur'anit dhe në hadithe

Më lart u njohën me pikpamjen e Sheriatit islam për gënjeshtren dhe me ndikimet shkatërruese të saj në jetën shoqërore. Tani do të flasim për të kundërtën e gënjeshtres, e cila është e vërteta. Si vlerësohet kjo cilësi e lavdrueshme në Sheriatin islam?

All-llahu (xh.sh.) i fton robtë e Tij që të jenë gjithmonë me të vërtetët. Ai thotë: **“O ju që besuat! Bëhuni të përkushtuar dhe të jeni me të vërtetët...”** (Surja “Teube”: 119).

Në një ajet tjetër All-llahu i përgëzon robtë e Tij të vërtetët ku thotë: **“Kjo është dita që të vërtetëve u bën dobi e vërteta e tyre. Ata kanë Xhennete, në të cilat rrjedhin lumenj, janë përjetë të pasosur në ta. All-llahu është i kënaqur me ta dhe ata janë të kënaqur nga Ai. Ky është shpëtim i madh.”** (Surja “Maide”: 119).

Profeti Muhammed (s.a.s.) ka thënë: **“Më i afërti juaj tek unë në Ditën e Gjykimit do të jetë ai që thotë të vërtetën.”** (“Biharul Anvar”; vëll 74, f. 152, hadithi / 7).

Imam Aliu (a.s.) ka thënë: **“E vërteta është krenari.”** Dhe: **“E vërteta është motra e drejtësisë.”** (“Gurerul Hikem”; f. 217).

Imam Sadiku (a.s.) ka thënë: **“Vërtet, All-llahu i ka dërguar profetët që të thonë të vërtetën dhe të çojnë në vend amanetin.”** (“El Kafij”; vëll. 3, f. 104).

Gënjeshtria e lejuar

Megjithëse gënjeshtria është e shumtuar dhe konsiderohet vepër e ulët, Sheriati islam e ka lejuar atë në raste dhe situata të veçanta (kur është fjala për domosdoshmëri të madhe). Cilat janë ato raste kur lejohet gënjeshtria?

1- Domosdoshmëria.

Një shembull. Kur jeta e një njeriu varet te gënjeshtria; atëherë ajo lejohet. Në Kur'an thuhet: *"..përveç atij që dhunohet (për të mohuar) e zemra e tij është e bindur plotësisht me besim..."* (Surja "Nabl":106). Ky ajet ka zbritur për shokun e njohur të Profetit (s.a.s.), Ammar ibn Jasir, i cili u torturua nga paria mushrike e Mekkes. Për t'i shpëtuar vdekjes ai shqiptoi kufrin (mosbesimin) me gjuhën e tij. Pra, situata e vështirë e lejon gjënë e ndaluar. Juristët (fukahatë) thonë se "domosdoshmëritë i lejojnë të ndaluarat." Nëse njeriu përballet me dëme të cilat nuk mund t'i përballojë (dëme materiale a që kanë lidhje me veten e tij dhe me dinjitetin e tij), atëherë atij i lejohet t'i shmangë duke thënë një gënjeshtër.

2- Pajtimi: Kur pajtimi mes njerëzve dhe shmangia e armiqësisë mes tyre varet te gënjeshtria, ajo lejohet. Nëse e vërteta e acaron situatën duke e shtuar edhe më shumë armiqësinë dhe urrejtjen, ajo (e vërteta) është haram (e ndaluar). Pra pajtimi e bën gënjeshtër të lejuar dhe të vërtetën të ndaluar.

Profeti Muhammed (s.a.s.) i ka thënë imam Aliut: *"O Ali, All-llahu e pëlqen gënjeshtërën për pajtim dhe e urren të vërtetën që shkatërron."* ("Biharul Anvar"; vëll. 78, f. 356, kreu 10).

3- Mashtrime në betejë: Përpjekjet për të mashtruar armikun në luftëra dhe duele ushtarake është e lejuar në Sheriatin Islam. Lejohet që të bëhen parada, plane ushtarake pa qëllime të vërteta për sulme.

Gënjeshtria në shaka

Ka raste që shakaja përzihet me njëfarë gënjeshtre. Kur një njeri bën shaka me shokun e tij dhe shakaja përmban gënjeshtër, ai shfaqsohet duke thënë: Bëra shaka!

Jo. Gënjeshtria nuk lejohet as me shaka. Profeti Muhammed (s.a.s.) ka thënë: *"Mjerë ai që flet dhe gënjen që të qeshin të tjerët! Mjerë ai, mjerë ai!"* ("Biharul Anvar"; vëll. 69, f. 23, kreu 114).

Imam Bakiri (a.s.) transmeton: *"Kam dëgjuar babanë tim, të thotë: "Frikësojuni gënjeshtërës edhe kur është e vërtetë edhe kur është e pavërtetë, e vogël a e madhe goftë."* ("Biharul Anvar"; vëll. 69, f. 235, kreu, 114).

Biseda me nënkuptime

Et- teurijetu (biseda me nënkuptime) është bisedë e cila ka dy kuptime; Njëri kuptim është si e thotë folësi dhe tjetri si e kupton dëgjuesi: Et- teurijetu nuk është gënjeshtër, por dëgjuesi e bën të afërt me gënjeshtërën. Njeriu e përdor teurijetun kur nuk do të thotë të vërtetën e nuk do të gënjejë; p.sh dikush kërkon dikë tjetër. Për këtë ai pyet një person të tretë. Personi i tretë nuk do të thotë të vërtetën e as të gënjejë. Për këtë ai i thotë "e kam parë në treg." Dëgjuesi kupton tjetër kuptim dhe niset për në treg me shpresë se do ta takojë personin që kërkon.

Përmbledhje

Gënjeshtria është e thjeshtë për t'u thënë, por është prej mëkateve të mëdha. Gënjeshtria luan rol në shkatërrimin e marrëdhënieve shoqërore, sepse ajo prish besimin. Për këtë Islami e quan veprim shumë të shumtuar në jetën njerëzore.

Pyetje

- 1- Ç'është gënjeshtër?
- 2- Cili është qëndrimi i Sheriatit islam kundrejt gënjeshtërave?
- 3- Si e cilësojnë hadithet gënjeshtërën?
- 4- Cilat janë rastet kur lejohet gënjeshtër?
- 5- A lejohet gënjeshtër në shaka?
- 6- Ç'është teurijetu (biseda me nënkuptime)? Sillni një shembuj.

Mësimi 30

PLOTËSIMI I KËRKESAVE

Në njëzet e nëntë mësimet e mësiparshme mësuam se Islami ka si qëllim lumturinë e njerëzve dhe ngritjen e tyre morale. Që të përmbushet ky qëllim, Islami ka përcaktuar për njerëzit morale që rregullojnë marrëdhëniet shoqërore. Të gjithë e dimë se njeriu, përveç të pamëkatëve prej tyre, kanë mangësi përpjestimore. Prandaj njeriu, ka nevojë për një njeri tjetër për të plotësuar rrugën e përsosurisë. Po ashtu, vetë njeriu nuk është në gjendje t'i përmbushë të gjitha nevojat e tij jetësore, qofshin materiale a shpirtërore. Për ata janë edhe faktorë për të ecur shkak drejt përsosurisë. Prandaj, përsëri ai ka nevojë për udhëzim dhe përkrahje. Ne myslimanët jemi ymmet (bashkësi) si të gjithë ymmetet e tjera. Edhe për ne ka armiq dhe keqdashës, të cilët na pengojnë në rrugën e përparimit, të zhvillimit dhe të përsosurisë. Myslimanëve u del për detyrë që të solidarizohen dhe të bashkohen për përballimin e sulmeve të ndryshme. Profeti Muhammed (s.a.s.) ka thënë: **“Muslimanët janë dorë e bashkuar kundër armiqve të tyre.”** (“Biharul Anvar”; vëll. 58, f. 150).

Është e natyrshme, se kur shumë duar bëhen një dorë e vetme, fuqitë shtohen. Kur nuk ka bashkim duarsh, fuqitë dobësohen dhe do të kemi prapambetje. All-llahu (xh.sh.) nuk i lejon myslimanët të përçahen.

Ai thotë: **“Dhe respektojeni All-llahun dhe të dërguarin e Tij dhe mos u përçani e të dobësoheni e ta hubisni fuqinë...”** (Surja “El Enfal”: 46).

Pushtuesit gjithmonë mendojnë dhe punojnë për të futur përçarje mes individëve të një bashkësie, me qëllim që ta kenë të lehtë sundimin e tyre. All-llahu (xh.sh.) jep shembullin e Faraonit: **“(Me të vërtetë), Faraoni ka ngritur kryet lart në tokë e popullin e saj e ka grupëzuar dhe një grup prej tyre e shtyp...”** (Surja “Kasas”: 4).

Kur shoqëria e bashkuar përçahet dhe ndahet në grupime a sekte, ajo shoqëri do të dobësohet dhe do të bjerë pre e sundimit. Për këtë, Kur'ani famëlartë e qorton

përçarjen dhe e ka quajtur vepër të djallit. All-llahu (xh.sh.) thotë: ***“Shejtani nuk dëshiron tjetër veçse nëpërmjet alkoolit dhe bixhozit të futë armiqësi mes jush, t’ju pengojë që të përmendni Zotin dhe t’ju largojë nga namazi...”*** (Surja “Maide”: 91).

Uniteti, bashkëpunimi dhe solidarësia, çojnë në forcim. Imam Aliu (a.s.) në një thënie të tij na fton që të mendojmë për popujt e shkuar dhe të marrin mësim prej sprovave të tyre. Në fjalimin e tij të njohur, me emrin “El Kasiatu” Imami thotë:

“Mendoni për sjelljet e popujve që kanë qenë para jush! Çfarë kanë qenë në kohën e tubimit dhe vuajtjeve?! A nuk ishin të ngarkuar me barrën më të rëndë? Dhe, a nuk ndodheshin në kushte më të rënda nga të gjithë banorët e kësaj bote? Faraonët i mbanin ata si robër duke i flakur në vuajtjet më të mëdha dhe ua shuanin etjen me ithëtinë. Qëndronin në këtë gjendje të poshtëritimit shkatërrues dhe shtypjes mizore dhe nuk gjenin kurrfarë rruge për shpëtim e as mënyrë për tu mbrojtur. Dhe kur All-llahu pa qëndrueshmërinë e tyre duke i bërë ballë vuajtjeve me durim, për shkak të besimit ndaj Tij dhe e duronin mjerimin nga frika prej Tij, Ai u siguroi dalje nga ankthi i tubimeve. Poshtërimin ua zëvendësoi me respekt, ndërsa frikën ua zëvendësoi me siguri. E ata u bënë sundimtarë, autoritarë dhe prijës të dalluar. Kështu mëshira e All-llahut ndaj tyre arriti kufijtë të cilët nuk i kishin arritur as dëshirat e tyre. Prandaj, shikoni se çfarë u bënë kur grupet e tyre u bashkuan, mendimet e tyre u pajtuan, zemrate e tyre u harmonizuan, duart e tyre u lidhën me njëra tjetrën, shpatat e tyre ndihmuan njëra-tjetrën, shikimet e tyre u bënë depërtues dhe mendimet e tyre u bënë të paluhatsëm. A nuk u bënë udhëheqës të anëve të tokës dhe sundimtarë mbi kokat e mbarë njerëzimit? Pastaj shikoni se çfarë u ndodhi kur i mposhti përçarja, u zhduk bashkimi dhe fjalët e zemrat ndryshuan. U ndanë në grupe të ndryshme dhe u shpërndanë në grupacione. Pastaj All-llahu ua hoqi atyre veshjen e nderit dhe i privoi me mëshirën e Tij. Tek ju kanë arritur vetëm tregimet e tyre si udhëzim e mësim për ata që i pranojnë këshillat.”

Nga ky mesazh i përkryer, kuptojmë se uniteti e solidariteti janë faktor për mbarëvajtjen e popujve dhe për lumturinë e tyre, ndërsa përçarja është shkak themelor i rënies, i shkatërrimit dhe i zhdukjes.

Në kohën e Profetit Muhammed (s.a.s.) ymmeti islam arriti në skajet e larta të moralit falë zbatimit të etikës islame. Në atë kohë myslimanët ishin të dashur mes tyre dhe të ashpër ndaj armiqve. Në Medinen Munouareh (e Ndrishme), shoqëria islame arriti një përparim të paparë dhe qe shembull për shoqëritë e tjera.

All-llahu (xh.sh.) thotë në Kur’an: ***“Ju jeni populli më i dobishëm i ardhur për të mirën e njerëzve, të urdhëroni për të mirë dhe të ndaloni nga veprat e këqija dhe t’i besoni All-llahut...”*** (Surja “Ali Imran”: 110).

Morali i lartë e i përkryer i bën, popujt shembull për të tjerët. Në një hadith thuhet: ***“Bëhuni thirrës të njerëzve jo vetëm me gjuhët tuaja, pra edhe me veprat tuaja.”*** (“Biharul Anvar”; vëll. 67, f. 309).

Vërtet, vetë fjala nuk ka vlerë a ndikim nëse ajo nuk shoqërohet me vepër. Nëse duam që flamuri islam të qëndrojë i ngritur dhe mesazhi i All-llahut të përhapet në rruzullin tokësor, duhet të zbukurohemi me moralin islam dhe jeta jonë ta ketë themelin te besimi në All-llahun (xh.sh.). Atëherë, ne do të jemi shembull për shoqëritë e tjera.

Detyra jonë është zbatimi i etikës islame, me qëllim që të jemi shoqëri e fortë përballë kundërshtuesve, sepse All-llahu (xh.sh) na urdhëron që të jemi një dorë e bashkuar dhe na ka ndaluar që të përçahemi e të kemi konflikt mes nesh. Nga sa u tha mund të kuptohet se qëllimet e etikës në Sheriatin islam janë si vijon:

1- Forcimi i shoqërisë dhe mbrojtja e dinjitetit të saj nëpërmjet përhapjes së shpirtit vëllazëror dhe solidaritetit mes myslimanëve. Ne duhet të jemi dorë e fortë. Ne na e ka ndaluar All-llahu të përçahemi e të kemi konflikt mes nesh.

2- Përpjekjet që edhe shoqëritë e tjera të përqafojnë Islamin nëpërmjet paraqitjes së shembujve ndikues.

3- Bashkëpunimi dhe përkrahja me qëllim që myslimanët të përsosen dhe në shoqëritë islame të sundojnë lumturia e krenaria e të qenit islam.

Këto nuk mund të arrihen vetëm nëpërmjet përhapjes së dashurisë, vëllazërisë dhe respektit të plotë mes anëtarëve të shoqërisë islame.

PARATHËNIE

Mësimi 1

ISLAMI, FE SHOQËRORE

Namazi me xhemat

Namazi i Xhumasë

Urdhërimi në të mira dhe ndalimi nga të këqijat

Khumsi dhe Zekati

Përmbledhje

Pyetje

Mësimi 2

VËLLAZËRIA ISLAME

Përmbledhje

Pyetje

Mësimi 3

TË DREJTAT E PRINDËRVE

1- Respektimi i prindërve

2-Kujdesi për të mos u bërë keq atyre

3- Dhembshuria dhe Mëshira

Përmbledhje

Pyetje

Mësimi 4

LIDHJET FAREFISNORE

Ndërprerja e lidhjes farefisnore

Përmbledhje
Pyetje

Mësimi 5
TË DREJTAT E FQINJIT

Keqtrajtimi i fqinjit
Përmbledhje
Pyetje

Mësimi 6
MORALI I BASHKËJETESËS

Moralet e mira
Ndikimet e moralit të mirë
Përmbledhje
Pyetje

Mësimi 7
THJESHTËSIA

Shenjat e thjeshtësisë
Ndikimet e thjeshtësisë
Përmbledhje
Pyetje

Mësimi 8
MBAJTJA E PREMTIMIT

Rëndësia e zbatimit të premtimeve
Përmbledhje
Pyetje

Mësimi 9
ZEMËRBUTËSIA DHE VETËPËRMBAJTJA (1)

Zemërimi
Përmbledhje
Pyetje

Mësimi 10
ZEMËRBUTËSIA DHE VETËPËRMBAJTJA (2)

Disa shembuj rreth hilmit dhe bllokimit të zemërimit
Përmbledhje

Shoqata

Fladi

Pyetje

Mësimi 11

FALJA

Dallimi me uf'uit dhe të safhit

Falja në mundësi

Vendet e të falurit

Përmbledhje

Pyetje

Mësimi 12

DREJTËSIA

Kujtesë morale

Përmbledhje

Pyetje

Mësimi i 13

FYTYRA E QESHUR DHE SHAKAJA

Ndikimet dhe frytet e fytyrës së qeshur

Shakaja

Grupi i parë

Grupi i dytë

Grupi i tretë

Përmbledhje

Pyetje

Mësimi 14

SOLIDARITETI DHE BASHKËNDIMESA PËR PËRMBUSHJEN E NEVOJAVE TË TË TJERËVE

Përmbledhje

Pyetje

Mësimi 15

HARMONIA DHE PAJTIMI MES BESIMTARËVE

Pajtimi mes besimtarëve

Përmbledhje

Pyetje

Shoqata

Fladi

Mësimi 16

NDERIMI I JETIMËVE DHE I TË VARFËRVE

Përmbledhje

Pyetje

Mësimi 17

VIZITATEK I SËMURI

1- Vizita

2- Nxitja për vizitën

3- Rregullat e vizitës

Përmbledhje

Pyetje

Mësimi 18

PJESËMARRJA NË GËZIME E NË HIDHËRIME

3- Pranimi i ftesës

4- Pjesmarrja në hidhërimë

Përmbledhje

Pyetje

Mësimi 19

MIKPRITJA DHE VIZITA

Mikpritja

Rregullat e mikëpritjes

Përmbledhje

Pyetje

Mësimi 20

PËRSHËNDETJA DHE DHËNIA E SELAMIT

Rregullat e përshëndetjes dhe të selamit

Takimi dhe përqaftimi

Përmbledhje

Pyetje

Mësimi 21

SHENJTËRITË

Të shenjtat individuale
Mbulimi i të këqijave
Çuarja e amanetit
Përmbledhje
Pyetje

Mësimi 22

MIKU DHE SHOKU (1)

Përmbledhje
Pyetje

Mësimi 23

MIKU DHE SHOKU (2)

Përmbledhje
Pyetje

Mësimi 24

PËRGOJIMI (1)

Ç'është përgojimi?
Ndalimi i përgojimit
Përmbledhje
Pyetje

Mësimi 25

PËRGOJIMI (2)

Shkaqet e përgojimit
Largimi i mundimit shpirtëror
Vetpëlqimi
Tallja dhe përqeshja
Smira
Përngjasimi me të tjerët
Paraprita
Shtirja për keqardhje
Rastet kur lejohet përgojimi
Ankesa për padrejtësi
Udhëzimi dhe këshillimi
Përkujdesja
Parandalimi i veprave të këqija

Shoqata

Fladi

Hedhja poshtë dhe pranimi
Nofka (llagapi)
Bidadçijtë
I shthururi
Dëgjimi i përgojimit
Përmbledhje
Pyetje

Mësimi 26

SHPIFJA DHE PARAGJYKIMI PËR TË KEQ

Të menduarit keq për të tjerët
Pasojat e të menduarit për të keq
Përmbledhje
Pyetje

Mësimi 27

THASHETHEMJA DHE TALLJA

Bashkëpunimi me thashethemin
Të tallurit dhe të përqeshurit
Përmbledhje
Pyetje

Shoqata

Fladi

Mësimi 28

SMIRA

Njohja e smirës
Smira sipas e ajeteve të Kur'anit Famëlartë
Smira dhe smiraku në hadithe
Shkaqet e smirës
Përmbledhje
Pyetje

Mësimi 29

GËNJESHTRA

Përkufizimi i gënjeshtërs
Gënjeshtër sipas ajeteve të Kur'anit
Gënjeshtër sipas haditheve islame
E vërteta në ajetet e Kur'anit dhe në hadithe
Gënjeshtër e lejuar

Gënjeshtra në shaka
Biseda me nënkuptime
Përmbledhje
Pyetje

Mësimi 30

PLOTËSIMI I KËRKESAVE

